ExLibris

ISSN 2708-4876

E PËRJAVSHME LETRARE KULTURORE

Themelues · Kryeredaktor BUJAR HUDHRI

E SHTUNË, 21 SHTATOR 2024 | NUMËR 302 | VITI VII I BOTIMIT | ÇMIMI 50 LEKË | WWW.EXLIBRIS.AL | EMAIL: INFO@EXLIBRIS.AL | BOTIM I ONUFRI SHPK

Don Jak Zekaj, lindur më 1906, ndërroi jetë në vitin 1995. Ai la në dorëshkrim një vepër të pasur poetike dhe përkthimore, në të cilën përfshihet edhe një përshtatje e panjohur më parë e "Këngëve të Milosaos" të De Radës. Paçka se Zekaj e përfundon në vitin 1958, "Milosao" botohet vetëm tani vonë, bashkë me një pjesë të veprës së tij, nga Enti Botues "Gjergj Fishta" në Lezhë.





Një variant i ri i përshtatjes së poemës së njohur "Këngët e Milosaos"

Nga Tefë Topalli

205 vjet nga lindja e arbëreshit të shquar Francesco Antonio Santori

Nga Klara Kodra Vilma Proko (fq. 18)



Shekspiri dhe përkthyesi Fan Noli, ballë për ballë

Prof. Dr. Diana Alqi Kristo

Në kohën kur përktheu Noli, kishin kaluar më tepër se 300 vjet nga koha kur Shekspiri shkroi kryeveprat e veta dhe gjuha angleze kishte pësuar ndryshime; po kështu kishin ndryshuar edhe spektatorët, teatrot, aktorët, lexuesit, mënyrat e tyre të të menduarit dhe ndjenjat e tyre. Koha, që mbulon me tisin e mjegullës çdo gjë, kishte zbehur edhe pasqyrën shekspiriane të jetës. Për përkthyesin, problemet lindin qysh me fjalët e para.

(fq. 6)

SHËNIME MBI LIBRAT

Strategjia narrative e romanit "Autoportet me teleskop" të Besnik Mustafajt

nga Emin Azemi (fq. 4)

Romani *Kishim një ëndërr* (2016) të shkrimtarit Nasi Lera

NJË KLITHMË ARTISTIKE PËR REALITETIN SHQIPTAR

nga Mikel Gojani (fq.6)

Përmbledhja e parë me tregime e prozatores Ornela Musabelliu

"TRËNDAFILA DHE QIPARISA": EKSPLORIM MJESHTËROR I NJERËZORES

nga Arbër Ahmetaj (fq. 10)

Vëllimi i poetit qipriot Mehmet Jasin, "Engjëj hakmarrës", botuar nga"Neraida"

Rreth vetmisë bashkuese të një poezie të sapombërritur në shqip

nga Natasha Lako (fq.11)

Poezia "Silvias" e Giacomo Leopardi-t

TË LEXOSH POEZINË SI NJË PARTITURË

nga Natasha Poroçani (fq. 22)

BIBLIOTEKË

Mehmet Kraja (fq. 12)
Bindi

Vangjush Saro (fq. 13)
'I ftuar' në TV 13...

Roland Gjoza (fq. 14)
Instinkti i trëndafilave

Dhimitër Pojanaku (fq. 16)
Shiu lexon trishtimin tim

Mark Simoni (fq. 17)
Mesnata e të marrëve

Arben Meksi (fq. 24)
Karikatura e së shtunës

Libri me reportazhe "Udhëtim në Europën Lindore" i G. G. Márquez

Gërshetime imagjinare në largësitë e epokave dhe të zhanrit

nga Enver S. Morina (fq. 20)

Librat e jetës sime: Autorja japoneze mbi humorin e Kurt Vonnegut, gëzimet e James Joyce dhe përkthimin e Beatrix Potter

MIEKO KAWAKAMI:

Franz Kafka është autori që më ngushëllon (fq. 21)

Një variant i ri i përshtatjes së poemës “Këngët e Milosaos”

Nga Tefë Topalli

Don Jak Zekaj, lindur më 1906, ndërroi jetë në vitin 1995. Ai la në dorëshkrim një vepër të pasur poetike dhe përkthimore, në të cilën përfshihet edhe një përshtatje e panjohur më parë e “Këngëve të Milosaos” të De Radës. Paçka se Zekaj e përfundon në vitin 1958, “Milosao” botohet vetëm tani vonë, bashkë një pjesë të veprës së tij, nga Enti Botues “Gjergj Fishta” në Lezhë. Ndërkohë vijon puna për botimin e plotë të gjithë trashëgimisë së tij letrare.



Kush ishte don Jak Zekaj

Jak Zekaj (13 korrik 1906 – 30 nëntor 1995), ka qenë prift famullitar, që sherbeu në Pukë dhe në Zadrimë. Lindi në fshatin Baqël të Lezhës. Në moshën 11 vjeçare dërgohet në Seminarin Papnor, ku u njoh prej edukatorëve për zellin dhe aftësinë, duke kaluar pa rend, nga klasa në klasë, nën një regjim të rreptë të pedagogjisë së asaj kohe. U dallua midis moshatarëve studentë, sidomos në filozofi, letrësi dhe mësimin e gjuhëve të huaja: nga ato klasike (greqisht e latinisht), deri tek gjuhët moderne aq të lëvruara, si: italisht, frëngjisht, gjermanisht; kishte njohuri dhe lexonte sllavisht, spanjisht dhe njihte në shkallë shumë të mirë edhe gjuhën aramaike (variant i ebraishtes). Falë këtyre aftësive, në vitin 1927-1928, Kolegji Saverian e dërgoi në Insbruk (Austri) në Drejtorinë *Canisianum*, për të sistemuar bibliotekën e Universitetit atje. Të gjitha ciklet e arsimit shkollor i ka përfunduar me rezltate të shkëlqyera në Shkodër. Më 1932 shugurohet meshtar nga Imzot Della Pietra, Nunc i Selisë së Shenjtë, në Dioqezën e Sapës. Shërben në Kryezi dhe Qelzë si Dekan i 9 famullive të Pukës, duke fituar një popullaritet të jashtëzakonshëm midis banorëve, deri në vitin 1946, kur do të arrestohej.

Siç lexojmë në biografinë e hartuar nga Fran Palushi, Zekaj kishte nisur qysh në vitet e studimit në Kolegj me vjershat e vëllimit “Andrrat e Rinisë”, përfunduar në vitin 1933 (e pabotuar). Prodhimi i tij artistik vijon me veprën “Java e gjakut” – tragjedi me 42 mijë vargje. Mbi këtë kryevepër punoi e ripunoi për gati 50 vjet (1935-1981). Pas kësaj radhitet parodia kundër Zogut me 17 mijë vargje, përfunduar së shkruari në vitin 1942. Janë rreshtuar në këtë parodi personazhe realë historikë, si: Musa Juka, gjenerali i oborrit-Zef Serreqi, Xhemal Araniti - Ministër i Luftës, vetë Monarku A.Zogu, Gjeraldina, Jakomoni, Guxoni, gjeneral Pariani, Shkrimtari shkodran, Prefekti i Durrësit etj., gjithsej 40 vehtje. Sa ishte në malësitë e Pukës, kreu edhe përmbledhjen e gjerë poetikie “Varrët e zemrës” me 7 mijë vargje, shtrirë si punë artistike në dy kohë: para dhe pas Luftës II Botërore. Në fund të vitit 1943, ka gati parodinë “Kapuçat”, ku vë në lojë krerë të Shqipërisë: Sh.Verlaci me kompani, një listë e gjatë, ku gjenden edhe dy klerikë të njohur: Harapi dhe Shantoja, pa munguar aty as E.Koliqi etj.

Gjatë 14 vjetëve që shërbeu në Pukë, iu kushtua përkthimeve nga poetët gjermanë H.Heine, J.W.Goethe (Fausti), italiani Severino Ferrari e të tjerë, si: Idylet e Teokritit, Bukolikët, Keoforët e Eskilit, Orestja, Elektra dhe Ajaksi të Sofokliut, Medea e Euripidit; nga dramatika e Vittorio Alfierit; nga tragjeditë e Shekspirit; nga vepra “Ricciarda” e Ugo Foscolo-s etj., një vëllim me përmasa të gjera dhe me jo pak vështirësi shpjegimi, që po përgatisim për botim, krahas vjershave dhe poemave për blenin e dytë. Nga letërsia gjermane ai ka përkthyer dhe botuar romanin ekzotik, “Djali i Myftinisë”.

Dy vitet e burgut (1946-1948) don Jaku i vuajti në Kampin e Punës, në Beden të Kavajës; më pas u caktua famullitar në Hajmel (përfshirë edhe fshatrat përreth), Pistull, Kaçë, Naraç, Nenshat, Krajën, Baqël, ku shërbeu me përkushtim në Dioqezin e Sapës, pa iu ndarë krijimtarisë letrare. Në vitet 1954 – 1963 shkroi poemën “Ndër mrize ilire”, të cilën e quan “Bukolika shqiptare”, me 2700 vargje, me 21 ekloga (këngë): me metra të pasur dhe tingëllima joshëse, ku vjen e pikturohet aq bukur në vargje natyra e maleve dhe fushave ilire, shoqëruar me gurgullimën e krojeve dhe jehonën e përrojeve, madhështinë e Rozafës e liqenit pranë saj (*Lacus Labeatis*), oshëtimën e Drinit, Kirit dhe rrjedhën e qetë të Bunës... Ka shkruar përmbledhjen “Gjamë disprimit”, më 718 faqe e me rreth 10.800 vargje. Ka mbetur në dorëshkrim edhe Ditari i tij, nga vitet e Kolegjit e këndej, me njëmijë faqe.

Mbi variantin e ri të “Milosaos”

Këto ditë doli nga shtypi përmbledhja “Vepra poetike-1” nga trashëgimia letrare e don Jak Zekajt, në përpjekje për të botuar letërsinë e tij të hartuar në heshtje: vjershat, poemat, paroditë dhe përkthimet nga italishtja, gjermanishtja dhe gjuhët klasike, greqisht dhe latinisht. Midis tyre u gjet edhe përshtatja e poemës “Milosaat” të De Radës, sjellë prej Zekajt në gjuhën e sotme në vitin 1958, kur ishte famullitar në Hajmel të Shkodrës.

Vepra e arbëreshit të madh, që shënon fillimin e Letërsisë së Rilindjes sonë Kombëtare, ka qenë e para në shkrimtarinë e Jeronim de Radës, që u njoh në vendin tonë dhe me të filluan studimet e gjera jo vetëm të poetit të Makit, por edhe gjithë krijuesve të tjerë të komunitetit shqiptar që jeton në Itali prej shekujsh. Në vijim so të sjellim për krahasim dy fragmente prej dy këngëve të poemës: Kangjelit V dhe Kangjelit XXIV, për të parë se përshtatja nuk përputhet në masën e duhur, përballë së cilës lexuesi mund të shohë edhe origjinalin e De Radës, nga punimi shkencor bashkëkohor që ka kryer studiuesi i njohur i Albanologjisë, prof.Francesco Altimari në veprën e tij akademike.

Ndër punimet mbi tekstin në vargje të poemës, e para përshtatje duhet veçuar ajo e prof.Jup Kastratit, hartuar në vitin 1956, e cila mund dhe duhet quajtur pa mëdyshje *botim akademik,* sepse albanologu dhe historiani i Gramatologjisë shqiptare, studiuesi gjithë jetën i botës arbëreshe, J.Kastrati, ka sjellë shpjegime të thelluara tekstore, gramatikore, nisur nga alfabeti, leksiku, toponimia e zhvillimit të ngjarjeve të këtij romani në vargje, etimologjia, sintaksa dhe fonetika. Përshtatja e tij për Milosaon, para 70 vjetëve, na vjen në dy pamjet: me origjinalin dhe përftimin e tekstit për lexuesin. Kangjele për kangjele, autori rreshton fjalësin që duhet shpjeguar, trajtat e plota pas atyre të gjymtuara për shkaqe vargëzimi prej autorit arbëresh, përmban prurje të interpretimeve që bëjnë gjuhëtarë dhe shkrimtarë arbëreshë të kohës kur u botua vepra; të gjitha këto janë realizuar në një kohë kur mësuesi i Gjimnazin të Shtetit, në Shkodër, ishte vetëm 32 vjeç, pa shkelur ende në tokën arbëreshe! Kjo vepër e parë gjuhësore e letrare e J.Kastratit duhet parë në marrëdhënie me studiuesit shekncorë të De Radës, përveçse me lexuesit.

Punimet e autorëve të tjerë janë me shpjegime të zhakonshme sqaruese; si për shembull, ai i prof.Shuteriqit, që njihet si historian i shkrimeve të vjetra shqipe, por edhe poet e prozator; po kështu, Andrea Varfi ishte poet, kurse Gj.Zheji – shkrimtar romancier dhe studiues i vargut të poezisë shqipe, nisur edhe nga krijimtaria popullore.

Kurse për poetin Jak Zekaj, duhet shënuar se është tërhequr prej poemës deradiane, thjeshtë, për ta njohur në origjinal dhe për të sjellë një përshtatje, e cila meriton të emërtohet “përshtatje poetike”, pasi vargut të tij nuk i mungon ritmi, shpesh herë edhe metri, theksat, tonaliteti e muzikaliteti i vjershës, b.f., gjejmë vargje të tilla: “*Dita e kaltër mbi kodrina/ perballë detit në shkulm valitun/ n’valle gocat i perkëdheli,/ n’sa dashnorët per rreth kqyrin:/ gja ma t’ambël n’tokë çka kemi!*” (Kangjeli VII, f. 30) Ose: *“Nesër nadje njehë Shën Mrija/ flakadaje rreth me ndezë/ e udhët mbushë plot me zhumhuer! O ju manda nder bregore,/ ju ullij të blert nder suka tona/ e ju vneshta mbushë me vile,/ lehtë prarue prej rrezes s’hanës,/ gratë e lodhme të këtij katundit/ mos i leni kurr pa kokrra,/ tue i rrejt’t’mjerat kur t’i kqyrin!*”(Kangjeli XXI, f. 66) etj.

Duke poetizuar fjalën dhe sintagmat, fjalitë dhe në tërsi vargun, autori arrin të ravijëzojë pasazhe të bukura nga natyra dhe portretet e teatrit deradian përgjatë poemës, si tek Kangjeli XXII: *Bie me fjetë, por nuk më zen gjumi,/deren kush dhe mos të ma mbyllin,/që ktu të hijë puhija e detit/ e të më flladisë, si flladitë vashat, /që n’per ara mes blerimit/së bashku kndojnë e derdhin djersen...../* (f. 69). Tablo poetike si këto e përshkojnë gjithë tekstin e përftuar në përshtatje prej poetit Jak Zekaj:

“Ranë kumbonët e ushtroi tupani
e ime motër mblue me t’ zeza,
një pëlhurë nuk pranë tue matë;
që e kish ba nanlokja ime
endë me lesh e pejna mndashit.
Ia kish endë per palë shatorrit,

Don Jak Zekaj

djalit trim që të merrte të bijën,
e ushtrin'n'luftë kur ky ta qitte
n'fusha atje ta ngrehte natën,
gja por s'dinte motra ime....."
(Kangjeli XXVIII, f. 82)

Në fletoren ku gjendet varianti i Zekajt, bashkë me fjalët shoqëruese *përkthim i lirë* është edhe shënimi:

Sot me daten 30 Maj e mbarova perkthimin e Milosaat*!*

Hajmel, 30 -V- 1958

Pastaj, vijon parathënia:

Qysh student, tash ma se tridhetë vjet, më ra në dorë i permenduni libër i De Radës "Milosaat", i pari edicjon, kopertina e të cilit kishte ket permbajtje: POESIE ALBANESI/ DEL/ SECOLO XV/ CANTI/ DI MILOSAO/ FIGLIO DEL DESPOTA DI SCUTARI/ NAPOLI/ DA' TIPI DEL GUTTENBERG/ 1 8 3 6

E unë, me thanë të drejten, tue e lexue perkthimin italisht të kangëve të De Radës, u entuziasmova e m'u çuene në krahnuer ndjena të hovshme rinijet tue m'u pershkue neper true mendime kalorsijet, burrnijet, dashunijet e çka të duesh tjeter, e tue më xanë njisoj melenakolijet e pazhvillueshme. Mbas leximit të parë u mundova me hetue bukurit artistike të gjuhës arbreshe nder kto kangë, të cillat bukurina shperthejshin të padame neper prozen poetike të perkthimit, por as at-herë as deri në sot nuk mund gjeta bukuri nder vargje arbreshe të shkjepët e të pa kurrfarë ritmit të ktyne kangve.

S'po hij ktu me ba kritikë, ket ta bajnë tjerët, që, të dalldisun prej kurrgjas, i hjedhin lavde asgjas e me kalimin e kohes marojnë n'asgja lavdet e veprat e levdueme. Jo, me borë, si bajnë fmijët neper sheshe, ku kjo e bardhë e e ngriet e mbulon vendin, nuk mund të ngrehen trupore artistike, sado të mundohen edhe të mdhejtë me jau stolisë ktyne trupnave boret, gjymtyrët me shkopi e sukuj. [...] Por nejse! S'më duhet gja...Sot, në moshën e kalueme, po i marr me i perkthye këto kangë, o ma mirë me i pershtatë, i shtyem vetem prej entuziazmit që provova sa ishe i ri, kur lexova perkthimin italisht vue perkrah ktyne kangve, e kam me u orvatë me qitë në ket perkthim çka ka pasë nder mend (me thanë) De Rada...

Po ashtu, në përfundim të librit, Zekaj shton:

V r e j t j e

Punova, tue i shkrue rishtas këto kangë e tue ba ndo'j ndryshim të vogël aty këtu, që të delnin ma të kjarta, per me shmangë neper to errësinën e pështjellimin e mjaft vargjeve....., neper ndodhje të papritunа e të pavend, ... me zhdukje të shpejta të personazheve pa u marrë vesh si e per ç'arsye. Vallë, ku do të vehet De Rada e shumë të tjerë në klasifikimin e letrave? Matja e Parnazit fillon me zero e vijon deri në majen e tij, e më duket se asht vend mjaft me i vu poetët tanë, të cillët edhe pa poezi, duen me iu njitë, por rrëshanë e kambadorash, ktij nuk mund t'i kapet maja.

Mungesa e katër këngëve në variantin e Zekajt

Në dorëshkrimin mbi të cilin është realizuar transliterimi, mungojnë Kangët VIII, IX, X, XI. Arsyet e mundshme mund të jenë tre:

Më së pari, është dëshmia e atij që i ka sot në dorë shkrimet e poetit Zekajt, zotit Fran Palushi. Ai thotë se autori punonte edhe me fletë të shkëputura dhe, në çastin kur i është marrë biblioteka e tij modeste, këto fletë mund t'i kenë kaluar në materialet që iu hoqen nga banesa, mbase për ndonjë kontroll, por që nuk iu kthyen asnjëherë.

Mundësia e dytë është që autori ynë të ketë bërë një përkthim nga teksti italisht, sepse De Rada e ka botuar veprën në arbërishten e Makit dhe, paralel me të, e ka përkthyer italisht, sikundër parathënia mund të aludojë.



Mundësia e tretë, autori mund të mos e ketë pasur të plotë tekstin e origjinalit, sepse ksombla që ai zotëronte mund të ketë qenë e dëmtuar.

Megjithkëtë, në botimin e "Milosaos", këto këngë janë përshtatur nga unë sipas modelit poetik të vetë Zekajt në punën e tij, duke u mbështetur sigurisht edhe në variantet e tjera të sipërcituara nga arbëreshologët e mirënjohur.

Variantet e përshtatjes së poemës "Këngët e Milosaos"

Në mbyllje të kësaj paraqitjeje vëmë në dukje se vepra si këto përfshsihen në studimet tona letrare, por njëherësh i takojnë edhe vështrimit gjuhësor, një faze të caktuar të zhvillimit të saj, siç ishte arbërishtja e shkruar e shek.XIX e në vijim. Poema "Milosao", sa na ngjall emocione si lloj narrativ në vargje për skenat e bukura dhe fabulën (ashtu siç është e fragmentarizuar), vjen e bëhet njëherësh edhe objekt studimi gjuhësor në rrafshe të ndryshsme disiplinore, në punën me stzudentë, por edhe për kërkime gjuhësore gramatikore dhe leksikore. Botimi i kësaj poeme merret si vlerë e shtuar e botimeve të tjera, aq më tepër se ajo është e vetme në idiomën e shkruar të gegërishtes veriore, hartuar nga pena e një poeti, prej të cilit kemi në dorë një trashëgimi të pasur letrare dhe që kërkon sistemimin dhe botimin e plotë.

***

Ja variantet e përshtatjes sipas autorëve tanë, nga viti 1956 - 2009 (Kënga V, XXIV)

Origjinali i De Radës (Sipas veprës së F.Altimarit "Opera Omnia II, Canti di Milosaso" Rubbettino Editore, 2017, f. 115)

Origjinali nga vepra e F.Altimarit, Kangjeli V (f. 115)

Ç'të vën ndë dejtit
noerīt zëmëra ime ?
Zbardhëtin anīzit,
ruatin pran' u sheghëtin...
Erth dita e Arbërit.
Ndōmos vëdekurith
mbī shtrat na vemënith
mos përpara shpivet;
e te bota na gharronen
shokët e vëllezërit,
kronjet e katundi in. (f. 115)

1. J. Kastrati, , Poezi Shqipe të shekullit të XV, Kangë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës... Kënga V, Tiranë, 1956, f. 47

Pse të venë në det
Mendimet, o zemëra ime?
Zbardhen anijet.
Shkuan pastaj u-fshehen....
Erdh dita e Arbërit.
Doemos do vdesim
mbi shtrat, në mos rënçim
në prak të shtëpive tona.
E në dhé do na harrohen:
shokët e vëllezërit,
kronjet e katundi ynë. (f. 47)

2. Dh.Shuteriqi, Milosao, Tiranë, 1964, Kanga V, f. 30.

Përse të venë në det
mendimet, zemëra ime?
Zbardhuan anijezat,
panë këndej e u fshehnë...
Erdhi dita e Arbërit.
Doemos do vdesim
mbi shtrat, në mos rënçim
në prak rë shtëpive tona;
e nën dhe do na harrojnë
shokët e vëllezërit,
krojet e katundi ynë.

3. Andrea Varfi Këngë të Milosaut, Poemë, [1] Tiranë, 1974,Kënga VII (4 nëntor 1436) , f. 33

Ç'po të venë sot në det
mejtimet, o zemra ime?
Zbardhuan anije armike;
vëzhguan, pastaj u fshehen:
Erdhi dita e Arbërit !
Domosdo, të vdekur ne
mbi shtrat do të shtrihemi;
në mos duke bërë luftë
përpara shtëpive tona !
Dhe ndën baltë na harrohen
shokët e vëllezërit,
krojet edhe vendi ynë. (f. 33)

4. Prof.: Gjergj Zheji, Këngët e Milosaos, Transliteruar,
i shpjeguar dhe hartues i fjalorit, Argeta LMG, Tiranë, 2009, f. 31

Çë të venë ndë dejtit
noeritë zëmëra ime ?
Sbardhëtin anijzit,
ruatin, pran'u shehëtin...
Erth dita e Arbërit.
Ndo mos vëdekurtith
mbi shtrat na vemënith,
mos përpara shpivet;
e te bota na garronen
shokët e vëllezërit
kronjet e katundi inë. (f. 31)

5. Jak Zekaj, Kanga V, Milosaat, Botimet Fishta, Lezhë, 2024, f. 25.

Pse të kalojn mbi shkulma të detit,
zemra e ime larg kujtimet ?
U zbardhuen anit me vela,
erdhen pranë e prap u zhduken...
Mbërriti dita e Arbenisë.
Na do e mos mbi shtrat do të vehemi
dekun shtri po s'ramë nder praqe
t'shpive tona tue luftue:
e në jetë tjetër kur të shkojmë vetem





1 Ndër përshtatësit e poemës, A.Varfi, ka numërim tjetër të kangjellave; siç është kjo me numër XXXIV, bërë prej poetit Varfi, sipas botimit III, në Itali.

(Vijon në faqen 5)

Romani “Autoportet me teleskop” i shkrimtarit Besnik Mustafaj

STRATEGJIA NARRATIVE E ROMANIT “AUTOPORTET ME TELESKOP”

nga Emin Azemi

Romani “Autoportet me teleskop” i shkrimtarit Besnik Mustafaj është një produkt i pastër letrar, që për shumëçka është unik në mbarë letërsinë moderne shqipe. Në radhë të parë, ky roman është një manifest estetik i shkruar në vazhdimësi, madje edhe para se autori të vendoste të shkëputej nga politika, sepse procesi i krijimit nuk ndodhë vetëm gjatë aktit fizik të të shkruarit, por edhe përtej kësaj. Nëse një njeri që e lë këtë botë dhe pas tij mbetet një testament për trashëgimtarët e tij, për shkrimtarin kjo do të mund të transformohej në një përvojë pak a shumë tjetër, ku fiksionaliteti e bënë atë të jetojë me bashkëkohanikët edhe pasi ta ketë përfunduar veprën për të vërejtur nga afër reagimet dhe efektet e atij fiksioni. Dhe kësaj, Besnik Mustafaj ia ka arritur.

Lexuesi – një bashkëudhëtar i padukshëm

Politika, si profesion që i ndihmoi narratorit të krijojë një personazh (homonim) letrar, autorit i ka shërbyer vetëm si katalizator për të përshpejtuar procesin e njohjes me një jetë dinamike, e cila jashtë politikës nuk do ta kishte dramën që e ka romani. Ndonëse edhe vetë Mustafaj e thotë me një rast, se ky roman në palcën e tij është politik, prejardhja e këtij konstatimi që nuk është ekstra zhanror, megjithatë nuk na pengon ta shikojmë atë pak më thellë, duke depërtuar në zona që vetëm një shkrimtar i talentuar di të ecë, duke qenë i sigurtë se rrugët nga po ecte, për herë të parë po shkelte dhe në gjithë atë rrugëtim kompleks, sikur lë vend edhe për një bashkëudhëtar të padukshëm, për të bërë një transfer semantik të kodeve nga shkrimtari tek lexuesi, sepse vetëm duke qenë interaktiv në aktivitetin narrativ, shkrimtari dhe lexuesi krijojnë plotninë e përceptimit të veprës.

E ndarë në katër pjesë, ose në katër nivele që krijojnë strategjinë narrative të romanit , sikundër janë: Thesari për luftën, La Ceinture de Chastete (La sentyer de shastete), (Brezi i virgjërisë), Kalëruesi i humbur, Continuum, kjo vepër imponon para lexuesit sfidën për t’u ballafaquar me një lëndë komplekse, sa heterogjene si teknikë dhe metodë krijuese, po aq edhe voluminoze si informacion estetik e letrar për një tipologji të gjërë ngjarjesh, karakteresh e shtrirjesh kohore dhe hapësinore. Prandaj edhe nuk do të bënim ndonjë gabim metodologjik, sikur këtë vepër ta copëzonim në fragmente, për ta kapur më afër natyrën e procedeut, mirëpo kjo do të na shkaktonte telashe jo të vogla për ta përceptuar plotninë, e cila, megjithatë ka një rrjedhë dhe një dinamikë të brendshme narrative dhe si e tillë do të duhej një receptim integral i njësive të veçanta tekstore brenda gramatikës së plotë rrëfimore. Kjo dinamikë fillon në momentin kur narratori që identifikohet me heroin letrar Besnik Mustafajn, ndodhet në detyrën e ministrit të Jashtëm tek merr pjesë në një konferencë ndërkombëtare në Monaco, me përfytyrimin se në një kohë të keqe dhe në një vend të keq do të përfshihej në një telash të madh.

Një pe i hollë dhe gati i padukshëm që lidhë amplitudat e zhvillimit të fabulës është ecja e narratorit nëpër fushën imagjinative të jetës së përjetuar dhe transformimin e saj në një realitet të ri estetik, sepse shkrimtari ka rrugën e tij, që është vetëm e tij, për të mbërritur tek të fshehtat e njeriut, atje ku edhe e ardhmja është abstrakte dhe mjaftonte për të ngjallur frikë.

Kjo ecje bëhet duke bartur me vete edhe dromca të patretura nga e kaluara, pa të cilat narratori nuk do të mundte të projektone disa nga pikat referenciale të retrospektivës dhe perspektivës kohore që lehtë mund të shëmbëllejnë në figurën komplekse të Selami Beshirit, të cilin narratori e risjell në vëmendje për ta rishikuar edhe një herë në një mbrëmje të vonë në Bruksel.

Jo vetëm pse Selami Beshiri kishte një ëndërr të parealizuar qysh nga fëmijëria e hershme: të shuante nepsin për sallame e salçiqe, por edhe pse ai, si karakter do ta nxisë narratorin të bëjë hulumtime shterruese për të ndjekur diagramin e formimit dhe transformimit të personalitetit në dy kohë dhe hapësira krejt të ndryshme. Ky portretizim aspak stereotip dhe krejt origjinal, e nxjer në sipërfaqe prirjen e autorit për të ndërtuar alibinë e krijimit të situatave groteske, sikur në rastin e Selami Beshirit, të cilit, siç thotë autori, sistemi kompleks dhe i kudogjendshëm e kurdohershëm i propagandës dhe edukimit të regjimit revolucionar nuk kishte arritur t’ia rrënjoste një ëndërr që t’i mbijetonte kohës, gjë që e kishte arritur një spot publicitar për sallamërat belge.

“Autoportret me teleskop”, si një sporovë e guximshme letrare, e vendos ngadonjëherë autorin në pozitë të pabarabartë me kurreshtjet e panumërta të publikut, i cili me maninë e sipërfaqësisë dhe përtacisë për t’u thelluar më tepër në leximin e veprës, kërkon të nxjerrë jashtë kontekstit letrar personazhe e situata të caktuara. I ardhur në letrat shqipe si një individualitet, që kishte lënë gjurmë të pakontestueshme të formimit estetik në veprat pararendëse siç ishin romanet: ‘Vera pa kthim’ , ‘Një sagë e vogël’ , ‘Boshi’ dhe një opus i pasur poetik, autori i romanit që tani lexuesi ka në duar, është treguar mjaft bujar me ofertën e tij për një dialogim me lexuesin, duke kërkuar nga ai pjesëmarrje aktive receptive në periudhën postkrijuese të këtij romani. Mbase është për t’u admiruar kjo praktikë e autorit, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet emancipimi estetik i recepientit, pa të cilën edhe nuk mund të zhvillohet shprehia e komunikimit me veprën letrare.



Romani si një manual udhëzues për lexim kreativ

Nëse mund ta quajmë sprovë të guximshme, sfidën për të reduktuar maskimalisht distancën në mes të autorit dhe narratorit, gjithashtu do ta konsideronim si paradigmë socio-kulturore edhe metodën krijuese të shkrimtarit Besnik Mustafaj, e cila në aspektin teorik e estetik do të mund të formësohej si një manual udhëzues për lexim kreativ.

Çka mund të mësojmë nga ky manual, me kusht që ai të kundrohet brenda planimetrisë narrative që autori i skicon si metoda pune?

a)Në fillim çdo kapitull, në retrospektivë përsëritet dhe spjegohet më detajisht rrëfimi paraprak. Ose sekuenca narrative – njësia përbërëse e të rrëfyerit, e cila edhe vetë është e aftë të funksionojë si rrëfim. Në romanin “Autoportet me teleksop”, këto sekuenca narrative paraqiten edhe si seri situatash e ngjarjesh, nga të cilat e fundit në radhë paraqitet si përsëritje e pjesshme, apo transformim i së parës.

b)Alternacioni si gjetje origjinale e autorit, ku kombinimi i niveleve narrative bëhet në atë mënyrë që njësitë e njërit nivel alternohen në njësitë e nivelit tjetër.

c)Rrëfimi metadijegetik brenda një kornize, ose rrëfimi i cili funksionon si kornizë e rrëfimit tjetër, duke i siguruar atij ambient funksional dhe kontekstualizim të semantikës së objekteve dhe ngjarjeve.

ç)Vëzhgimi depërtues dhe kohezioni në mes të personazheve.

d)Struktura epike e narracionit në roman funksionon në trekëndëshin: personazhet – hapësira – veprimi.

Gjuha si kod semantik shenjash e mesazhesh, në romanin e Mustafajt paraqitet në dimensionin e dyfishtë: në aktin e të rrëfyerit dhe aktin e përvetësimit. Çdo histori që rrëfehet këtu, që nga misteri reth thesarit të luftës, pastaj aventurat e përcjella me groteskun urban të tipave, si Selami Beshiri, Bilal Barzezi, dialogu me Ana B., episdodi paradoksal e tragjikomik me gruan angleze në aeroportin e Athinës, telashet me gruan që shitte qumshtin e gjirit në një metropol europian dhe rënia pre e naivitetit të një emigranti shqiptar në këtë histori, skenat gati filmike të një jete të braktisur rurale, janë disa nga bërthamat semio-tematike që aktin e të rrëfyerit e përplotësojnë me dimensionin e përvetësimit.

Implikimet psikologjike e filozofike

Shtresa e objekteve të romanit përbën inventarizimin alegorik të gjërave që në fakt është bota, të cilën në mënyrën e tij

shkrimtari e bartë në veprën letrare, e që duket të jetë reale. Por në fakt ekziston vetëm si realitet estetik (gjuhësor), me të cilën sugjeron situata jetësore, sepse siç e thotë edhe vetë autori në një intervistë teleskopi, sa ç'ishte konkret, aq edhe jepte dorë për një metaforë me kuptime të shumëfishta.

Një prej atyre objekteve është edhe teleskopi, një lajtmotiv ky që i ka shërbyer autorit për ta ndërtuar intrigën fabulative të njeriut, që kishte nevojë të zhdukte distancat gjeografike dhe ideali për të braktisur ndjenjën që të krijon izolimi, të sygjeron të mendosh për objekte që i relativizonte kufijtë dhe distancat, siç mund të konisderohej edhe teleskopi si një objekt që i reduktonte këto parametra hapësinor, sepse, siç e thotë edhe vetë autori teleskopi, sa ç'ishte konkret, aq edhe jepte dorë për një metaforë me kuptime të shumëfishta.

Në roman, shtresa lëndore e objekteve është ngusht e lidhur me shtresën e aspekteve tematizuese, kurse aktivizimi i kësaj shtrese vie gjatë leximit, kur edhe bëhet kombinimi i objekteve me personazhet dhe marrëdhniet në mes vete.

Por e veçanta e këtij romani qëndron në resurset gjuhësore e stilistike për të sugjeruar vetëm ato mesazhe që burojnë nga vetë vepra, duke e ndihmuar lexuesin të mos jetë kaotik në përceptimin e sistemit figurativ të ngjarjeve e personazheve. Autori me këtë vetëm se vërteton teorinë e Ingardenit mbi funksionin e lexuesit në 'rikrijimin e veprës'.

Në lidhshmërinë sintetike të fakteve letrare, autori nuk ndjek ndonjë shkollë të caktuar historiografike, por bën zhvillimin e atyre përvojave me të cilat lexuesi i qaset veprës letrare.

Ajo që në roman karakterizohet si dramë e individit dhe fat i kolektivitetit, nuk do të mund të arrihej pa implikimet psikologjike e filozofike, të cilat autori i përdorë me mjeshtri, dhe kjo mund të vërehet sidomios në rastet kur personazhi paraqitet si inkarnim i tëhuajsimit dhe epshit, ose si peng i frikës për të panjohurën, por edhe për të papriturat e lirisë. Përjetimi i brendshëm i individit bartet në realitetin kompleks që e rrethon, kurse vetmia e njeriut, i rrethuar me frikën , paragjykimin, inkorporohet në toposin malor, që drejtpërdrejtë ndikon edhe në formimin e karakterit të mikrokosmosit. Letrarizimi i botës së individit dhe konflikti i kësaj bote me rrethin... Çdo personazh i këtij romani është episod nga seria e gjatë e quajtur jetë. Autori i afrohet me këtë konceptit letrar që kishte Tolstoi mbi jetën: mikrokosmosi derdhet, ose shkrihet në makrokosmos dhe përpjekja titanike për t'u dukur i veçantë nga kjo turmë socio-antropologjike, në momente e rrethana të caktuar kishte edhe kosto të lartë për vetë lirinë dhe jetën e njeriut.

Tragjika dhe grotesku i qenësimit njerëzor, e përkohshmja dhe e përhershmja, fantasshkenca, ëndërra, erosi përbëjnë linjat karakterizuese identitare të kësaj vepre, ndërkohë që ndërtimi i arkitekturës së romanit ecë bashkë me zhvillimin dhe formimin e personazheve, nga një kohë, në një kohë tjetër, nga një hapësirë në një hapësirë tjetër. Selami Beshiri, Bilal Barzezi, Muzafer Zhivini paraqesin tipologjinë komplekse të portretizimit psikologjik të njeriut, që kishte lëvizur nga një kohë e brisht rinore në një pjekuri burrërore, nga një vetmi rurale në një kaos metropolitan. Origjina sociale e shpirtërore e personazheve, bashkë me folenë e kujtimeve, krijojnë shtratin mjaft dinamik të rrëfimit, ku derdhja e lëndës narrative nuk bëhet në një kallëp të ngurtë e të mbyllur hermetikisht. Mjeshtria e autorit qëndron pikërisht në krjimin e një kallëpi mjaft elastik brenda të cilit lëviz lënda narrative.







(Vijon nga faqja 3)

na harrojnë shokë e vllazni;
e der krojet neper gryka
lehtë pa ne prap gurgullojnë. (f.25)

Obobo! vure krahë
si një flutur e mundafshin
ti o vashë nuk e pe.
(J.Kastrati, 1956, f. 93)

ndritje dhe mbitrarëzën ?
Bobo ! si më bëre krahë,
m'ike flutur dhe mëndafshin,
shoqja ime nuk e pe ! (f. 99)

II.

Kangjeli XXIV i poemës, nga origjinali sipas F.Altimarit, 1836

F.Altimari: Kangjeli XXIV, f. 136

Kusht t'thoj se mua më leje
e pâ fân motëra ime?
Sa të gharaksenej mbi dejt
më lëreje shtratëthin
sirkun të tagjisje:
cilonës çë nguqënej
llamburisëjin sufitat.
Popo! Bëre pêndëzit
Si një fjutur e mundash,
vash, të mos e shighje !

1. J. Kastrati Poezi Shqipe të shekullit të XV, Kangë të Milosaut, bir i sundimtarit të Shkodrës...Tiranë, 1956, f. 93

Kush mund ta thoshte se do më lije
motra ime e pafat ?
Sa agonte përmbi detë,
ti o shtratin ma lironje,
krimbin e mëndafshit të ushqenje;
tavanet ndritënin
prej petkut që skuqte.

2. Dh.Shuteriqi, Milosao, Tiranë, 1964, Kanga XXIV, f. 59.

Kush kujtoi se do më lije,
e pafat motëra ime ?
Sa agonte përmbi det,
Më liroje shtratin
që ushqeje sirkun.
Fustanes së trëndafiltë
shëndrinin tavanet.
Bobo! fletë si një flutur
se ç'më vure e mëndafshin,
vashë, nuk e pe !
Të tjera mbi dhe i kryen
ç'pati zënë dora jote
e ti më je pluhurosur. (f. 59)

3. Këngë të Milosaut, Poemë, [2] Tiranë, 1974, Andrea Varfi, f. 99

Kush pandehte se do m'ikje
imezonjë e shoqe e zezë,
ti që sa mbi det agonte,
shpejt më lerje shtratinë
të më ushqeje pubzatë
dhe me petkun e kuq flakë

2 Ndër përshtatësit e poemës, A.Varfi, ka numërim tjetër të kangjellave; siç është kjo me numër XXXIV, bërë prej poetit Varfi, sipas botimit III, në Itali.

4. Këngët e Milosaos, Transliteruar, i shpjeguar dhe hartues i fjalorit
Prof.: Gjergj Zheji, Argeta LMG, Tiranë, 2009, f. 89

Kush të thoi se mua më lëje,
e pafanë motëra ime?
Sa të garaksënej mbi dejt,
më lërëje shtratin
sirkun të tagjisije:
cilonës çë nkuqënej
llamparisëjin sufitat.
Popo! Bëre pendëzit
Si një fiutur, e mundash,
Vash, të mos e shihie ! (f. 89)

5. Kanga XXIV, Milosaat, Jak Zekaj, Botimet Fishta, Lezhë, 2024, f. 73.

Vallë, kush të tha se ti do të më leshe
e pafat, moj vasha ime?
Porsa drita në det agonte,
shtrojen lehtë ti ma lirojshe,
me i dhanë gji ferishtes së bukur.
Mbi ne ndrit në të kuq tavani,
petkut tand tue marrë feksimin.
Heu! por vunë flatra të holla,
ti moj vashë si flutur mndashit
prej sysh së mij sa mos me u pa. (f. 73)


Kanga I

Toka Gjuat krejt ndermes kishte,
e njëj e si nder shkulma të detit
prej dritës së re kish kaltkeme,
veç pllum-bardhi i Anakreóntit
së Tempe të motshme prap gjallndete.
Ky flutruj një dite nder male
nej me pi pe ehish manë etja,
e s'u kthye si mbush zahant:
jo atje bora s'e kish ngri,
as pergjaki s'e kish zhingjeta,
por se tretë kish der gi mi
tek e buzkha shpija eime.
N'agum dritës kur u gluhue
dheu me shpja e deti marë
si harpa gi del per sysh,
mue me zgjoj tue fluturue
neper xhama te dritoja.
Brofa në kambë e kgyra jashta:
Rrushi në vreshtë pergjysë i pjekun


Kanga VI

Nisi bora mbi vale të detit
krahët e çapkave tue i zbandë
ku nper fyusha kto kan bulmojtin.
Gjumi i rendë mue kujt më ka lodhë:
po shkon trupi tue m'u fiskun,
zi nji grues gi kish Marbela
kap mbas kupit njitet lodhsken
rend i rpunet Jaki kavalë

Faksimile nga dorëshkrimi i don Jak Zekajt

Shekspiri dhe përkthyesi Fan Noli, ballë për ballë

Nga prof. dr. Diana Alqi Kristo

Me një mjeshtër të gjuhës e letërsisë angleze si dhe të letërsisë botërore iu desh të ndeshej Nolit përkthyes qysh më 1916 kur përktheu Othellon dhe përsëri më vonë, më 1926 kur shohin dritën e botimit tri tragjeditë e tjera. Ndërkohë, Noli, i cili kishte mbërritur në SHBA më 1906 "kishte ndjekur shkollat e natës për të perfeksionuar gjuhën (52) dhe më 1912 ishte diplomuar nga Universiteti i Harvardit, dega e arteve, me sukses të shkëlqyer (cum laude). Pra kur nisi përkthimin e Shekspirit, ai kishte një zotërim të mirë të anglishtes. Megjithatë, kushdo e kupton se kur filloi përkthimin e kryeveprave të Shekspirit, Noli ka ndeshur probleme gjuhësore tepër të vështira, të cilat edhe vetë i ve në dukje kur shkruan në parathënien e Othellos "mburrem që munda ta përkthej." Ku qëndrojnë disa nga këto vështirësi?

Së pari, çdo gjuhë ka një përcaktues kohor. Asnjë formë semantike nuk është jashtëkohore. Një tekst është i kufizuar në një kohë historike specifike; ai ka atë që linguistët e quajnë strukturë diakronike. Ta përkthesh tekstin e dhënë do të thotë të rikrijosh të gjitha vlerat, ose pothuajse të gjitha vlerat (këtu kemi parasysh rastet e papërkthyeshmërisë) dhe qëllimet e shprehura në të, në gjuhën marrëse bashkëkohore, pra në strukturën sinkronike.

Nga pikëpamja e teorisë së përkthimit, dallimi midis krahasimit sinkronik dhe diakronik nuk luan rol. "Përkthimi mund të kryhet midis çdo lloj gjuhësh apo dialektesh, të cilët mund të kenë ose jo 'lidhje' dhe që janë në çdo lloj marrëdhënieje hapësinore, kohore, sociale, etj., midis tyre." (70)

Në kohën kur përktheu Noli, kishin kaluar më tepër se 300 vjet nga koha kur Shekspiri shkroi kryeveprat e veta dhe gjuha angleze kishte pësuar ndryshime; po kështu kishin ndryshuar edhe spektatorët, teatrot, aktorët, lexuesit, mënyrat e tyre të të menduarit dhe ndjenjat e tyre. Koha, që mbulon me tisin e mjegullës çdo gjë, kishte zbehur edhe pasqyrën shekspiriane të jetës. Për përkthyesin, problemet lindin qysh me fjalët e para. Fjalët në vetvete, rrallë kanë shenja të jashtme që të na tregojnë për ndryshimin e kuptimit, ato e shfaqin historinë e tyre vetëm në një kontekst të dhënë. Në librin e tij Eksperienca e të Huajit, Antonie Berman diskuton kompleksitetin e përkthimit të teksteve nga periudha të ndryshme historike, duke theksuar faktin se përkthyesi duhet të jetë i ndërgjegjshëm si për kontekstin historik të tekstit dhe gjuhës së burimit me të cilën punon.

Kur kemi për të përkthyer një tekst historikisht të kaluar, siç është në rastin tonë Shekspiri, përkthyesit i duhet punë e veçantë për të bërë deshifrimin, sepse në shekullin XX presently nuk do të thotë immediately (menjëherë – sot së shpejti) siç donte të thoshte në përgjithësi për Shekspirin, wish nuk do të thotë lust (epsh – sot dëshirë); apo rage nuk do të thotë folly (zemërim – sot budallallëk); silly nuk tregon innocence dhe purity (pafajësi, pastërti, - sot mëndjelehtësi). Sipas Gideon Toury, një studiues i shquar i përkthimit, e mendon këtë të fundit si një akt sinkronik dhe diakronik në të njëjtën kohë, "...përkthimet reflektojnë normat kulturore dhe konvencionet e kohës (sinkroni) por edhe i japin formë evolucionit të gjuhës si dhe praktikave të përkthimit me kalimin e kohës (diakroni).

Përveç dijeve të tij historike e kulturore, përkthyesi i vërtetë e gjen "shpëtimin" edhe në punën e lodhshme por të frytshme me fjalorin (duhet të kihet parasysh se çdo periudhë ka topografinë e vet të veçantë specifike). Përkthyesi nga anglishtja nuk e ka të vështirë të gjejë mjaft fjalorë që i japin një ndihmë të paçmuar në këtë drejtim: që nga Fjalori Anglo-Sakson i Bosuorth-Toller, Fjalori i Anglishtes Mesjetare i Hans Kurath e Sherman Kuhn, Fjalori Etimologjik i Skeat-it (me burime të pakrahasueshme), fjalorët onomatopeikë e deri tek fjalorët specifikë të gjuhës së Shekspirit. Nuk e dimë se pikërisht cilët fjalorë ka shfrytëzuar Noli, por krahas fjalorëve të shumtë dy gjuhësh apo idiomatikë që gjejmë në bibliotekën e tij personale, gjejmë edhe një botim të vjetër të Etymological Dictionary of the English Language (W. Skeat). Duke u nisur nga fakti se tre përkthimet e tjera Noli i ka bërë në Gjermani, ai nuk mund të mos ketë shfrytëzuar fjalorin Shakespeare Lexicon botuar aty nga vitit 1909 (po këtë fjalor kemi shfrytëzuar edhe ne, përveç materialeve të tjerë të shumtë ndihmës, për zbërthimin e Shekspirit gjatë analizës).

Një burim i dytë "vështirësie" qëndron në gamën e gjerë të kuptimit të fjalëve e cila nuk shfaqet menjëherë, në poliseminë. Prandaj përkthyesit i duhet ta jetojë "dramën", të njohë idiomatikën emblematike, filozofike të ndërtuar nga autori, për të matur peshën e fjalëve kyç, që do t'i krijojnë mundësinë e zbërthimit të tekstit. "Vështirësia" këtu është çështje reference. Gjuha na tregon sferat e njohurisë njerëzore apo të kontekstit të veçantë. P.sh., një figurë qendrore në "Hamletin" varet nga vokabulari i industrisë tekstile, mënyrës së ngjyrosjes së leshit (wool-greased or enseamed with hog's lard over the nasty sty, Hamleti, Akti 3, Skena 4). Pa zbërthyer kuptimin e saj nuk mund të zbërthehet figura. Pothuajse nuk ka asnjë dramë të Shekspirit ku të mos jetë përdorur zhargoni i gjerë i termave muzikore të kohës elizabetiane për të shprehur ide të rëndësishme të veprimtarisë apo të sjelljes njerëzore. Pra siç shihet, aludimet e pafund të Shekspirit janë marrë nga një mori sferash të veprimtarisë njerëzore, që nga detaria e ligji, mjekësia e kopshtaria, gjuetia e magjia, etj. Ndihmën në këtë rast na e japin manualet e ndryshëm mbi këto fusha dhe në veçanti glosarët me të cilët janë pajisur pothuajse gjithë botimet e Shekspirit.

Noli na thotë se si tekst bazë ka përdorur FF[1], por nuk do t'i kenë munguar edhe tekstet me shpjegime, veçanërisht përgatitur nga gjermanët për të cilët thotë se "kanë bërë më shumë për Shekspirin se sa vetë anglezët apo amerikanët". Kjo shprehje i referohet shpesh George Bernard Shaw-t (me të cilin Noli ka pasur edhe korrespondencë) (duke i hequr apo amerikanët), por dihet se studiues gjermanë si August Wilhelm Schlegel dhe Johan Wolfgang von GOether kanë kontribuar mjaft në studimin dhe vlerësimin e Shekspirit nëpërmjet analizave të hollësishme, përkthimeve dhe eksplorimeve filozofike të veprave të tij.

"Vështirësinë" e tretë na e paraqet hapi i shpejtuar i stilit shekspirian. Në thurjen e ngjeshur të dramës, ku ngjarjet dhe njerëzit lëvizin me shpejtësi (karakteristikë e teatrit të kohës ku skena ishte e ndërtuar ndryshe) ndërtimi sintaksor na paraqitet i ngjeshur. Dy tri fjalë mjaftojnë për të shpalosur një ide të tërë. Në këtë rast pikësimi luan rol vendimtar dhe të debatueshëm njëkohësisht. Ai shënon jo plotësisht, atë çka lihet për t'u nënkuptuar, ndërthurjen, si dhe atë çka kupton përkthyesi në mendjen e tij. Por leximi i vëmendshëm, pak e nga pak "siç e pinë ujin me gllënjka arabët në shkretëtirë ose francezët verën...rresht për rresht e fjalë për fjalë", na ndihmon që ta "kuptojmë vlerën e plotë të Shekspirit." (Vladimir Nabokov), t'i hyjmë thellë e ta zbërthejmë idenë që ka dashur të shprehë ai.

Të lexosh Shekspirin, do të thotë të fillosh të përgatitesh për këtë" thotë Steiner. Aq më tepër domethënëse bëhen këto fjalë kur i vihemi punës për ta përkthyer atë. Pra njohja me sfondin historiko-social të kohës në të cilën u shkrua vepra, njohja nga afër me pikëpamjet filozofike, politike, morale, ideo-artistike të autorit në përgjithësi, zbërthimi i parashtrimit të tyre në vepër, si nëpërmjet literaturës kritike ekzistuese ashtu edhe nëpërmjet leximit e rileximit të tekstit, zbërthimi gjuhësor e stilistikor i tij, të gjitha këto pra, përbëjnë detyrat paraprake kryesore dhe më të domosdoshme të përkthyesit.

Dëshmi e kësaj pune të madhe paraprake, të cilën e shohim të realizuar në përkthimet e Nolit, janë si literatura historike e kritike, biografike e etike, ashtu dhe fjalorët dhe glosarët enciklopedikë e komentarët, të cilët i gjejmë me shumicë në bibliotekën e tij personale. N. Jokli dëshmon se kur Noli deshi të përkthejë Faustin në vitet 20, puna e parë që nisi të bëjë qe studimi i literaturës dhe komentarëve mbi kryeveprën e Gëtes.

1 Tekstet e përfshirë në FF (First Folio, botimi i parë i veprave të Shekspirit) u përgatitën nga John Heminges dhe Henry Condell (1623), dy figura të shquara të teatrit elizabetian. Kjo përmbledhje pa dritën e botimit shtatë vjet pas vdekjes së Shekspirit dhe shërbeu si "kanuni" i formësimit të letërsisë perëndimore.

Të gjitha sa u përmendën më lart janë njëra anë e çështjes. Ana tjetër i përket punës së madhe të përkthyesit me gjuhën amtare, që është edhe mjeti me anë të së cilit do të shprehen mendimet e idetë, forca figurative e stilistike e origjinalit. Në studimin "Gjon Buzuku dhe gjuha e tij" (Vëllimi III, Vepra si përkthim) prof. Eqrem Çabej shkruan se "për të vlerësuar librin si duhet, qoftë si një dokument gjuhësor, qoftë si vepër letrare, duhet nisur nga ky vetë: të shikohet se çfarë ka ditur autori të nxjerrë nga visari i gjuhës amtare, si trajtoi ai me këtë brumë vetjak një lëndë siç është ajo e Dhiatës së Vjetër dhe e së Resë". Pikërisht duke u nisur nga ky këndvështrim, ne jemi munduar të vëmë në pah, aq sa na e lejonte edhe tema e këtij punimi, veçanësi të gjuhës së Nolit përkthyes, për të parë se si hyn ai në të fshehtat e gjuhës dhe si i shfrytëzon aftësitë shprehëse dhe mjetet e saj krijuese për të rritur bashkëmarrëdhëniet e shqipes me anglishten por gjithmonë duke pasur parasysh pavarësinë e saj në kuadrin e këtyre bashkëmarrëdhënieve.

Nga analiza kemi vërejtur se këtë ai e arriti si nëpërmjet shfrytëzimit të fondit leksikor-frazeologjik popullor (të gurrës popullore), të fondit leksikor që ishte krijuar në fushën e gjuhës së shkrimit, ashtu dhe nëpërmjet përdorimit të produktivitetit fjalëformues dhe kalkimeve gjuhësore për të plotësuar hallkat e zbrazëta në sistem. "Një shqipërim dinjitoz nga dora e një shkrimtari me sedër, siç ishte Noli, kërkonte ndër të tjera, edhe përpjekje të mëdha gjuhësore, për t'i treguar kështu, në radhë të parë, bashkatdhetarëve se gjuha shqipe ishte e aftë "të matej" edhe me gjuhët më të zhvilluara" (A. Karajdgiu). Për këtë qëllim ai punoi me zell si për zbulimin dhe vënien në përdorim të fjalëve ekzistuese edhe në drejtim të dhënies së nuancave të reja kuptimore këtyre fjalëve dhe çka është më e rëndësishme, në krijimin e një numri relativisht të madh të fjalëve të reja, veçanërisht të sferës abstrakte mendore.

Nuk zmadhojmë asgjë sikur të themi se ndër meritat e mëdha gjuhësore të Nolit është edhe krijimi i fjalëve të reja për të plotësuar mungesat e gjuhës shqipe që në atë kohë po bënte hapa përpara drejt plotësimit të kërkesave leksikore dhe stilistikore të përkthimit të veprave klasike nga më të vështirat e botës.

Krijimin e fjalëve të reja nga Noli e kemi parë në dy aspekte kryesore: në atë të formimit të fjalëve të reja mbi bazën e fondit gjuhësor kombëtar (kompozita, fjalë të prejardhura me parashtesa dhe prapashtesa) dhe në atë të huazimeve nga gjuhët e tjera.

Fjalët e krijuara me materialin gjuhësor të shqipes, janë të shumta e të larmishme. Ato janë fjalë të reja, të formuara në bazë të gjedheve fjalëformuese të shqipes popullore, të cilat janë të kuptueshme për lexuesin më të thjeshtë.

Për të dhënë një pasqyrë të kësaj krijimtarie, po riprodhojmë, të ndara sipas grupeve një numër kompozitash, fjalësh të prejardhura me parashtesa dhe prapashtesa, nga më të rëndësishmet, të cilat janë bërë pjesë e fjalorit të shqipes. [2]

2 Në fund të këtij punimi kemi renditur listat e plota të fjalëve të përbëra e të prejardhura që kemi gjetur në këto përkthime. Përcaktimi se cilat janë të Nolit e cilat të përdorura prej tij, del jashtë kuadrit të këtij punimi. Por të shoqëruara edhe me listat e fjalëve me ngarkesa konotative, frazeologjizmave, barbarizmave dhe arkaizmave, krijojnë një ide të përgjithshme mbi fjalorin e përdorur nga ky përkthyes. Shoqërimi i tyre edhe me ekuivalentin anglisht, është pasqyrë e punës së tij me fjalën.

Kompozitat

Anijebërës - shipwright	Kryemendje - genius
Armëlarë – furbish'd	Mendjeshthurur - madness
Atëvrasje - parricide	Mjekërthinjur - grizzled
Besëplotë - loyal	Rrezekuq – red rays
Faqemvrojtur – tristful visage	Rrobë-çjerrë – wild in their attire
Gojëkyçur – tongue-tied	Syverbonjës – seeling, blinding
Këmbëngulje - stubborness	Shpirtdjall – hellish villain
Kokëtrokë – heavy-headed	Zemërdhembje – heart-ache

Sikurse shihet nga shembujt e mësipërm, si dhe nga listat e plota në fund të këtij punimi, kompozitat e krijuara dhe të përdorura nga Noli, në shumicën e rasteve, janë përcaktore, që është edhe tipi më prodhimtar në gjuhën shqipe. Prof. Shaban Demiraj dallon dy tipa kompozitash përcaktore te ky autor, të cilat në shumicën dërrmuese të rasteve janë një temëshe, kompozita ku gjymtyra e parë përcakton të dytën (kryemendje –genius, kryeshkak – main motive, kokëthatë-barren, kokëngjeshje – obstinante, rrezekuq-redrays) dhe kompozita ku gjymtura e dytë përcakton të parën (perçeegër-monstruous name, shpirtbrumë – peak, syjeshil – green-eyed, sedërplotë-controversy). Pra të dyja gjymtyrët janë produktive në gjuhën shqipe, cilësi kjo që i jep dorë përkthyesit në formimin e një vargu pa fund kompozitash sipas natyrës së gjuhës dhe krijimin e vargut poetik të ngjeshur me ide ashtu sikurse edhe në origjinal. Ndërlidhja e përshtatshme strukturore u jep kompozitave të Nolit unitet theksi e shqiptimi si një fjalë e vetme, si dhe njësi semantike e morfologjike në fjali. Megjithëse ai i bashkon kompozitat me vijë lidhëse, ne i kopjuam ato pa vijë lidhëse, në bazë të rregullit të drejtshkrimit, gjë që pjesërisht është bërë edhe nga botuesit e mëparshëm. Ky ndryshim është i nevojshëm pasi kompozita na paraqitet e njëfjalëzuar. Përkthyesi e ka përdorur vijën lidhëse i shtytur ndoshta nga rregulli i disa kompozitave angleze si life-rending, thick-lips, etj., ose nga praktika e kohës sepse atë e gjejmë tek Kristoforidhi, për të cilin vija lidhëse është rregull në drejtshkrimin e kompozitave, tek Naimi si p.sh. dhembje-madh, mëshirë-shumë, etj., ndërsa gazeta "Dielli' e asaj kohe nuk e përdor vijën lidhëse.

Kompozitat e Nolit në përgjithësi nuk janë idiomatike. Bashkimi i dy ose më shumë fjalëve nuk sjell kuptim të pavarur prej tyre, por jep atë kuptim të drejtpërdrejtë që japin fjalët përbërëse.

"Përkthyesit e Homerit në gjuhën angleze, nga Chapman e më parë, kanë imituar epitetet kompozita të origjinalit dhe pjesërisht nëpërmjet këtij kanali, e pjesërisht në saje të kulturës klasike të poetëve tanë, kompozitat e pasura të greqishtes patën influencë të madhe në poezinë angleze"(Daniel Chandler). Shekspiri shkëlqeu në përdorimin e formimin e shumë kompozitave me finesë artistike të tilla si proud-pied April, a heaven-kissing hill, etj. Kjo është një nga arsyet kryesore pse i gjejmë kompozitat me shumicë edhe tek përkthimet e Nolit. Një arsye tjetër është se ato i kanë dhënë dorë në krijimin e vargut të ngjeshur me ide.

Fjalët e prejardhura

Numri më i madh i neologjizmave të krijuara nga Noli me fondin kombëtar, janë fjalët e prejardhura. Këto fjalë i japin gjuhës një kolorit të veçantë origjinal, që së bashku me veçanësi të tjera të gjuhës së tij, përbëjnë atë që tashmë njihet si stili nolian.

a) Fjalët e prejardhura me parashtesa

Çdëfrim – act of sport	Përshpirtore - requiem
Çligjësoj – outlaw	Përndezje - distemper
Ishmotër – sometime sister	Përnisje - attempt
Mosfjetura - watching	Përqyr - audit
Përfundje - conclusion	I stërbukur – most beautiful
Përfryrë - bombast	Shpëlqej – displease
	Zhbetoj - abjure

b) Fjalët e prejardhura me prapashtesa

Balsamore - balmy	Gazmori - merriment
Barkaris - embark	Gjemboj - sting
Dallgore – flood, ocean	Kremtore - solemn
Derrërisht - swinish	Lundërzoj - sail
Dheshmë (i) - earthly	Mirësoj - improve
Ferrtë (i) – hellish	Nisiot - islander
Fishkëse – wither'd	Smirtar - spiteful
	Zuzarësi – malleco

Si shihet edhe nga shembujt e mësipërm, Noli përpiqet të krijojë fjalë të sferës abstrakte e ideve, sipas modelit të gjuhës shqipe, një gjuhë e pasur me elementë të jetës materiale e shpirtërore.

Parashtesat dhe prapashtesat e përdorura nga Noli në krijimin e këtyre fjalëve numërohen me dhjetëra, por ne përmendëm këtu vetëm disa prej tyre. Por Noli në këto përkthime ka përdorur edhe shumë fjalë të prejardhura të gjuhës shqipe popullore, fjalë të prejardhura të krijuara nga shkrimtarë të tjerë para tij. Përcaktimi i përpiktë se cilat janë fjalët e prejardhura të krijuara nga Noli, cilat i përkasin fondit popullor dhe cilat janë krijuar nga shkrimtarët e tjerë, kërkon një studim të veçantë që nuk i përket këtij punimi.

Sidoqoftë, përdorimi i gjerë i fjalëve të prejardhura e ka pasuruar gjuhën e përkthyesit dhe i ka dhënë mundësi t'i qëndrojë afër origjinalit. Ne kemi mundur të regjistrojmë rreth 90 fjalë të prejardhura të grupit a) dhe 130 të tjera të grupit c), pra fjalët e krijuara e të përdorura prej tij me anë ndajshtesash në këto katër përkthime arrijnë rreth 220. Megjithatë, në studime më të thella në këtë drejtim, mendojmë se numri do të rritet.

Shumica dërrmuese e parashtesave dhe prapashtesave i përkasin fondit kombëtar të gjuhës shqipe, qofshin këto të gjuhës popullore (ç- , pa-, për-) ashtu edhe të gjuhës së kulturës, krijime të mbështetura në gjuhët e huaja (mi-, nënë-, po+emër abstrakt), ndërsa ndajshtesat e huaja që u janë ngjitur fjalëve shqip, si do ta shohim më poshtë, janë fare të pakta.

Parashtesat dhe prapashtesat ndryshojnë nga njëra tjetra jo vetëm nga vendi që zënë në fillim dhe në fund të rrënjës, por edhe nga funksioni dhe kuptimi që i japin fjalës. Prapashtesa, si një morfemë që zë vend në fund të rrënjës, i jep asaj një kuptim të ri leksiko-gramatikor, madje edhe



stilistikor, ndërsa parashtesa, si një morfemë që zë vend në krye të rrënjës, modifikon kuptimin e fjalës dhe nganjëherë, i jep asaj kuptim të kundërt. Këto karakteristika të ndajshtesave që shprehen në gjuhën popullore i gjejmë edhe në neologjizmat e Nolit.

Parashtesat që gjejmë në fjalët e prejardhura të krijuara apo të përdorura nga Noli, janë këto : ç-(çdëfrim); ish- (ishmotër); më-(mëgjunjazi), mos-(mosfjetura); nën- (nënqesh); pa-(pamundur); për-(përgatit); ri-(rindreqje) (kjo është e vetmja parashtesë që kemi hasur); stër-(i stërbukur); z-(zgjeshur); sh-(shburrërroj); zh-(zhbetoj).

Prapashtesat: -ësi (fajësi); -llëk (azganllëk); -të (i befastë); -risht (botërisht); -it (darovit); -nor (dashnor); -ar (detar); -isht (grarisht); -onjës (drithëronjës); -më (i dyshmë); -ëse (folëse); -ak (fluturak); -atë (fushatë); -i (gazmori); -si (gjallësi); -nik (gjysmanik); -tje (këcejtje); -tar (këshilltar); -ore (kremtore); -oj (lartësoj); -zoj (lundërzoj); -os (munxuros); -shëm (i panatyrshëm); -eshë (pëllumbeshë); -uar (i qytetëruar); -atës (strugatës); -ri (shënjtëri); -tirë (shkretëtirë); -im (vjershërim); -imë (vogëlimë); -ris (barkaris); -or (dëshmor); -ushe (djallushe); -aç (frikaç); -esë (ngadhënesë); -ot (nisiot); -me (pritme); -je (rrjedhje); -nkë (rrufjankë); -icë (tokicë).

Siç shihet, në grupin e ndajshtesave, parashtesat janë më të pakta, gjithsej 13, ndërsa prapashtesat arrijnë 42 ose gati katër herë më shumë. Midis të gjitha ndajshtesave gjejmë tri raste hibridesh kur ndajshtesa të marra nga gjuhët e huaja u janë ngjitur fjalëve shqipe, një prapashtesë turke -llëk, e cila është përdorur vetëm një herë, një parashtesë latine ri- e bashkuar me rrënjën shqipe ndreq (rindreq) dhe një prapashtesë sllave icë (tokicë). Me sa duket, në përdorimin e parashtesave dhe prapashtesave, ai e ka plotësuar nevojën me fondin e gjuhës kombëtare dhe nuk ka kërkuar ndihmën e gjuhëve të huaja. Prapashtesa turke –llëk, s'është veç një shkarje, sepse fjala azganllëk është përkthyer më poshtë azganësi.

Huazimet

Admiroj - admire	Grimasë - grimace
Aksident - accident	Imponoj - impose
Altar - altar	Intrigan - intriguer
Ambicioz – ambitious	Kurtinë – curtain
Bandit - bandit	Parullë-parola (watch word)
Deklaratë - declaration	Qashtër (i) - chaste
Dezertoj – desert	Rezolutë - resolution
Difekt - defect	Sfidoj - defy
Dinjitet – dignity	Shpeditë - expedition
Ekzekutoj – execute	Vigjëllor - vigilant

Neologjizmat e sjella në gjuhën tonë nga fondi i gjuhëve të huaja, kanë qenë një nevojë e domosdoshme, pra duhet ta shohim si një meritë të përkthyesit, po aq të rëndësishme sa edhe ajo e krijimit të fjalëve me fondin kombëtar. Në përdorimin e huazimeve, Noli në përgjithësi ka ndjekur disa kritere. Disa fjalë ai i ka marrë në nivelin grafologjik sepse ishin të pranueshme në nivelin grafologjik-fonologjik të gjuhës shqipe p.sh. altar, bandit, fatal, favor, funeral, interval, etj. Një numër fjalësh të tjera ai i modifikoi në bazë të rregullave të fonetikës së gjuhës shqipe si dishtelloj, kerubin, i qashtër, skrupull, shpeditë, shkollar, albastër, këshillë, vëngjillë, vigjëllore, birgjërore, vijtore, etj. Foljet në përgjithësi ai i ka përdorur në trajtën fonetike të gjuhës shqipe si atakoj, ekzekutoj, evitoj, fortifikoj, garantoj, imagjinoj, imponoj, kontribuoj, korruptoj, preferoj, etj. Një pjesë tjetër e huazimeve janë të kryqëzuara, të harmonizuara në formën e tyre me atë të fjalëve shqip. Midis shembujve të shumtë të kësaj kategorie, mund të përmendim fjalët deklaratë, dekoratë, delegat, dispozitë, fortesë, imagjinatë, komunikatë, konditë, konsideratë, pozitë, proklamatë, provizor, provokator, rezolutë, s'lutim, shpeditë, spektator, traditë, etj. Në këtë drejtim, Shaban Demiraj vë në dukje së "duke qenë se fjalët e tipit në shqyrtim (është fjala për emrat që mbarojnë me – ion D.K.), në gjuhë të ndryshme përdoren si emra të gjinisë femërore, që tregojnë më fort rezultat veprimi, edhe Noli i përdori si emra femërorë. Për këtë arsye ai e zëvendësoi fundoren –ion me –ë, që është fundorja më e përhapur tek emrat femërorë të shqipes." (Demiraj)

Pra huazimet nuk janë përdorur në mënyrë mekanike, por janë përshtatur sipas formës fonetike, fonologjike, grafetike, grafologjike, paradigmës ose kuptimit në bazë të rregullave të gjuhës marrëse. Ato janë marrë për arsye se i mungonin gjuhës sonë, janë integruar në sistemin e gjuhës në formë harmonioze, që nuk sjellin asnjë vështirësi dhe elementi i ri është përputhur plotësisht me sistemin e gjuhës sonë. Kjo është arsyeja që një pjesë e mirë e huazimeve të Nolit kanë hyrë në fondin e gjuhës shqipe.

(Vijon në faqen 9)

Disa aspekte rreth romanit *Kishim një ëndërr* (2016) të shkrimtarit Nasi Lera

NJË KLITHMË ARTISTIKE PËR REALITETIN SHQIPTAR

nga Mikel Gojani

Një botë letrare e pasur dhe shumështresore

Nasi Lera është një nga shkrimtarët e spikatur shqiptarë, krijimtaria e të cilit dallohet për humanizmin, për lartësimin e ndjenjave më të rëndësishme, brenda të cilave transmetohet një atdhedashuri prekëse. Nasi Lera nuk bërtet, ai përshkruan dhe komunikon në mënyrën më njerëzore të mundshme. Në letërsinë shqipe Nasi Lera bën pjesë në mesin e shkrimtarëve më të afirmuar, me vlera të mirëfillta poetike. Vëllimet e para me tregime i botoi në vitet në vitet '70, ndërsa romanet gjatë '80 e '90. Nasi Lera është prozator i mirëfilltë, pa bujë e reklamë në letërsinë tonë. po qetë, ngadalë, sigurt. në letërsinë shqipe.

I lindur në Korçë më 22 shtator 1944, aty kreu shkollën fillore. Pastaj do të shkojë në Tiranë për t'i kryer studimet e larta në Fakultetin histori – filologjisë[1], studime, të cilat i përfundoi në vitin 1968.

Pas kryerjes së studimeve, kthehet në vendlindje për të punuar si mësues në rrethin e Korçës, kurse më vonë prapakthehet në Tiranë dhe punon si redaktor në Radiotelevizionin shqiptar. Për shumë vite ka qenë sekretar i Lidhjes së shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë.

Veprimtarinë letrare e ka nisur në vitin 1968, në prag të përfundimit të studimeve. Talenti i tij u dëshmua në fushën e prozës. Botoi vëllimet me tregime "Bora e fundit" (1972), "Era e pishave"(1976), "Nisemi djema" (1977), "Ditë nga ky shekull" (1979. Më 1980 Redaksia e botimeve "Rilindja"[2] botoi një përmbledhje të zgjedhur të tregimeve të tij "Dita e tretë".

Gjatë viteve '80 do të botohen edhe tre libra të tjerë me tregime që mbajnë titujt: "Sytë e dashurisë" (1981), "Duaje emrin tënd" (1983) dhe "Treni ecte drejt dëborës" (1986). Kurse, më 1996 botoi vëllimin me tregime e novela "Ulërimë e heshtur".

Ndërkaq, gjatë viteve '80 e '90, Nasi Lera prozën e tij e pasuroi edhe me zhanrin e romanit. Botoi këto romane: "Gjaku i prillit" (1981),"Të jetosh kohën" (1984), "Orët e qytetit të vogël" 1986, "Balada e vetvetes (1990), "Nata e premierës" (1990), "Ngjallja e diktatorit (1992), "Ana Zh. (1995),"Sytë e Sofisë" (2011), "Njeri pa stinë" (2011), "Të gjallë dhe të vdekur" (2014), që është edhe romani i tij i dhjetë.

Poetika e Lerës është mjaft joshëse

Për prozën e Nasi Lerës është folur dhe shkruara mjaft. Arsyet janë të shumta, sepse poetika e prozës së tij është shumë joshëse, prandaj vazhdon të zgjojë interesime për studime të mëtejme. Nga çfarëdo këndi dhe nga çfarëdo konceptesh teorike letrare që i është qasur, kritika ka hasur aty në një art të madh.

Pra, te kjo prozë kanë hetuar sendërtimin e plotë e konkret të idealit të lartë të artit letrar: t'i shërbejë me përkushtim dhe besnikëri bukurisë artistike e nëpërmjet këtyre edhe bukurisë së jetës.

Romani "Kishim një ëndërr[3]" i Nasi Lerës, botuar më 2016, dëshmoi mirëfilli vlerën cilësore të krijimtarisë letrare në prozën e këtij shkrimtari, gjithashtu njëherësh të prozës romaneske shqiptare në përgjithësi.

Vështruar në këtë kontekst, ky roman arrin majat e vlerave dhe e bëjnë të dallohet nga proza e deritanishme e N. Lerës, por edhe nga ajo shqiptare në përgjithësi.

E para lidhet me shumësinë e shtresëzimeve të ndërliqshme tekstore të romanit, dhe, e dyta, me shtjellime tekstore poetike që rrezatojnë një shumësi domethëniesh, të botës së individit në veçanti e të shoqërisë shqiptare në përthithësi. Këtu kemi të bëjmë dhe me trajtimin shumëplanësh të fatit e të botës shpirtërore e psikologjike të personazheve kryesore, Astit dhe Lora Rebinit. Ata përjetojnë dhe kalojnë nëpër situata të ethshme e dramatike.

Nga teatri i absurdit te absurdi i jetës

Në roman rrëfehet për Astin, regjisori që nuk mundi të vinte në skenë gërshetimin e Çehovit me Beketin, përkatësisht tragjikomedinë çehoviane-beketiane, të vënë në skenë në realitetin e përditshëm nga politikanët dhe politika shqiptare. Femra është viktima e parë e realitetit të tillë. Skenat e veprës gërshetojnë tragjizmin, neverinë realiste, grotesken, komiken dhe dhimbjen e një realiteti që përjetohet çdo ditë.

Romani fillon me hapjen e dyqanit të arkivoleve të Tim Funeralit, i cili lokalin e tij e kishte furnizuar me arkivole dhe kurora lulesh prej letre. Pas një kohe lokalin e mbyll. Në derë ishte vënë lajmërimin bashkë me numrin celular, me qëllim të shitjes së lokalit, mirëpo pothuaj askush nuk kthente shikimin në drejtim të atij lokali pasi që ishte në një pjesë jo të dukshme dhe kishte një ndërtesë të lartë pranë. I zoti i lokalit e humb shpresën që mund ta shiste apo ta jepte me qira. Dikur xhamat e atij lokali i mbuloi pluhuri dhe dikush vizatoi mbi to organin mashkullor dhe dikush tjetër e shkroi parullën: "Rroftë Shën Valentini!" Njerëzve më tepër iu binte në sy dhe i tërhiqnin vizatimi i organit dhe thirrja për Shën Valentinin se sa lajmërimi, "Shitet apo jepet me qira". Pas një kohe ky dyqan u shndërrua në floktore. Hapja e dyqanit më së shumti e gëzoi Gjon Garipin, i cili zuri miqësi me vajzën e bukur dhe ishte në gjendje t'i përcillte edhe gjitha vajzat tjera që vinin për t'u rregulluar. Mirëpo, kaloi shumë kohë, vajza mbylli dyqanin dhe iku për në jug-perëndim. Për një kohë lokalin e mbuloi një heshtje e hirtë dimërore, duke e hapur pas një kohe një burrë hijerëndë, zyrë avokature, i cili pjesën më të madhe e kalonte pranë televizorit, pasi që nuk kishte punë. Kjo zyrë, pas pak kohësh, u mbyll, duke u rihapur prapë më tepër që s'pritej, në agjenci funerali. Njerëzit, të cilët e njihnin legjendën e dyqanit, ishin të bindur se lokali nuk do t'i shpëtojë mallkimit mbi të, ashtu siç nuk i kishte shpëtuar tekniku i frigoriferit, parukerja nga jugperëndimi i vendit, avokati etj.



Asti është një nga protagonistët që mban barrën më të madhe të prozës. Ai kishte krijuar marrëdhënie me Fredin, mirëpo ajo pas një kohe nuk i përgjigjet thirrjes së tij; kishte ndarë mendjen të heshtte, edhe Asti ishte i vetëdijshëm që nuk do të ishte në gjendje t'ia sigurojë një jetë çfarë do t'i pëlqente asaj, sepse ishte një regjisor i dështuar. Projektet, të cilat i paraqiste për realizim, i dështonin një pas një. Momente interesante në jetën e tij paraqet takimi me Ledi B. si dhe rrugëtimi i tij me makinën e saj të një tipi bashkëkohor dhe i po atij viti të prodhimit. Bukuria e Ledi B., e josh Astin.

Asti kishte synim të vejë në skenë Çehovin dhe Beketin; kishte besim se një ditë do të sjellë diçka të re.

"*Nuk Shihja ku po shkoja. Atë mëngjes, nuk mendova për teatrin, nuk mendova as për* Çehovin *dhe as për Beketin, sepse gjithmonë mendoja për të dy: vija në skenë* Çehovin *dhe më dukej sikur vija Beketin ose vija në skenë Beketin dhe më dukej sikur e vija* Çehovin. *I shkëpusja nga koha e tyre, i sillja në kohën time dhe më dukej se të dy i flisnin asaj njëlloj, sikur asgjë nuk kishte ndodhur në shekullin që më ndante nga* Çehovi *dhe në gjysmëshekullin që më ndante nga Beketi. Kur mendoja për ta, mendoja se i ndërronin me dëshirë vendet me njëri-tjetrin. Beketin e luaja në dekorin e* Çehovit *dhe* Çehovin në atë të *Beketit e të dy në dekorin e dhimbshëm të vendit tim. Harrohesha, sikur të ndodhesha në një sallë e të shihja të luhej në një skenë të madhe: në njërën anë gjysmë* Çehovi *dhe në gjysmën tjetër Beketi, por në gjysmën e* Çehovit, *luhej Beketi dhe në gjysmën e Beketit, luhej* Çehovi. *I besoja marrëzisë sime skenike dhe isha i bindur se një ditë do të sillja diçka të re... (f. 28).*

Asti, siç shprehet edhe regjisori vetë, po të mos e kishte këtë besim nuk do të studionte regjisurën. Kur ta kuptonte se nuk do të ishte i aftë të thoshte diçka të re, do të largohej nga teatri, gjë që edhe ndodhi. Dhe ndërsa po ecte, jo drejt një teatri, gjë që edhe ndodh. drejt një institucioni financiar; nuk po ecte si regjisor, por si një personazh i dalë nga një dramë e panjohur, autor i së cilës ishte koha ku ai jetonte.

Autori rrëfen edhe udhëtimin e Astit për në qytezën R. me mikrobusin e vjetër, bashkë me udhëtarët e përditshëm. Zbritja e tij në qytezën tepër të varfër dhe më tepër ia humb shpresat që do të nxjerrë ndonjë kredi. Shpalosen ngjarje e situata të tjera: takimi në bilardo me të çmendurin, i cili aty kishte humbur kredinë dhe kërkonte nga ky që t'i besojë, kthimi me plot dëshpërim dhe dyshimi për të hequr dorë nga kjo punë; takimi me femrën e pamartuar, e cila kishte marrë kredinë për vëllanë dhe djalin e tij dhe mendonte ta shiste shtëpinë dhe të ikën azil. Kredia ishte aq e lartë sa që nuk dinte nëse do t'ia paguanin paratë e shtëpisë. Ikte nga ajo shtëpi, në të cilën kishte dëshiruar të vdesë. Vëllai nuk i

1 Shënimet biografike i mora nga leksikonet letrare e tekstet e tjera. Shih Literaturën.
2 Nasi Lera, *Dita e tretë*. Tregime, "Rilindja" , Prishtinë, 1980.
3 Nasi Lera, *Kishim një ëndërr*. Roman, Botimet LIVING, Tiranë 2016.

kishte prekur kurrë ndonjëherë punë me dorë. Aty do të ndeshim edhe shumë çaste të tjera tepër interesante që për shkak të rëndimit të jetës, njerëzit janë detyruar t'i marrin kreditë. Asti kishte përshtypjen se po jetonte në një kohë më të ashpër se sa në kohën e Çehovit, në kohën e Beketit dhe se ajo që po përjetonte ishte një hakmarrje ndaj vetvetes.

Në roman transponohen një varg dukurish dhe preokupimesh dhe preokupimesh qenësore të njeriut tonë dhe të botës së tij. Kjo shumësi problemesh shprehet nëpërmjet një strukture tekstore të ngjeshur, ku shkrimtari ka lënë vetëm tekstin pa të cilin nuk do të kuptoheshin, të nxiteshin dhe të zhvilloheshin lidhjet e ballafaqimit të dukurive e problemeve, të shqiptohej dhe të krijohej konteksti poetik, që e dallon veprën letrare artistike prej çdo vepre tjetër joletrare dhe joartistike.

Shkrimtari Nasi Lera ka bërë objekt të trajtimi artistik vetëm ato aspekte, dukuri dhe ide që shprehin esenca, që kur ndërlidhen dhe gërshetohen ndërmjet vete brenda strukturës së tillë, shndërrohen në një tërësi komplekse shprehëse e kuptimore, në të vërtetë krijojnë atë sistem kuptimesh nxit dhe krijon në vetëdijen e lexuesit një sistem të ri, të hapur dhe të pambaruar domethëniesh, i cili do të zhvillohet dhe do të pasurohet varësisht nga mundësia krijuese dhe riprodhuese e marrësit që vë komunikim artistik me të.

Në romanin "Kishim një ëndërr" objekt trajtimi bëhet e keqja, e keqja që njeriu i shkakton njeriut. Kjo gjë është konkretizuar e shprehur sidomos nëpërmjet dukurisë së realitetit të rëndë që ka pllakosur shoqërinë shqiptare, dhe ky realitet i rëndë, me zhvillimet e tij deri në tragjizëm, përvetësohet nga forca të caktuara, nuk janë pjellë vetëm e kohës përkatëse, por rrjedhojë e natyrshme e së kaluarës, përtëritje e së keqes në një çast dhe në një vend konkret ekzistimi.

"Romani është një klithmë artistike për realitetin shqiptar. Si një simbolikë e paqëllimtë, duket sikur autori na thotë se i gjithë vendi është një agjenci varrimesh, jo vetëm për njerëzit, por mbi të gjitha, një agjenci ku varrosen Shpresat, Ëndrrat, Dashuria, Mirësia. Asti, regjisori që nuk mundi të vinte në skenë gërshetimin e Çehovit me Beketin, në të vërtetë përjeton tragjikomedinë çehoviane-beketiane të vënë në skenë në realitetin e përditshëm nga politikanët dhe politika shqiptare. Femra është viktimë e parë e realitetit të romanit të Nasi Lerës, siç është edhe e realitetit shqiptar, por pa vënë në grackën e shabllonit joshës të idealizmit dhe viktimizimit të saj. Skena e varrimit në fund të romanit është edhe skena më e fuqishme, sepse gërsheton tragjizmin, neverinë realiste, groteskun, komiken, dhembjen se ajo që lexon, është një realitet që përjetohet çdo ditë nga lexuesi", shprehet shkrimtari dhe kritiku i shquar, Rudolf Marku.

Në roman vështrohen tema nga më nduarduartat, përmes të cilave autori përçon mesazhe tepër interesante.

Po shpalos disa nga ngjarjet që lënë vulën e vet të shtjellimit. Pjesëmarrja e Lora Rebit në pritjen e organizuar të Ambasadorëve, e cila përfaqësonte baknën BesAlb, dhe e cila ishte shkuar në vend të bashkëshortes së drejtorit të bankës. Me këtë rast Lora Rebi ndjehej tepër keq për formën e shkuarjes së saj si zëvendësuese e bashkëshortes së drejtorit të bankës, gjegjësisht pjesëmarrjes së saj pa ftesë në këtë organizim. Në këtë rast kureshtje zgjon edhe ndërtimi i lidhjeve deri nga ato më intime të Astit me Lora Rebin, po ashtu edhe ndarja e tyre. Ndarjes së tyre i paraprinte Balada e Shopenit, dhe sa herë që ata bashkë dëgjonin këtë Baladë, Asti i përkujtonte Lora Rebit, kjo muzikë është një shenjë letrare-gjuhësore e paralajmërimit të ndarjes së tyre. Më pastaj, ankthi i Lora Rebit, ndërsa qëndronte si sekretare e drejtorit të bankës, te drejtori vjen një vajzë e re dhe simpatike. Qëndrimi i gjatë i vajzës simpatike te drejtori, shkaktoi nervozizëm dhe ankth te sekretarja, sepse ajo vonesë e bënte të dyshonte. Më tepër e rrënonte shpirtin e saj të trazuar, ishte qëndrimi i drejtorit, i cili këtë nuk e priste me buzëqeshje, por me shumë indiferentizëm.

Kapitull mjaft interesant dhe që shpërfaq shumëçka që vë në pah të vërtetën, është mbajtja peng e qenies njerëzore nga ana e atij realiteti të egër, që shpie deri në zhbërjen e substancës së dinjitetit njerëzor. Vjen një ngjarje tjetër, kur gjatë kohës së natës, drejtori i bankës BesAlb bën një udhëtim intrigues me sekretaren, e cila nuk kishte njohur qëllimin e shkuarjes dhe kufirin e atij vendi ku do ta shpinte eprori i saj. Udhëtimi zgjat deri në orët e vona të asaj nate që i zë në Strugë dhe vendosja e tyre në një hotel. Po ashtu, edhe varrimi me muzikën e Enio Morikones, të Z. A., të cilin e kishin vrarë brenda makinës, duke e hedhur në erë me tritol, paraqet një shembull autentik të tragjizmit që sjell realiteti përkatës i kohës.

Në roman frekuentojnë shumë protagonistë, si Asti, Lora Rebi, Tim Funerali, Helga, Drejtori, Z.A. Vejusha e bukur, Skënder S. Këto personazhe kanë në vete një shumësi kuptimore. Në këtë mënyrë personazhet shprehin raportet shoqërore, përkatësisht mungesën e individualitetit të tyre, zhgënjimin, poshtërimin, shpirtvogëlsinë etj. Secili prej tyre kanë në vete një përmasë të tragjikes së kohës dhe të marrëdhënieve në të cilat jetojnë. Sidomos personazhet si Asti, Lora Rebi, drejtori i bankës BesAlb, ngërthejnë një botë komplekse.

Mbi bazën e perceptimit të këtillë të çështjeve dhe të dukurive të ndryshme, nga qenësia e përvojës së realitetit ekzistues, Lera krijon një realitet artistik të papërsëritshëm.

(Vijon nga faqja 7)

Barbarizmat

Advantë - advantage (dobi)	Frankërisht – frankly (shkurt e qartë)
Avar – avaritious (lakmitar)	Inklinatë – inclination (prirje)
Bush – bush (kaçubë)	Kungjëroj – conjure (ysgt, nxis)
Karnal – carnal (mishëror)	Leftenar – lieutenant (toger)
Kastigim – castigation (qortim)	Ominoze – portentous (ogurzezë)
Kompas – mute (figurant)	Përmetoj – permit (lejoj)
Cirkonstancë – circumstance (rrethanë)	Prodige – prodigal (plangprisës, i papërmbajtur)
Digjëroj – digest (tres)	Punit – punish (dënoj)
Diskrecion – discretion (urtësi)	Rovinë – rovinare (rrënim)
Faca – face (fytyrë)	

Sikurse shihet nga shembujt e lartpërmendur si dhe nga lista e plotë e barbarizmave në fund të këtij punimi, përkthyesi nuk i ka respektuar rregullat e huazimit, siç ka vepruar me huazimet e lartpërmendura. Këto fjalë ai i ka marrë nga gjuhët e huaja pa pasur asnjë nevojë për to, sepse për të gjitha ka pasur fjalë shqipe të bukura e të njohura prej tij, dhe ndonëse është përpjekur t'ua zbutë pamjen e huaj dhe t'u japë trajtat e gjuhës amtare, lexuesi ka vështirësi t'i kuptojë dhe populli nuk i ka përvetësuar, sepse nuk i janë dashur, kështu që ato nuk zënë vend në sistemin e gjuhës sonë. Vjen pyetja, pse e ka bërë Noli këtë? Duhet pasur parasysh se në kohën që janë bërë këto përkthime, kishin ndryshuar konceptet gjuhësore të Naimit, Samiut e Kristoforidhit, të cilët ishin përpjekur që t'i zgjidhnin mungesat leksikore të gjuhës sonë brenda përbrenda fondit të saj dhe kishte filluar të përhapej një rrymë e re intelektualiste për ta pasuruar gjuhën me sa më shumë fjalë të huaja (periudha 1912-1944, Sh. D.) Noli, deri në një farë mase, nuk i shpëtoi kësaj rryme. Ai që punonte me gjuhën anglisht, e cila 70% të fjalëve të veta i ka të huajtura nga gjuhët e tjera, ndoshta nuk shihte ndonjë të keqe në pasurimin e gjuhës shqipe me fjalë aksidentale. Prandaj ai "nuk mund t'i shpëtonte kësaj rryme të kohës" (A. Karajdgiu). Për sa u përket fjalëve turqisht e arabisht, me të cilat ishte molepsur gjuha shqipe dhe me të cilat i ka mbushur vjershat e tij origjinale (natyrisht për efekte satire e humori), në përkthimet e Shekspirit është treguar shumë i kursyer. Rrallë tek hasen turqizma dhe ato që hasen, si *senet, befa, tabor*, etj., janë përdorur për të plotësuar mungesat e gjuhës, sepse këto fjalë, kanë qenë më të kuptueshme për publikun se sa zëvendësimi i tyre me fjalë perëndimore.

Megjithëse barbarizmat në përkthimet e Nolit janë një fakt i pakundërshtueshëm, numri i tyre është relativisht i vogël. Barbarizmat e tij që janë regjistruar në të katër veprat e përkthyera, nuk e arrijnë qindin, që i bie rreth 20 për çdo vepër. Për sa u përket huazimeve në përgjithësi, Noli herë herë i ka shkelur normat, por në analizë të fundit, ai është treguar më shumë purist se dorëlëshuar.

Drejtshkrimi

Në qoftë se drejtshkrimin e Nolit do ta gjykojmë në planin sinkronik, do të gjejmë ndryshime të shumta jo vetëm në çdo faqe, por edhe pothuajse në çdo rresht. Por atë duhet ta gjykojmë në planin diakronik, d.m.th. ta shohim me syrin e kohës në të cilën është shkruar dhe jo ta krahasojmë me drejtshkrimin e sotëm. Që gjatë rilindjes e më tej, koineja letrare jugore përforcoi, plotësoi e zgjeroi më tej tiparet e njësimit të gjuhës së shkrimit. Në kohën kur shkroi Noli, kemi pothuajse të formuar normën njësore të koinesë së jugut. Megjithatë, kur studiojmë gjuhën e tij, nuk mund të mos i vemë re format arkaike që ka pasur gjuha e shkruar e koinesë jugore në atë kohë dhe nuk mund të mos i përmendim ndryshimet e shumta drejtshkrimore që ndajnë dy periudhat.

Noli i përdor shumë apostrofat. Pothuajse në të gjitha fjalët që përfundojnë me zanore dhe pasohen nga një zanore tjetër, qoftë kjo lidhës apo fjalë tjetër, ai e heq zanoren e parë dhe e zëvendëson me apostrof. Ai shkruan *m'e vogël, mund'në fund, e marrt'e mira, q'e ka mësuar, mburrj'e zbrazët, t'm'a lanje, do t't'a thom, nj'a tre togje, koh'e gjyqit, an' e mba'në, zotërinjt' e mi, n'arrati, t'an'e saj, ng'an'e veshit, mjer'ay, mënj'anë*, etj. Rreshtat e tij janë të mbushur me apostrofe që ndjekin njeri tjetrin. Edhe trajtat *m'a, t'a, t'i*, ai i shkuran me apostrof. Shumë fjalë të drejtshkrimit të vjetër duken anakronike për lexuesit e sotëm. Kështu p.sh., Noli shkruan *njerës, theori, pllane, luftare, thom, munt, ment, shigur, shqoj, i nderçim, funt, liksht, nukë, balla, arthtë, sonde, dolla, urdhërë, i kottë, të ratë, rezik, patmë, kujdese, ay, përgjakshim, rop, trek, tjatri, këputhra, pralla, tent, farmaq, mëngjest, lint*, etj. Një pjesë të madhe të fjalëve që drejtshkrimi ynë i shkruan me *sh*, Noli i ka shkurar me ç, si çpërblen, i nderçim, i çkoqur, i përnderçim, çpagoj, çmuar, çnderoj, çpojtje, munç, etj. Një sërë foljesh të kohës së tashme e të pakryer që mbarojnë me *j*, Noli i shkruan sipas dialektit toskë të asaj kohe me *nj*, si *bënja, sqonj, shkonj, guzonj, tregonj, mundonj, vinj*, etj. Gjithashtu Noli e përdor shumë vijën lidhëse. Kështu p.sh., ai shkruan *krye-unjur, gojë-ndyrë, sqoj-e, ndiz-i, lësho-i, mërzit-e, u-sqo, ime-bijë, jote-bijë, im-zot, beso-më, im-vëlla, me-zi, u-nis, u-poq/u-bë, shpjer-i, thua-na, im-më, përdor-e, çaj-i, sill-i*, etj. Mbaresën *–i* të foljeve të zgjedhimit të parë, në të kryerën e thjeshtë e jep me *-nj*, sipas parimit fonetik, ashtu si edhe autorë të tjerë para tij, p.sh., *tradhtoj* për *tradhtoi, çpagoj* për *shpagoi, përhiroj* për përhiroi, fitoj për *fitoi,* etj.[3]

Natyrisht, në rrethanat e kohës kur shkruan Noli, ishte objektivisht e pamundur që ai të shmangte trajtat me karakter dialektor. Kështu p.sh., ai shkruan çlironjës, i panatyrtë, i *pashpirtmë, shpërblerë, i zakontë, i armatisur, i shpejtmë, u poqnë, shpeditë, thirmë, mbetmë, shkelë, dyke mejtuar*, etj.

Të gjithë shembujt e lartpërmendur nuk tregojnë aspak dobësitë drejtshkrimore të përkthyesit tonë, por zhvillimin e natyrshëm të gjuhës shqipe. Madje mund të themi se në krahasim me autorë të tjerë të kohës së tij, Noli përdori "një drejtshkrim sa më të qëndrueshëm dhe forma gramatikore sa më të përbashkëta duke i dhënë gjuhës së tij një karakter sa më të njësuar" (Sh. Demiraj). Pra gjuha e Nolit është më e afërta me shqipen e sotme të njësuar. Ndryshimet e drejtshkrimit në krahasim me drejtshkrimin e sotëm të njësuar nuk janë të mëdha dhe mund të zëvendësohen lehtësisht në botimet e ardhshme. Drejtshkrimi i tij praktikisht nuk shkakton ndonjë keqkuptim për lexuesin, as e vështirëson perceptimin e kuptimit, as e dëmton vlerën artistike.

Duke soditur panoramën gjuhësore të Nolit dhe duke e krahasuar atë me gjuhën e pasur me format e ndërlikuara të gjuhës së Shekspirit, studiuesi del me përshtypjen e një beteje të fituar. Kushdo e kupton se kur filloi përkthimin e kryeveprave të Shekspirit, Noli ka ndeshur probleme gjuhësore tepër të vështira. Nga këto katër përkthime të marra në analizë, rezulton se Noli është ndër lëvruesit më në zë të gjuhës shqipe.

Përvoja e pasur gjuhësore e shkrimtarëve të shquar rilindës përpara tij, përrallat, legjendat, këngët popullore që ishin burim i pashtershëm për leksikun e tij dhe që gjejnë pasqyrim të thellë në të shprehurit e mendimeve, e ndjenjave, me një forcë për herë më të madhe, na krijojnë bindjen se përkthyesi zotëronte kulturën humanistike të kohës, bashkuar me një njohje të plotë të ligjërimit të vendit.

Pasurinë e madhe gjuhësore të Shekspirit ai u përpoq të na e jepte nëpërmjet një verbi energjik, e në më të shumtën e rasteve, ia doli mbanë. Për këtë ai bëri edhe një punë të madhe hulumtuese e krijuese në gjetjen e mënyrave dhe mjeteve për pasurimin e saj të mëtejshëm, sidomos me elementë të sferës abstrakte, dhe me këtë i bëri një shërbim të madh gjuhës amtare. Në të njëjtën kohë, ai e vuri gjuhën shqipe në një shkallë të barabartë me gjuhët e zhvilluara të Evropës.

Meritë tjetër e tij është se ai diti të zgjedhë fjalët në një kohë kur, me përjashtim të fjalorit shqip-greqisht të Kristoforidhit, nuk kishte fjalor për të qenë shqip-shqip, ose anglisht-shqip, ose gjuhë e huaj-shqip. Përkthyesi më i thjeshtë e di mirë se çdo të thotë t'i hysh punës së një përkthimi madhor pa fjalor të gjuhës amtare.

Me gjuhën e tij të pasur, Noli "ka dhënë një kontribut të madh në përmirësimin e frazës shqipe. Ai ka arritur që mendimet dhe ndjenjat e thella të veprave të përkthyera dhe origjinale, t'i paraqesë me një frazë mjeshtërisht të përpunuar, ku krahas saktësisë dhe larmisë së ndërtimeve sintaksore, bie në sy edhe rrjedhshmëria, edhe eleganca e të shprehurit si dhe përdorimi mjeshtëror i mjeteve të larmishme stilistike" (SH. B.). Përgatitja e tij e thellë estetike e gjuhësore pasurohet me përgatitjen e tij në fushë të stilit, disa elementë të të cilit analizohen në një shkrim tjetër.

3 Të gjithë shembujt e mësipërm janë marrë nga "Tragjedia e Othellos", shtypur në Boston, Mass, 1916.

Përmbledhja e parë me tregime e prozatores Ornela Musabelliu

“Trëndafila dhe qiparisa”: Eksplorim mjeshtëror i njerëzores

nga Arbër Ahmetaj

“Frika! Frika! Frikë nga merimangat, frikë nga rrjetat e pasigurive, frikë nga... frikë se u dashurova edhe me mungesën sa me prezencën e tij, me hijet sa me dritën e tij, me tradhtinë po aq sa me besnikërinë...”
“Buzëqeshja jote - varreza e hirtë e fjalëve të mia.”

“Trëndafila dhe Qiparisa” është përmbledhja e parë me tregime e prozatores Ornela Musabelliu. Emri i saj ka qenë prezent në shtypin letrar që nga fundi i viteve ’90, ndaj dhe ardhja e saj me këtë vëllim tregimesh është bërë natyrshëm.

Tridhjetë e gjashtë tregimet e këtij libri tregojnë qartësisht pjekurinë e saj si tregimtare dhe një autore që i njeh mirë kodet narrative, arkitekturën e tregimit, njësinë e kohës, gjeografinë dhe aksionin, si dhe ngritjen progresive të tensionit dramatik brenda tekstit. Te disa prej tregimeve, mbyllja është aq e papritshme sa të krijon përshtypjen e gabuar se spontaniteti i rrëfimit është diçka e lehtë për t’u arritur, ndërkohë



që, në të vërtetë, kërkon një mjeshtëri të jashtëzakonshme dhe dedikim.

Ka tregime, si: “Zemërimi”, ku duket sikur nuk ndodh asgjë, përveç një ndezjeje të brendshme, brejtjeve psikologjike të personazhit, që e ka të vështirë të pajtojë natyrën e lëkurës së vet, por ndez mijëra llamba alarmi përmes të cilave sheh botën përreth si një kërcënim të vazhdueshëm. Ekzagjerimi i egos së brendshme gjendet edhe në tregime të tjera, si: “Dua më shumë”, por me natyrë e përmbajtje krejt tjetër. Kjo gamë rrëfimesh tregon se luhatje të tilla psikologjike, kur shkruhen me mjeshtëri, sjellin gjendje me të cilat lexuesi identifikohet lehtësisht.

Një pjesë e madhe e interesimit të autores përqendrohet në subjekte që duken si “të huaja” për moshën e saj. Shumë tregime, si: “Këpucët”, “Trëndafila mes qiparisave”, “Pritja”, “Zonja Ryjkebys”, “Kujdes çfarë dëshiron”, “Komoja e plakushit”, “Çifti”, etj., kanë në përmbajtje problematikat e perëndimit të jetës, e moshës së njeriut, mënjanimit dhe vetmisë. Sidomos vetmisë, kjo diagnozë vdekjeprurëse, jo vetëm fizike, por shkatërruese edhe nga pikëpamja psikologjike, para se trupi të dorëzohet.

Musabelliu sjell me përkujdesje subjekte dhe personazhe melankolike e realiste, burra dhe gra, që pas një jete të tërë, ku kanë dhënë gjithçka për shoqërinë, përballen, përveç me gjëra të mira, si: sjelljet njerëzore me ta, përkujdesjet e vogla, gëzime dhe përjetime emocionale që hijeshojnë jetën e tyre, edhe me frikën dhe ankthin që ndjell afrimi i fundit. Te “Pritja” dhe “Çifti” kemi, përveç notave të theksuara humaniste, edhe një bashkëngjitje prekëse emocionale mes çifteve të moshës së tretë, ndërsa tek “Tatuazhi” i jepet rëndësi asaj që mund të quhet “lehtësia e domosdoshme e të pranuarit të moshës”.

Aty-këtu, autorja sjell grimca të shndritshme të fëmijërisë dhe rinisë, që kanë mbijetuar në shpirtin e këtyre burrave dhe grave të moshuar, duke kujtuar lexuesit se personazhet e saj kanë qenë të rinj para nesh dhe dinë një a dy gjëra më shumë për jetën.

Histori të mrekullueshme, po aq të trishta dhe ankthndjellëse, të afta të sjellin përjetime të cilat, prej vetë natyrës dhe errësirës së tyre vetmitare, janë të vështira për t’u përshkruar në tekste letrare, vijnë përmes tregimeve: “Dënimi”, “Lidhëset” dhe “Përdhunimi”. Misteri i vuajtjes dhe së keqes, fataliteti i qenies sonë si vdekatarë, dështimet dhe arritjet, ato shkëlqime të rralla emocionesh të dashurisë dhe përkujdesjes mes njerëzve, i japin jetës së personazheve arsye për të vazhduar.

Të tjera tregime përshkohen nga një lirizëm i thellë, që vjen përmes regjistrash të ndryshëm shkrimi, shpesh përmes afirmimit të lirisë individuale, por edhe ankthit që ngjall rrjedha e pamëshirshme e kohës apo ndonjë kujtim shkatërrues nga fëmijëria, si tek tregimi “Dita e Nënës”. Në disa raste, përmes një vegimi ëndërror, që vështirë se mund të pranohet si realitet i përjetuar, vijnë në tekst pasione përvëluese të cilave u jepet jetë veç në fantazi, si tek “Të panjohurit”, “Shën Valentini i kuq” dhe “Punishtja”.

Ajo që bie në sy në këto tregime është se shumë prej tyre duken sikur e kanë nisjen te një ngjarje e zakonshme dite - një ndarje, një aksident, një vrasje, një vizitë në varreza - por autorja e ka kapërcyer “zakonshmërinë e padobishme” të këtyre subjekteve dhe ka krijuar personazhe me individualitet të skalitur, me përjetime dhe pyetje të thella, që veprojnë me një natyrshmëri shpartalluese, larg çdo manjerizmi apo artificialiteti emocional.

Një fëmijë i dënuar, i mbyllur në banjë, të moshuar që s’dinë si t’ia bëjnë me ditët e vetmisë, njerëz të frustruar prej shpirtvogëlsisë, burra dhe gra në kërkim të pasioneve frymëzuese apo të lodhur prej marrëdhënieve që stërgjaten pa kuptim; një çift që zgjohet në një dhomë hoteli dhe secili për vete përpiqet të kuptojë se si ka përfunduar aty, apo dy tjerë që gabojnë tubetin e lubrifikuesit me një ngjitës, një vrasëse merimangash dhe një maniak i gjuhës shqipe, një vajzë që merr një të fejuar me qira, skenari “live” i një filmi që shkruhet dhe luhet në të njëjtën kohë, me pasoja tragjike, një vajzë që s’e kupton pse ka aq dhunë në familjen e saj dhe kërkon paqe në një shëtitje mes varresh; oborri i zonjës Ryjkebys, që hutohet nga zërat gazmorë të dy vogëlushëve dhe dhjetëra personazhe dhe rrëfime të tjera, që shpesh i afrohen fantastikes, të habitshmes, magjikes, pa iu larguar me ulërima realitetit të përditshëm.

Nga ana gjuhësore libri është, ndër më cilësorët në letërsinë e sotme shqipe, ku shfaqet edhe mjeshtëria e autores si redaktore e talentuar letrare, në botimet shqipe sot. Retorika nuk është aspak artificiale; dialogjet janë të natyrshme dhe gjuha e personazheve i shkon përshtat kastës, moshës dhe kultivimit nga vijnë.

Një pjesë e tregimeve janë metafora brenda metaforash dhe veç një lexim i vëmendshëm të bën të kuptosh se rrëfimi nuk është i rastësishëm, por i qëllimshëm e i strukturuar me durim, për të shmangur gjithçka që nuk i duhet tekstit.

Ky libër që do të merrni në dorë, do t’ju marrë për dore në një udhëtim ku do gjeni edhe veten.

“Trëndafila dhe Qiparisa”, tregime, Ornela Musabelliu, “RL Books”, Bruksel, 2024, ISBN 9782390690290

Vëllimi poetik i poetit qipriot Mehmet Jasin, "Engjëj hakmarrës" i sapobotuar në shqip, na kujton edhe një herë rolin e fuqishëm të vendlindjes në ndikimin poetik, si materie dhe si formë.

Poeti qipriot na kujton gjithashtu se ka lindur i rrethuar nga ujërat mesdhetare, mes qerthujve të ekzileve të vazhdueshme, ku jetë e mot si edhe ai vetë janë përfshirë edhe shqiptarët, derisa të na nxitë edhe për një pyetje tjetër, si të shqyer vetë prej fjalës vendlindje. Sa herë lind njeriu?

Para sa e sa vitesh më ka bërë shumë përshtypje një varg i poetit Adonis, i cili thotë se e ardhmja është e kaluara jonë. Dhe nuk është fjala për forcën thithëse që kërkon e gjithë e kaluara historike në jetët njerëzore. Është fjala për njeriun e përbërë në formë kujtimi. Në rastin e poetit Mehmet Jasin, e gjithë vendlindja e tij vazhdon të jetojë në formë kujtese. Dhe kujtesë nënkupton edhe praninë e një gjendjeje të re, në një lloj lindjeje tjetër, ku poezia ripërtërihet vazhdimisht, duke krijuar një zhvendosje të vazhdueshme, qoftë nga pasurimi i përvojave. Po t'i referohemi qoftë çdo poezie të kësaj përmbledhjeje, do të gjejmë gjithë ato rizbulime të reja të një të kaluare, që edhe në kujtesë vazhdon të krijojë një udhëtim të pafund. Dhe kjo tregon se diçka ka ikur njëherë e përgjithmonë, ose rrëshqet pa mbarim edhe në jetën e çdo njeriu. Dhe kjo gjendje bëhet e dyfishtë për poetin që është tronditur deri në identitetin e vet, të cilin e mbart kurdo e kudo me vete për të sfiduar madje edhe rrugën drejt vdekjes. Dhe kjo nuk është thjesht kënga e njeriut në ekzil, por vazhdimi i një ekzili të përditshëm, nga një poezi në tjetrën, deri në largimin e pafund. Për një poet mesdhetar, gjithë ky udhëtim përmban gjithashtu një peshë kulturore me lashtësi të ndritshme. Petro Çerkezi, përkthyesi i poetit Mehmet Jasin në shqip, thekson se poezia e Mehmet Jasinit mund të quhet si poezi e banuar nga fantazmat. Atëher edhe më shkurt mund të thuhet, se atje ku ka dhimbje, ajo jeton vetëm nëpërmjet dashurisë. Kur lexon poezitë e Mehmet Jasinit, gjen shumë Qipro, sepse Qiproja është dashuria e tij e parë dhe ndoshta e fundit. Lexuesi shqiptar, si mesdhetar mund të gjejë edhe shumë Shqipëri brenda. Poezisë së këtij poeti, të formuar në një Mesdhe të përbashkët, ku kulturat hapen dhe harlisen për t'u ngërthyer me njëra-tjetrën, në rastin e Qipros edhe në tragjedi më të afërta përplasjesh.

Hurmat që pikojnë mjaltë, tapetet e gjelbra të lutjes që fluturojnë drejt nesh nga shkretëtira të largëta, hurma, hurma, hurma, këndon poeti në poezinë kushtuar kësaj peme, dhe e gjithë kjo për atë vetë si kujtim. Për ne si një farë gjendje e paketuar. Dhe duket sikur poezia ka lindur që asgjë të mos humbasë. Për të këqyrur më mirë poezinë e Mehmet Jasinit, mund të ndajmë më dysh edhe gjendjen e vendlindjes poetike në ndryshim të vazhdueshëm nëpërmjet humbjeve, ku në lidhje me krijimin, fjala lindje triumfon. Mund ta lëmë poetin edhe vetëm me lindjen e një gjendjeje të re poetike që shfaqet në çdo poezi, në atë logosin poetik ku, nga "çfarë" e një vendi të përcaktuar, gjithçka kthehet në "si", atje ku ngacmimi poetik, nga frymëzimi embrional, si filli që i jep fjalës frymë, njësoj si majaja bukës, sjell një botë njerëzore jashtëzakonisht të përcaktuar dhe të mbushur plot jetë, që përsëri është dashuri përderisa ka dhimbje. Ky është vetë udhëtimi më i brendshëm poetik, që e çel poezinë si çelet një lule nga të cilat do të mbillen farat sa herë hapësira hapet. Në nënshtresëzime të tilla, edhe vete brenda një çasti a një jete, diçka humbet pa pushim. Nga cikli "Këngët e vjetra të Neapolit", midis përjetimeve si kujtim, si kumbime tik, tak, që janë të reja edhe gjyshja thotë, "si për të krijuar vetë thellësi të tjera të kujtesës nëpërmjet humbjes, a sikur të me shihje më të re."

Vëllimi poetik i poetit qipriot Mehmet Jasin, "Engjëj hakmarrës", botuar nga"Neraida"

Rreth vetmisë bashkuese të një poezie të sapombërritur në shqip

nga Natasha Lako

Kujtimet krijojnë atë rrëshqitje të vazhdueshme drejt një udhëtimi të ri, si në poezinë 'Shtëpia e vdekur'. Ka mbetur në kujtesë "Muri i zbardhur atje ku dikur qëndronte ora / tavolina prej arre e harruar nga koha." Mespërmes kësaj kujtese të ngrirë, siç e quan ai vetë në një poezi, lëvrin një kujtesë tjetër që sjell thellësi të tjera, shfaqet makina e shkrimit ku i ati ka daktilografuar poezitë e para, plaçkitja e pajave të ruajtura në sëndukë otomanë, "pasqyrat, pasqyrat që mbulonin fytyrat me çarçafë", atje ku jehon histerike e qeshura e luftës.

Ekzil i kujtesës nga shtëpia e vdekur, deri në thellësitë edhe më tragjike, derisa. si thotë vetë poeti, lind, si gjendje e re edhe mbi shtëpinë e vdekur vetëm poezia. Dhe le të kujtomë se edhe vetë vendlindja edhe fjalën lindje e lë si gjymtim, në formë më të vetmuar, humbjeje, ose largimi, si përpjekje për të zënë një tjetër vend, dhe një tjetër "lindje".

Po ka edhe një ikje a tjetër ekzil, si në poezinë për tezen. "Çuditeshim ku e gjente një energji të tillë si të diellit, herë si dhi kokëfortë, herë duke shpërthyer në të qeshura pa asnjë mbrojtje tjetër." Dhe mandej, ky shpërthim i së qeshurës për një lumturi "kalimtare", si thotë poeti, fjalë e ndarë kjo nga gjithë të tjerat, në vendosjen poetike brenda poezisë. "Vallë çfarë mund t'i mësojë njeriut vetë e qeshura," i drejtohet poeti në poezinë e tij "Alpinisti" një djaloshi, që merr rrugëtimin klandestin që nuk do të mund t'i japë më një Itakë. Kështu gjendjet njerëzore u ngjajnë galaktikave, që përpiqen të ruajnë të paktën ligjet e gravitacionit, nëpërmjet kujtesës.

Nga kjo kujtesë në poezinë e Mehmet Jasinit lind një galeri e tërë personazhesh, që nga ky djalosh që nuk e gjen më Itakën deri te Shën Pjetri, te Mustafaj dhe Marika, ku dashuria nuk pyet për ndarje dhe diferenca, por për zambakë, më të mbifuqishëm se gjithçka. Ne shpeshherë druhemi ta quajmë poezinë të drejtpërdrejtë, pikërisht për shkak të këtyre thellësive, që ajo ruan dhe njëkohësisht zbulon, ndonjëherë e përmbushur me arabeskat figurative që hapin udhët. Por suksesi i parë i poezisë së Jasinit është vështrimi njerëzor i kohës ku jetojmë, vështrim që kaq drejtpërdrejt mban gjallë këtë galeri njerëzore në gjendje të kthyera në zhgjendje.

Nga kjo drejtpërdrejtësi si gjendje e re reale poetike, e ngjizur një herë e mirë, lind në poezinë e poetit vetë hapësira e madhe e dashurisë njerëzore që në një botë kaq të pasur nuk mund të rëndohet nga paragjykimet dhe që shpreh atë pjesë qipriote që i takon të gjithë botës. Dhe

lexuesi i kudondodhur e kupton shqetësimin, hallin dhe mbi të gjitha dashurinë, kaq vetjake, kaq të profilizuar, ku vetëm kaq kuptuarshmërisht kemi mundësi të qëndrojmë pranë njëri-tjetrit. Sepse nëpërmjet poezisë bota njihet, jo nga hartat, por nga shpirti njerëzor. Kësaj radhe, nën përkthimin e Petro Çerkezit kjo poezi vjen në gjuhën shqipe, në këtë truall që kulturalisht sfidon moskuptimet njerëzore, të cilat në Qipro ka ndodhur të kenë ngritur edhe karakollë të rinj ushtarësh, për të mos folur për të vrarë, të ngrirë në kujtesë, në vetminë e tyre, po aq të ngrirë.

Mali është më i fortë, ti je më i fortë se mali, i ngurtë, si vetmia, thotë poeti në poezinë "Alpinisti". Në poezinë "Personi i tretë" ai këndon: "dhe shirat zbresin të dashurohen nëpër ujëra me Kashtën e Kumtrit që i mbulon si vello dasme." Po, edhe ne shqiptarët gjendemi në Mesdheun edhe të këtij poeti, të përkthyer në gjuhë të ndryshme.

Dhe më në fund lipset t'i kthehemi edhe vendlindjes së Petro Çerkezit, përkthyesit të këtij vëllimi, që ka ruajtur në ekzilin e tij, së bashku me kujtimet e qytetit të Gjirokastrës edhe letërsinë e tij, të shoqëruar me kthjelltësinë e ujërave të Vjosës, me të cilat vezullon edhe kthjelltësia gjuhësore, e mbushur plot dritë të gjuhës shqipe në rastin e këtij përkthimi.

Mehmet Jasın lindi në lagjen Jenisehir në Nikosia nga prindër turko-qipriotë.

Ai u largua nga Qiproja në moshën 17-vjeçare dhe shkoi për të studiuar në Turqi, në Universitetin e Ankarasë dhe atë të Stambollit. Kreu studime pasuniversitare në Angli, Francë dhe ShBA.

Poezitë e para i botoi në vitin 1979 në revistën turke Vepra artistike dhe libri i tij i parë me poezi Ushtar i vdekur dashuria ime u vlerësua nga kritika dhe u nderua me Çmimin e Poezisë të Akademisë së Turqisë dhe me çmimin A. Kadir, por u ndalua për shkak të "përmbajtjes së tij të rrezikshme".

Vepra e Jasinit shpesh përmban temën e humbjes.

Në vitin 2002 botoi poezi në gjuhën turke.

Librat e Jasinit janë përkthyer në më shumë se 20 gjuhë dhe poezi të tij janë muzikuar në Qipro, Turqi, Britaninë e Madhe dhe Holandë.

MEHMET KRAJA

Bindi

tregim

Johan fon Bergmanin nuk e pa askush nga ne, kur arriti në Tivar me tri mushka ngarkuar. Ai u shfaq te Hani i Nënkalasë disi befas dhe nuk u kuptua se nga cila anë e natës u fut aty. Mushkat i shkarkuan dy burra që erdhën me të dhe po ata dy burra na e banë me dije se zotëria i tyre, ngado që shkonte, mbante me vete ca arka me shkresurina dhe një krevat me susta. Shkresurinat i shkruante vetë dhe vetë i lëçiste, kurse krevati nuk i shërbente për asgjë, sepse ai nuk flinte kurrë. Asnjëherë? Asnjëherë, pra!

Nuk e kuptuam, po ashtu, pse Sani Kaduri, këngëtari dhe rapsodi i qytetit, që këndonte me zë të hollë dhe i binte qemanes, atë natë këndoi deri në mëngjes një këngë të vjetër zamani. Dheu i zi, aman, pse nuk m'tret ma shpejt! Kënga e Sani Kaduri shpërndahej nëpër natë dhe dvarej pa gjurmë, kurse gjëma e nëndheshme e të vdekurit nuk ikte gjëkundi, rrinte aty, në çdo qoshe të territ, në çdo pikë të shiut, si ai malli i përjetshëm që nuk mbaronte asnjëherë, duke bërë që nata të ndalej mbi Kala dhe me përmallim ta shikonte atë pjesë të botës, të zhytur në një pikëllimë vetmie. Po zotnia, pse nuk fle kurrë?

Që nga ajo natë dhe disa muaj që erdhën pastaj, Sani Kaduri dhe Johan fon Bergmani nuk u panë të ndaheshin nga njëri-tjetri. Në të vërtetë, ngjau që atë mëngjes, akoma pa zbardhur, kur Sani Kadurit i shkrepi të këndonte këngën për dashurinë e humbur, në derën e plemes u shfaq Johani trupgjatë dhe disi i nëpërdukshëm, si të ishte një hije e natës së shkuar. Nuk dihet se çfarë folën mes veti Johani dhe Sani Kaduri, por ne të kalasë, dy ose tre sahat më vonë i pamë që të dy tek rrinin në një shkëmb mbi Përroin e Bindit. Ky Johani, aty nga dreka u kthye në han dhe që andej mori gjyzlykët me kornizë floriri, letër dhe mereqep dhe, pak më vonë, bashkë me Sani Kadurin zbritën thellomave të përroit, zunë vend nën një shkëmb dhe, pasi pinë një damixhan verë, kënduan së bashku, ndërkohë që qemanes i binte vetëm Sani Kaduri. Sani Kaduri i binte qemanes, pinte verë nga damixhani dhe i thoshte atij Johanit, nëse rrimë gjatë këtu, nëse vijmë nesër dhe pasnesër po në këtë vend, nëse pimë verë dhe i këndojmë sevdasë, ai Bindi që thua ti, do të vijë pa e thirrur njeri, sepse edhe xhindet këtë punë kanë, të bëjnë pallën e sefasë, të pinë verë dhe t'i këndojnë dashurisë.

Të gjitha këto që thoshte Sani Kaduri i dehur, Johani i shkruante në letër, pastaj ndalej, qeshte me broçkullat që fliste Sani Kaduri, pinte verë dhe, herë pas here, fshinte me mëngën e dollomasë pikat e verës që i shkonin mjekrës teposhtë. Shënimet njëditore mbylleshin me përshkrime të hollësishme të mbrëmjeve në çardakun e hanit, kur Sani Kadurit i shfaqej mrekullia e frymëzimit, që e bënte këngëtarin e sevdasë të përfshinte në një këngë të vetme tokën dhe qiellin, largësitë e paarritshme të kësaj bote dhe të asaj tjetrës, dhembjen dhe pikëllimin, harenë dhe gëzimin, të gjitha këto të thurura si në një qëndismë malli për të paarritshmen, për ëndrrën, dashurinë dhe përjetësinë.

Kështu kishte shkruar Johani. Por ne të kalasë e dinim se një ditë, krejt rastësisht, gjërat kishin marrë një kthesë të papritur, pikërisht atëherë kur Sani Kaduri i paskësh thënë Johanit se ditëve të vjeshtës dhe të dimrit, atëherë kur deti atje poshtë tërbohej dhe bëhej si dalë mendsh, Bindi dilte nga deti dhe ngjitej përroit përpjetë, derisa arrinte te muret e kalasë, që aty, pastaj, të zinte vend dhe të qëndronte një javë e më shumë, deri sa fërtyma të fashitej dhe bota të kthehej në gjendjen e saj të rregullt. Nuk është e mundur! Perënditë nuk sillen kështu. Është e mundur, kishte thënë Sani Kaduri, i ndërprerë nga lemza që ia shtrëngonte damarët e qafës dhe ia ngjiste gjuhën pas qiellzës.

Pra, po me këtë radhë Sani Kaduri i kishte rrëfyer atij Johanit, se gjatë kohës që Bindi rrinte në thellomat e përroit, natë për natë dilte fshehurazi që andej dhe në kala i mbarste lëneshat. Nuk të besohet? Hik!

Nuk ishte e vështirë të merrej me mend, se sa kishte qenë tronditës për Johanin ky rrëfim i Sani Kadurit, sepse kallëzimet e mëvonshme të njerëzve të kalasë bëjnë të ditur se netëve me shi, aty nga fundi i vjeshtës, Johani ishte parë tek dilte nga Hani i Nënkalasë tre çerek ore para mesnate, i mbështjellë me një dolloma të zezë dhe një fener në dorë, ishte futur në kala fshehurazi dhe atje, mbi murin e epërm të qytetit, kishte qëndruar në terr, deri në zbardhje të dritës.

Për këtë natë dhe për zhvillimet e tjera të atyre ditëve, Johani nuk kishte lënë shënime, vetëm që shkrimet e tij të kësaj periudhe papritmas bëheshin disi të mjegullta, të mbushura me ndërprerje të shpeshta dhe fillim e fund përshkoheshin nga ndjenja e çorientimit dhe përhumbjes. Netët e gjata pa gjumë, gjithashtu, zënë një vend të rëndësishëm në përshkrimet e Johanit, net që nxisin dëshirën e pashpjegueshme për të prekur thellësinë e errët të gjërave. Ku është, tani, ajo ditë e djeshme me të gjitha ngjarjet e saj, që unë nuk e shoh askund, shkruante Johani, dhe nga do të shkojë kjo natë, kur të shfaqet dielli në anën e përtejme të lindjes dhe përse unë nuk mund të jem edhe këtu, edhe në një vend tjetër njëkohësisht, kur nata mundet, kur era mundet, kur mendja mundet, dhe pastaj gjerë e gjatë e përshkruante pamundësinë e tij për të dalë përtej botës dhe për të parë me sytë e tij anën e errët të saj.

Ndërkohë, nga shënimet e Johanit del e qartë se ai nuk kishte hequr dorë aq lehtë nga synimi i tij që Sani Kadurin ta mësonte të këndonte këngë trimërie. Madje, kishte ndodhur një herë që Sani Kaduri ishte gajasur së qeshuri, ndërsa i kishte kapur veshi një nga ato bëmat trimërore të një kënge të tillë. Dy trima bënin dyluftim dhe gjuanin njëri-tjetrin me topuz, gjuan i pari dhe topuzi e bën një shkëmb çikë e thërrime, gjuan i dyti dhe topuzi ngulet tre pash nën dhè! Sani Kaduri nuk e mban dot të qeshurën, Johani ngryset në fytyrë, Sani Kaduri i thotë Johanit, aman, mos e ço më andej këtë punë, nuk muj me këndue nji kangë me topuz, Johani bëhet i sertë, zgjidh qesen e parave dhe i jep Sani Kadurit një metelik argjendi, Sani Kaduri e mban në dorë metelikun dhe mendohet gjatë se çfarë mund të bëjë me të, do të shkojë këmbë në Shkodër për të blerë një qemane të re! Ndërkohë, Sani Kadurin e çojnë peshë nepsi dhe meraku, e ka mendjen te një perri, me trupin si ngjalë dhe balluket e zeza, me xhamadanin e qëndisur që mënt plas nga gjinjtë e mbushur. Aman, i thotë Johanit, lëri ca para te Xhamia e Namazgjasë, kur të vdes, të ma bëjnë varrin afër ndonjë vejushe, dhe kur të vijë dita e zgjimit të të vdekurve, nga varri im të kaloj në varrin e saj, ose ta zgjas dorën e ia prek në ato vendet e merakut, sepse sevdanë dhe nepsin nuk i tret as dheu!

Nga shënimet e Johanit nuk arrijmë ta kuptojmë aq qartë si ndodhi që ai, po ato ditë, e verboi Sani Kadurin. Në të vërtetë, Johani e bëri këtë në një mënyrë që nuk është e lehtë të shpjegohet, sepse Sani Kaduri nuk kuptoi gjë prej gjëje, vetëm që kur u zgjua nga dremitja e pasdites në plemen afër stallës së hanit, në vend që ta shihte botën siç e kishte parë gjithmonë, para sysh iu shfaq një mjegull e bardhë dhe e dendur, me ca hije të palëvizshme, që nuk i shquante dot se çfarë ishin. Sani Kaduri fërkoi sytë një herë e dy, madje edhe duart i zgjati përpara që të davariste atë tymnajë, por përveç mjegullës që u dendësua edhe më shumë, nuk arriti të shquante asgjë tjetër.

Por, akoma më e çuditshme nga kjo, del e dhëna se Sani Kaduri nuk nxori zë ankimi dhe nuk tha ndonjë gjë, që t'i jepte dikujt të kuptonte mynxyrën që i kishte rënë mbi kokë. Përkundrazi. Ai doli nga plemja me tahmin dhe, duke u mbajtur pas mureve, u çapit disi deri në hyrje të hanit dhe aty, pasi u sheshua mbi kalldrëm, me një zë të dridhur e të mbushur pasion, këndoi një këngë zamani, për një ashik plak dhe për bëmat e tij fort të çuditshme, që kishin të bënin me sevdanë dhe jo tamam me sevdanë; që kishin të bënin me lektisjet e shpirtit dhe jo tamam me këtë; mbase më shumë një pikëllim për gjërat e bukura të kësaj bote, që ai nuk do t'i shihte kurrë më!

Megjithatë, meqë kemi të bëjmë me një vete të rëndësishme të këtij rrëfimi, e shohim të arsyeshme që në këtë vend të japim edhe disa shpjegime plotësuese rreth asaj që ngjau ndërmjet Sani Kadurit dhe Johan fon Bergmanit. Ta zëmë, nuk mjafton të themi këtu se nga penxherja e hapur e hanit, Johani duhet të ketë dëgjuar me vëmendje këngën e Sani Kadurit tashmë të verbër dhe, si i kishte dalë se ajo nuk ishte këngë trimërie dhe as ndonjë nga ato këngë që flisnin për ndodhí të mahnitshme; se, madje, as këngëtari nuk ishte nga ata rapsodët e verbër që i kishte kërkuar gjithandej maleve të Bosnjës dhe Rumelisë, për të cilët kishte lexuar dikur se bridhnin nga një vend në tjetrin dhe ngjarjet e këngëve i bënin si të vërteta; pra, në një rrethanë të këtillë, Johan von Bergmanit nuk mbetej gjë tjetër, përveçse t'i ngarkonte mushkat që në mëngjesin e ditës së nesërme dhe të largohej nga Hani i Nënkalasë, pa u vërejtur pothuajse nga askush.

Por, dy gjëra nuk ndryshuan as në këtë periudhë të jetës së Johan fon Bergmanit: pagjumësia dhe ajo ëndrra e vogël, e fshehur në kujtesën e hershme të fëmijërisë. Ai nuk flinte kurrë, shikonte diellin në lindje dhe në perëndim, natë për natë shihte hënën si ndërronte formë, ndonjëherë numëronte yjet në qiell, mendonte për fshehtësitë e pashpjegueshme të botës, ngjitej mbi male, zbriste luginave, dëgjonte ushtimën e detit, kthehej në bujtinë dhe hidhte mbi letër shënime pa ndonjë radhë, ashtu siç i vinin gjërat nga zërat e brendshëm të vetmisë. I ra kryq e tërthor Rumelisë, në një fshat vlleh e martuan me një vajzë trembëdhjetë vjeçe, ajo vinte e ngushtë nga vithet dhe kur Johani bëri të flinte me të, ajo nxori një bollë nga kutia dhe e futi në shtrat, bolla iu mbështoll Johanit nëpër trup, ai klithi i tmerruar, u vesh me të shpejtë dhe bëri të dilte, por një grumbull plakash që rrinin te dera e kthyen brenda, Johani ia mbushi zgorrin me farë vajzës trembëdhjetë vjeçe dhe iku nga fshati ndaj të gdhirë, si të dilte në mëngjes nga një ëndërr e keqe.

Ndërkaq, në ëndrrën e hershme të Johanit për viset e largëta, mbeti pamja e gjithmonshme e rapsodit të verbër, që këndon dhe e krijon botën njëkohësisht.

Johani mbajti shënime për këngëtarët që i kërkoi dhe i gjeti gjithandej, nëpër mejhane qytetesh e nëpër kasolle fshatrash. Njërin, madje, e gjeti të tillë çfarë e kishte menduar, të moshuar dhe të verbër, e pagoi nga dy florinj për një këngë, kjo zgjati një javë, deri sa e kuptoi se rapsodi shtihej i verbër, por nuk ishte i tillë dhe se këngët që i këndonte ishte një përzierje gjuhësh që nuk mund t'i kuptonte njeri. Po me këtë radhë shënoi në letër fjalë të rralla, këngë, legjenda, rrëfenja dhe etimologji, kaloi një natë me dylberët e Shkodrës, ata i bënë sajdi edhe me mish të pjekur dhe raki manash. Pikërisht në një rrethanë të tillë, Johani shpjegoi etimologjinë e fjalëve *ankth* (anth-nëkoj-rëkoj-ankoj), krahasuar me latinisht *animus*, indishten e vjetër *aniti*, baskishten *amerts*, jo, kjo nuk është e saktë, por vjen nga *ang*, *angu*, me zvogëlimin eufemistik në fund, *ankthi*, *angthi*, që shkon me latinishten *angustus*, gjermanisht *eng*. Po aty ishte edhe etimologjia e fjalës *besë* (besoj, besim, besimtar, bestar, besatohem, besatar, pabesi), latinisht *foedus*, *credo*, me rrënjë indoevropiane *bhenddh*, indishtja e vjetër *badhunati*, gjermanisht *binden*, më e mundshme të lidhet me *bind*, bindem, nuk ka të bëjë me grupin gjerman *binden*, që ka kuptimin e lidhjes, por afrohen me fjalën *be*, latinisht *fido*, *fides* e *foedus*, gotishtja *baidjam*, me kuptimin e shtrëngesës, detyrimit.

Ndërkaq, sipas shënimeve të Johanit verbimi e Sani Kadurit kishte të bënte me Bindin, thënë më mirë, me idenë e Sani Kadurit se Bindi mund të shihej me sy, sepse këngëtari pikërisht këtë gjë kishte bërë: kishte dalë mbi muret e kalasë, dhe i kishte thirrur Bindit me zë të lartë: dil të të shoh nji herë, hudum plak, ti që m'i merr dashnoret dhe ma ban jetën xhehenem! Bindi ishte shfaqur vërtet bashkë me një dritë vetëtime, kishte dalë nga përroi ose kishte fluturuar nëpër qiell. Sani Kaduri ishte verbuar nga drita e vetëtimës, kështu kishte shkruar Johani, duke fshehur faktin se një natë të vonë, ndërsa rrinte pranë dritares së vogël të hanit dhe shikonte hënën që nanuriste në qiell, Johanit i qenë rrëmbushur sytë nga mallëngjimi, kishte parë edhe kodrinën e hijezuar të Tukemilit që ravijëzohej në sfondin e qiellit, pastaj kishte dëgjuar ushtimën e detit që vinte si ofshamë e largët dhe nëpër atë sfond regëtimash arriti të shquante zërin që gjithmonë i thërriste vetmisë së tij, zë që nuk thoshte asgjë të qartë, por e krijonte botën në format e saj të para, zëri nuk ishte zë tamam, kënga nuk ishte këngë tamam, para syve të tij kishte ndodhur e pamundura, e pashpjegueshmja, e paarritshmja. Johani kishte marrë një shishe të vogël në njërën nga baulet e tij, shishen e kishte mbajtur me vete prej vitesh, sepse kishte menduar se ndonjë ditë vetmia e tij mund të bëhej më e zezë se skëterra, atje ishte përzierja e helmët e squfurit dhe nishadrit, e braktisjes dhe zhgënjimit. Johani zbriti shkallëve të hanit pa u ndjerë, u fut në derën e pasme të plemes afër stallës dhe ia verboi sytë me helm Sani Kadurit, pikërisht në çastin kur ai shihte veten ëndërr nën hijen e hurmave, hija e hurmave shkonte tejanës dhe sillte me vete një fresk të lehtë, si dhe pamjen e tri perrive, të cilat vallëzonin këmbëzbathur mbi rërën e valë të shkretëtirës.

Sani Kaduri atë çast ishte i lumtur dhe buzëqeshte hareshëm në ëndrrën e tij.

VANGJUSH SARO

'I ftuar' në TV 13...

tregim

Aty nga ora 11 e paradites, shkrimtari Sh. ishte duke ecur me kokën lart nëpër atë çfarë kishte mbetur (apo tjetërsuar tashmë) nga ajo që dikur i thoshin Kinostudio. Ishte vapë. Këndonin gjinkallat; kënga e tyre e bënte edhe më të rëndë zagushinë. Ngrehinat e reja, zgjatimet e atyre që kishin qenë edhe më parë, rruginat e pluhurosura, shkurret e mbetura nga kushedi qëkur, të gjitha këto ishin në sfond. Ai e kishte mendjen gjetkë; po kërkonte selinë e TV 13. Dhe pasi e gjeti atë, nxitoi brenda, gjithë me kokën lart. Eci një copë herë nëpër një sallon të laryshitur me gjithfarë zbukurime e ngjyra. Pastaj u përball me rojen, i buzëqeshi atij, i tha ashtu e kështu dhe, më në fund, bëri tutje.

Shkrimtari Sh. nuk ishte i njohur; në kryeqytet e më tej. Megjithatë, ia kishte gjetur anën... ta fuste librin e vet në një listë rekomanduese të Ministrisë; kishte përcjellë në rrjete edhe ndonjë recension nga kolegë që, në të gjithë parametrat, ishin aty-aty me të; më në fund, e kishte ngecur librin edhe në nja dy a tre librari. Mirë edhe për kaq; por prapë ishte larg suksesit dhe vuante njëlloj mospërfilljeje. Ishte pikërisht atmosfera e ftohtë në të cilën po kalonte edhe botimi i librit të tij të dytë, ashtu, të tretë, që e detyroi atë të lëvizte pak. Kjo ishte sajuar pak a shumë në këto rrethana: Një nga aksionerët e TV 13, ishte i afërm i gruas së tij. Ajo i kishte folur të afërmit në lidhje me librin e burrit të saj; aksioneri kishte komunikuar me Shefin e Departamentit të Kulturës; ky i fundit i la njëlloj porosie moderatores së Kulturës; dhe kjo i bëri shkrimtarit Sh. një ftesë për intervistë. Tani, ai gjendej përpara gazetares në fjalë, një vajzë plot hire dhe e veshur si për në krevat.

Në studio ishte qetësi. Shkrimtari Sh., i cili kishte me vete kartën e identitetit, disa kopje të librit të tij të tretë dhe një tufë me lule, po priste plot durim, veç i shpërqendruar disi nga emocionet. I dukej vetja shumë i vogël përballë Miss-it që do ta intervistonte. Ai ishte i një burrë i shkurtër, me një pamje dosido, madje pak i tukequr; sharmi i moderatores aq sensuale dhe veshja e saj, e kishin hutuar pak. Jo. Shumë. Kur ajo e pyeti pse gjendej atje - dukej sheshit që nuk mbante mend asgjë - ai tha vetëm kaq:

-Unë *jamë*...

Nganjëherë, fliste në dialekt. S'ishte kjo arsyeja që moderatorja ende nuk po mundte të kapte si duhej situatën. Edhe ajo, me një tironçe të adoptuar, e pyeti sërish - më mirë ta kishte vrarë - çfarë ish tu bo ai atje (!) Emri i të ftuarit nuk i kumboi asgjë në vesh. Por sapo që tjetri përmendi bashkëpronarin e TV 13, gazetarja e bëri lidhjen sakaq. Megjithatë, ajo ende dukej pak konfuze. Nuk po e përcaktonte dot tematikën e bisedës; pastaj, vështrimi me gjasë i rëndë i shkrimtarit i dukej si një gjë komike, mënyra se si i mbante librat e tij në sqetull, edhe më për të qeshur.

Moderatorja vetë nuk lexonte libra. S'mbahej mend kur mund të kish shfletuar ndonjë aso. Por ajo 'shfletonte' - me pangopjen dhe kureshtjen që tashmë ka vënë në resht shumicën e popullatës - gjithfarë gallatash e ndodhish që gëlonin nëpër rrjete. Këto, si dhe njëfarë fjalori me terma që... ishin në kohë, e kishin përgatitur atë të përballej me çdolloj situate.

Koha po shkonte gjithë në atë paqartësi **e** përhumbje. Më në fund, dikush tha se regjistrimi do të bëhej pas nja 15 minutash. Moderatorja po shkëmbente fjali me regjisorin. Ndërkaq, ngase dera e studios tjetër ishte ende gjysmë e hapur, vinin shtjella-shtjella fjalët e një kënge që thoshte pak a shumë: "Merre merre merre/ merre po ta dhanë/ por nuk mundesh ti/ jo jo jo..." Me siguri, po regjistrohej ndonjë video. Ta këpuste shpirtin ajo këngë dhe 'lirika' e saj. "Ti më thua/ unë s'e dua/ kot mos ma kërko..."

Moderatorja iu dha pak tualetit të vet, kohë gjatë së cilës i telefononte pareshtur i dashuri. Ajo i thoshte atij me butësi: "O Taku, jom në punë, lale." Kurse regjisorit: "Jena gati?" Dhe prapë të dashurit: "Jom në punë, o trangull. Folim më vonë."

Në një moment, vajza pa lulet që mbante në dorë shkrimtari Sh. dhe e pyeti me një fytyrë ku e ku më të lulëzuar nëse ia kishte sjellë asaj.

-Jo jo, - nxitoi të shpjegohej ky. - Unë mendova se në përfundim të intervistës, ju apo dikush tjetër këtu mund të m'i dhuronte mua... Si ta them... A mund të fillojmë?

Gazetarja shkëmbeu një vështrim me regjisorin.

-Leji aty... Lulet, pra mo. Po mirë, edhe librat. Njonin mbaje n'dorë. Mbyllni derën, lale!

Kamera e parë dha shenjën. Moderatorja vuri sakaq maskën.

-Të nderuar shikues, - buzëqeshi ajo - në këtë emision do të flasim për letërsinë, si shprehje e vlerave që derivojnë në shpirtërat njerëzorë. Libri është mesazheri më i mirë për çdo kohë... Ë? Lene hyrjen, lale, - ia bëri me dorë regjisorit - e bojm' i her' tjetër... Por ne, - vazhdoi me sytë nga operatori përballë - kemi sot këtu autorin e librit për fëmijë "Dhelpra, qeni, gjeli, qengji, gomari, ketri, ujku, macja, bleta, pjergulla, kajsia, retë e bardha dhe flutura krahëshkruar". Atëherë, pra, - u kthye ajo nga shkrimtari Sh., duke u treguar ndërkohë kamerave këmbë vërtet shumë të bukura - ju kini trokitur tashmë në vetëdijen e lexuesve me mesazhet tuaja. Apo jo? Teleshikuesit e TV 13 janë të interesuar të dinë motivet që ju çuan te ky libër.

Shkrimtari i sajuar Sh. qërroi zërin dhe ia nisi me pak emocion:

-Unë *jamë* autori i librit "Ujku, qeni, gomari..." Jo! Unë *jamë* autori i librit "Gomari, ujku, qeni..." Jo! Prapë. Unë ju *përgëzojë* për emisionin... Libri *imë* është një libër që vjen si një, si një... Prapë. Pse unë e titullova atë "Qeni, gjeli, gomari..." Jo! "Gjeli, gomari, ujku..." Jo! "Dhelpra, macja, ujku..." Jo! Po mirë, pse dhelpra është dinake, do të thoni ju? Jo! Prapë...

-Zotëri - ndërhyri moderatorja, duke e parë që i ftuari ishte pak i hutuar - si e konceptoni ju komunikimin me lexuesit? Ju kini një kod letrar tuajin, sigurisht...

-Kod?! *Patjetërë*! - tha shkrimtari, duke parë ndërkaq tavanin. - Po sigurisht; sepse libri *imë* "Ujku, qeni, gomari..." Jo. Prapë. "Dhelpra, ujku, qengji..." Jo jo! Por libri *imë*...

Vajza më kot i bënte shenja që ta lexonte titullin në libër; ai e kishte në dorë atë. Por tjetri po mbytej nga emocionet. Mbase aq e kishte gajden. Ndoshta edhe vajza po e tralliste keq e më keq me hiret dhe aromën e saj... Ajo vazhdonte të zbulonte edhe më shumë pjesët e zbuluara e, ndërkaq, fliste sikur të ishte duke udhëtuar për në Hënë:

-Letërsia është një planet që rezaton, apo jo? Bota e fjalës e mbështjell subjektin njeri. Pra, ju...

-Pra, unë... Libri *imë*... Subjekti i këtij libri... Subjekti i librit "Dhelpra, gjeli, ketri..." Jo! Prapë. "Ujku, qengji, ketri, macja..." Jo! Jo dhe jo!"

Edhe pse herën e fundit kishte arritur të bënte bashkë katër nga kafshët e kafazuara në listën që, fundja, ishte titulli i librit të tij, shkrimtari i pafat nuk po mundte dot të dilte nga ai dreq çarku. E kishte menduar të lehtë këtë bisedë, ashtu siç edhe kur shkruante. Por tani diçka po shkonte ters. Papritur, iu ndërmend numri 13. Hëëë! Pse ky TV duhej të kishte atë emër?

Gazetarja bëri një pauzë, gjatë së cilës shkëmbeu disa mendime me regjisorin, që gjithsesi e kuptonte, jemi në ekran lale, disa gjona shkojn' mirë, disa jo... O Taku, iu kthye pastaj edhe njëherë të dashurit, po ça fol o lale, jom tu regjistru. Ik tani! Iiik!

Ajo e kishte ngritur zërin kaq shumë dhe njëri nga tingujt kishte goditur kaq fort, saqë shkrimtari Sh., në pështjellim të plotë, pothuaj i trembur, u ngrit të ikte me të vërtetë. Moderatorja e zuri për krahu. Jo ju, zoti Sh. S'po flisja për ju. Pra, vazhdoi ajo duke i shkelur syrin regjisorit - o Zot, ishte si një shegë e përflakur, e shkalafitur, të tundonte - pra libri juaj ndjek disa kordinata... Apo jo?

-Kordinata?! *Patjetërë*, ky libër, libri *imë* "Ketri, macja, ujku qengji, dhelpra..." Jo. "Qengji, ujku, dhelpra, macja..." Jo! "Ujku, qengji, dhia, jo, dhelpra, ketri..."

-Vizioni juaj në këtë libër - ndërhyri sërish moderatorja - është, le të themi diametrik...

-Diametrik, po. Qengji, ujku, macja...

Vuu muzika e celularit, për të dhjetën herë. Qeni, ketri, zogu...

"Takuuu! Më çmene sot, laleee!" Krejt papritur, vajza u ngrit dhe doli përjashta furtunë, por duke mos harruar t'i bënte shenja kameramanit përkundrejt të fokusohej te kopertina e librit. Celularin sa nuk po e kafshonte. Shkrimtari Sh., i cili mbeti atje si lloz, mori librat dhe i vuri nën sqetull. Pastaj i shkoi mendja edhe të lulet. Sidoqoftë, mbase edhe ai kishte nevojë për pak pushim. Duke shkuar pas moderatores, krejt i pakthjellët, në mos edhe i dehur nga kurmi i saj, nuk i doli nga mendja t'i thoshte, sa me fjalë, me shenja: "Po lulet?..."

Dikush duhej t'ia jepte atij lulet. Ç'është kështu! I kishin mbetur në dorë... S'po merrte vesh kish mbaruar punë apo do ta thërrisnin prapë. Nga dera e sapohapur, një reze dielli kishte hyrë brenda sa për të projektuar grimcat e panumërta të pluhurit. Kurse matanë, nga studioja tjetër, vinte ende ajo kënga që thoshte pak a shumë: "Merre merre merre/ merre po ta dhanë/ por nuk mundesh ti/ jo jo jo..."

Sa bukur! Po shkonte dreka...

ROLAND GJOZA

Instinkti i trëndafilave

(Fragment romani)

Balloja e madhe kishte emrin e nënës. Hoteli ishte mbushur me afishe të mëdha dhe drita. Ditëlindja e nënës përkonte me Krishtlindjen, po më fort me fikun e asaj të Burretos, që sapo kishte vënë këmbë si nuse në shtëpinë e fundit të rrugicës. Ai fik, siç tha Zoi bardhoshi, kasapi i ri i hotelit, i kishte kokrrat si herdhet e demave të rinj. Vërtet, si mund të bëjë kokrra fiku në dimër dhe, veç kësaj, ato t'u ngjanin organeve mashkullore të demit? Pastaj ra dëbora e parë që zuri mbi fik dhe mbi oborrin e hotelit, ku sapo kishin zbritur prej një karroje me katër kuaj, demat e rinj që do të bëheshin biftekë dhe rosto për festën e madhe.

Aty te muri e pinin kafenë nëna dhe babai. Zgjasnin kokat dhe shikonin Zoin që mprihte thikat. Mbi trapezën e gjatë prej metali ishin tre çekiçë të mëdhenj, një satër, pesë thika me dy tehe. Ç'bardhosh që është, i nxiri, të kall datën, po kështu nga shtati sindozot si një dem race duket. Zoi e shikonte nënën dhe buzëqeshte, i tregonte thikën dhe shkonte nëpër tehet e saj gjuhën sikur ta lëpinte. Shiko ç'bën, mavria, po a bëhet kjo? Shikon ti qyp, i kthehej babait, merr shembull, as një pulë s'di të therësh dhe më je veshur kapter, pale, mban dhe pisqollë në brez. Vër sy e mend të mësosh, djali ty të ka ngjarë. Unë do shkoj, tha babai, jam vonë për punë! E mbarove kafenë? E mbarova. Fryj tani! Unë po bëj sehir, se ky shejtan Zoi qenka për thagmë! Demat rrinin lidhur në fund të oborrit dhe çukërmonin e tërhuzeshin me hov, kërcenin e shfrynin, se nuk iu pëlqente ai litar i trashë dhe ato kanxha që i kishin mbërthyer. Po si ia bën, more mavri? S'ke frikë? Jo, aspak, përkundrazi, ata kanë frikë prej meje. Ky është një lloj sporti, e kam trashëguar nga prindërit, edhe mëma tredhte e vriste dema. Ata, e shikon si tërbohen, janë në afsh, i kemi shkëputur nga fusha me mjegull e anëdetit, ku i linim të kullosnin në gjendje të lirë. Kërkojnë femrën, iu vjen lëngu i saj prej larg, iu shpon hundët ajo erë e dalldisur dhe duan të shkëputen nga litari. Shiko si e brejnë me dhëmbë. Iu ka rënë në kokë të bien me femër, po femrat i kanë larg dhe domosdo që i kanë tradhtuar me dema më të vjetër, se të rinjtë, këta me mish më të mirë, më të njomë, më ndjellës e më trallisës, i sjellim këtu! E, ç'mish që kanë, zonjë! Ç'mish! E ha dhe të ngjallen ato që ke dashuruar! More ç'flet kështu, iu çor nëna, llafe turpe s'dua unë! Pastaj këta, zonjë, vazhdoi Zoi, sikur t'i kishte veshët të zënë me dyllë, kanë herdhe më të mëdha, ke për t'i parë si do ta lëshojnë spermën kur të hanë goditjen e parë. Prandaj zuri ai fiku i asaj nuses së Burretajve, prej kësaj sperme. Ka qenë fik femër! Pse, o i flamosur, fik femër? Posi, nuk ke dëgjuar për ujë femër? Ç'mollois ky i zi me bojë, ore ti, e çon nëpër mend se me kë ke të bësh? Dukesh nga boja, zonjë, që je e bredhur, e shëtitur, di nga bota. Në ç'kuptim, more fyell? Keni lëkurë të hollë prej aristokrateje, e keni të shkruar në ballë. Nëna qeshi, shkoi duart nëpër flokë, u krekos, donte të thoshte diçka, po nuk foli, vetëm ngriti njërën dorë, dha shenjën se ai i kishte rënë pikës. Shiko, thirri Zoi dhe menjëherë liroi litarin, uli kanxhën që mbante të mbërthyer demin dhe e la të lirë. Demi u rrotullua përqark vetes me kërcime e hove të befta, pastaj rendi me të katra drejt Zoit që mbante në dorë çekiçin e madh. Uli pak kokën dhe drejtoi brirët, po Zoi e goditi me çekiç në ballë, i nguli njërën thikë, pas saj katër të tjerat dhe demi u lëkund, fërgëlloi i tëri, një fiskajë gjaku i spërkati Zoit përparësen prej gome të zezë, shkau e ra para këmbëve të tij. Nëna kishte ngrirë. Demi ishte shtrirë me kurriz dhe herdhet e mëdha lëshuan një shkulmë sperme që i mbuloi barkun. Nëna mbylli sytë. Zoi nxori një shishe raki nga xhepi i madh i përparëses dhe e piu surba-surba gjersa i rrodhi nëpër mjekër, ia bëri një ah! që iu shkëput nga shpirti dhe fshiu lotët nga sytë. Ai qante vërtet, me zë, me gulçe. Pse qan? i tha nëna. Vrava birin tim, tha ai. Kë bir, more! Eh, s'kupton ti!... Demi i dytë, bëri atë rrotullimin e egër përqark vetes si i pari dhe në vend që të sulmonte Zoin, i ra me brirë murit të shtëpisë, e çau, u fut brenda me rrëmbim, përshkoi të gjitha dhomat, goditi e rrënoi mure, bufe, komo, prishi shtretër dhe më në fund ra në gjunjë, me një plagë të madhe në brinjë. Nëna ulërinte, Zoi qeshte. Ndodh nganjëherë edhe kjo, zonjë! Dema janë, ku dinë ata se ku i fusin brirët. Janë pa mend e të verbër në këtë anë. More ti, këlthiti nëna duke shkulur flokët, ke shpirt apo s'ke! Ç'më bëre, që ta bëftë perëndia! Zoi e goditi demin në ballë, i nguli thikat dhe e tërhoqi zvarrë. Nënës i kishte rënë të fikët. Zoi e mbushi dorën me spermën e demit dhe ia vuri nënës në hundë, ajo menjëherë u përmend. Mos u bëj merak, zonjë, gjëra që rregullohen. Më të mirë do ta bëjmë shtëpinë, ke për të parë! Ç'nishan njeri! tha nëna. Po kjo ç'është që më ngjit? Spermë demi! Ua, edhe këtë ma bëre, mor zorzop!



Shtëpinë ma prishe, na tani dhe kjo... Është ilaç, qeshte Zoi. Pas pak, si në ëndërr, nëna pa me çudi si erdhën gjithë ata ustallarë, kuzhinierët me të bardha zgjasnin kokat, Zoi jepte urdhra: zbrazini dy dhomat e madamave në katin e fundit dhe atë të zotit Kiki. Sillini këtu. Zonjës, do t'i vini në dhomë krevatin tim dopio. Kjo punë duhet të mbarojë për dy-tre orë. Nxitoni! Nëna dëgjonte me njërin vesh, se me tjetrin ndiqte punën që bënin ustallarët. Kush je ti, more Zoi? Pronari i hotelit! Ua, ia bëri nëna dhe vuri dorën në faqe.

Pse çuditesh? Po ja, flokë të bardha, vetulla të bar-dha, qerpikë të bardhë, sy të shpëlarë, që kur të shikon të kall datën. Po ty të thonë të gjithë kasapi, ai që vret dema e derra. E bëj për sport. I rris vetë në fushat në pyllin tim. Vërtet kështu të shtie frikën, po kur ka ballo jam tjetër njeri. E si, më qafsh, me kë tallesh ti? Do ta shikosh! Zoi e pa në fytyrë nënën dhe i buzëqeshi: Ti duhet të kesh lindur në një ditë feste. Ku e di ti, qeshi nëna, po për festë kam lindur. Për Krishtlindje! Atëherë do të organizoj ballon e madhe të Krishtlindjes dhe ajo do të mbajë emrin tënd!

Kjo ndodhi pati dy të mira për djalin: gjeti bllokun e shkelur keqas nga demi, çarçafët këtej e tutje s'do të kishin arna.

Rrugicën e kishte gjetur belaja me kasapin, se ai po humbte shumë në sy të botës, sidomos të grave, ngaqë i kish dalë rival Zoi. Kishte frikë se mos i merrte Evanthinë. Që pas asaj ngjarjeje të bujshme me demin që i kishte prishur shtëpinë nënës, kasapi mprihte thikat jashtë, para shkallëve të dyqanit që ta shikonin të gjithë, nga tre i kishte bërë trembëdhjetë dhe, një e dy, mprihte thika. Njëri i zi, tjetri i bardhë, dy kasapë, po i bardhi na doli që ishte dhe pronari i hotelit, kjo më fort e kishte tërbuar të ziun. Evanthia i thoshte të priste dhe nuk e pranonte më në shtëpi. Ai donte të nxitonte të vinte unazë me të që të qetësohej, po ajo i vinte shumë kushte dhe ai nuk mbante mend asgjë. Sa dilte prej saj nuk i kujtohej asnjë kusht. Veç donte ta rrëmbente e ta kishte në shtrat. Nuk ngopej me mishrat e saj, i çohej qimja përpjetë kur e kishte nën vete dhe ia dëgjonte rënkimet. Po kishte teka të mëdha, diçka nuk shkonte dhe ai fajin më të madh ia vinte Zoit, që kishte fituar aq shumë famë. Po edhe ai kopili i vogël, ia nxinte shpirtin me dyshime. I vogël, i vogël, po thonin se e kishte të madh. Eh, bela, ç'e kishte gjetur, i thoshte me mburrje se kishte fituar shumë para, se do ta mbante në pëllëmbë të dorës, po ajo hiç, sa mbaronin atë punë mirë e bukur, i shkisnin lot e ngrysej prej një brenge. Një ditë i tha, pas derës: Shko, nuk të dua! Mirë, mirë, mishin po ta lë këtu! Mish viçi i freskët, nëntë muajsh! Merr vesh ti, dëgjohej pas derës zëri i trishtuar i Evanthisë: Kam rënë në dashuri! Me kë?

Shko tani, dashke dhe emrin ti! Mirë, mirë, kujdes mishin, ta kam lënë këtu te dera. Kujdes, se ta hanë macet! Dhe ikte, po harronte shpejt ç'i kish ndodhur dhe mprehte thika.

Ta mbaj apo ta djeg, ta mbaj apo ta djeg, thoshte me vete djali për bllokun që e mbante në duar. Një bllok i zakonshëm që s'peshonte më shumë se një krah zogu.

I mbushur me një shkrim si këmbë pate, plot shkarravina dhe njolla boje. Sa

punë që kishte, duhej të daktilografohej, të korrigjohej, të çohej në një gazetë a... po ku çohen romancat? Ai s'dinte asgjë. E mbante në duar si diçka të tepërt. Do ta djeg, tha me mend e shkoi drejt mangallit në oborr mbushur me qymyr që digjej e nxirrte flakë të furishme. Sa u bë gati ta flakte, një vajzë e vogël i la në dorë një pusullë. Ai lexoi: Eja, se po vdes. Evanthia. E harroi bllokun, e futi në xhep në mënyrë krejt instinktive dhe vrapoi, kapërceu murin dhe ngjiti një palë shkallë me furi, ndaloi para derës dhe disa sekonda dëgjoi zemrën e vet se si rrihte dhe frymëmarrjen si fishkëllimë. Erdha, hape derën. Hapur është!

E gjeti mbi shtrat, të shtrirë, të palëvizur, sikur po hiqte shpirt. Mbylle derën nga brenda! Të pa njeri? Dëgjo: Të dua! Vetëm ty të dua në këtë botë! Ai u hodh mbi të dhe ajo e pushtoi me zjarr, e puthi, qau. Aq shumë të dua, sa s'pyes për moshën tënde! E di që është marrëzi, s'do të na e falin, po kjo më qe shkruar! Më zhvish, shpirt, me ato duart e tua që i dua shumë, se dinë të përkëdhelin... Sa më pëlqen me ty, sa më pëlqen të bëj çdo marrëzi me ty! Me ty e ndiej, me ty, vetëm me ty! Oh, unë e zeza, që nuk zë mend! Bie në dashuri dhe marrosem! Po ti, më do ndonjë çikë? Të dua shumë! Edhe më shumë, ngaqë më mbaje larg. Atëherë e kuptova se sa të doja. T'i lëmë të kaluarat, tha ajo, të mos rrëmojmë për të kaluarat, e di, kam bëre gabime, kam dashuruar njeriun e gabuar, po si kjo gjendje lëngate që po më merr frymën, nuk kam kaluar asnjëherë. Ti sikur më ke bërë magji. E vulosa kur më tha ajo hajdutja e dashnorëve, e Tolajve, se ti e kishe kyçur gojën, nuk i kishe treguar asgjë për marrëdhëniet tona. Aty më ra në kokë! Po si ndodhi? Nuk e di! Je gati për luftë? O, do na vrasin, o do i vrasim!

Se kjo dashuri s'do të ketë jetë të gjatë, e njoh veten, e mallkuar jam, ftohem një ditë... E merr parasysh këtë dobësi, shpirt? E marr, tha djali. Sido që të ndodhë, do të ruaj kujtimin tënd! Ose do pi helmin e do vdes, ose do t'i marr babait revolen dhe do vras veten! E bën? Po më dhe urdhër ti e bëj që tani! E dija, e dija këtë, sa me fat që jam! I kam menduar të gjitha, shpirt, na pret një udhëtim i vështirë, se për disa kohë do të zhdukemi, gjersa të bien gjakrat.

Kur po zhvishej, atij i ra blloku nga xhepi, ajo e pa dhe e mori në duar. Ç'është kjo, ti i ke shkruar këto? Ç'shkrim! Kot, është një romancë. Sa bukur! Ta botosh! Lëre fare, unë kam dashur ta djeg. S'më pëlqen më. Jo, jo, do ta daktilografojmë dhe do ta dërgojmë në ndonjë shtëpi botuese. Lëre këtu, dua ta lexoj. Ta kam falur, tha ai. Ajo buzëqeshi, ishte zhveshur lakuriq, e priste.

Balloja kishte filluar që në mesditë, dëgjohej që larg muzika. Kasapi mprehte thika. Ishte tërbuar, Evanthia nuk ia hapte më derën dhe ai nuk i dërgonte më mish.

Ajo ballo madhështore me tryezat mbushur plot e përplot me haje të zgjedhura, plot me qirinj të ndezur që lëshonin flakë drithëruese, me shandanët e mëdhenj që vareshin nga tavani i gdhendur, me lloj-lloj njerëz të veshur si për festë, ishte kaq grishëse, sa asaj të Burretajve i ra të fikët. Dy muaj më vonë, atë erdhën dhe e morën të sajët, se burri i qëlloi i ftohtë. Nëna shkëlqente nga bukuria. Ku e kish patur

tërë atë bukuri të fshehur? Tani që kish bërë flokët dhe ish stolisur si nuse, ajo të merrte sytë. Ish bërë e butë, nuk fliste shumë, sytë i shkëlqenin, dridhej e fërgëllonte me një si komb në grykë, sikur nuk përcillej dot. Më vjen për të qarë, i tha Evanthisë, po ty të vjen për të qarë? Më vjen dhe mua, si kjo ballo s'më kanë zënë sytë. E ka taksur për mua ai i flamosur, shtoi nëna, seç më vjen rrotull ditëziu dhe unë bëj sikur nuk e kuptoj! Më vjen rrotull, kupton ti, tutkune? Si s'të kuptoj, moj, po ai yti thotë gjë? Ç'ne, ai s'sheh asgjë! Këta burrat janë miopë, vetëm kur ia bën bamp, i hapin xëlat! Ajo e Tolajve s'mbahet. Me kolonelin e saj, la nam... Ai dorac, si s'ka turp, se kësaj tonës, i kanë ikur me kohë. I shoqi është gjallë, kjo cipëplasur hargaliset... Ç'pate ti, moj Evanthi, ku të gremisi mendja? Nuk e shikon, kasapi më tregon thikën! I ka rënë në kokë për mua, o do të më bëjë gruan e tij, o s'ka! Kujt ia tregon thikën, ai buburrec, dale pa i them Zoit unë!

Muzika dëgjohej aq shumë, sa të dyja gratë e mby-llën gojën. Kasapi iu afrua Evanthisë dhe e ftoi për një kërcim. Ajo nuk po tundej nga vendi. Nëna e goditi me bërryl: çohu, moj, mos lerë nam! Kërcim është! Ajo u ngrit dhe e ndoqi deri te pista. Atje ai i vuri dorën në bel dhe ajo zgjati të sajën në supin e tij, pastaj u shuan dritat dhe në pistë ra terri. Dëgjohej ndonjë ulërimë, shkrepte ndonjë e qeshur, dikush qëllonte me shuplakë, kërcisnin të puthura. Po kjo ishte shkruar në ftesë: kërcim në errësirë. Dhe të gjithë e kishin pranuar duke u hequr se ishte pak e tepruar, po prapë s'kishte ndonjë gjë të paturpshme, se s'mund të bëhej ajo punë për tre minuta sa zgjat një kërcim. Në të vërtetë kjo u pëlqye fort se, siç u shpreh ajo e Burretajve, gjella e huaj është ku e ku më e shijshme se ajo e shtëpisë. Sa herë thoshte fjalë të tilla, ajo shtrëngonte gjinjtë e mëdhenj. Kësaj s'i bëka gjë ai dordoleci i saj, qeshte nën buzë ajo e Tolajve. Atë e ftonin për të kërcyer, por vjehrra nuk e linte. Kudo shoqërohej nga vjehrra, edhe te kasapi, që gratë nuk e llogarisnin për burrë, se ishte i zi dhe vinte erë. Evanthia erdhi duke qeshur, rregullonte fustanin, fshinte faqet dhe buzët, shtronte flokët. Ç'të bëri, moj? e shtyu me bërryl nëna. E bëri si e bëri, po... Sa më shijoi! Ç'turp! Qofsh ti si i thua këto fjalë! Budallaçkë!

Atë kohë para nënës u paraqit Zoi, ai u përkul lehtë dhe e ftoi me mirësjellje për një tango: A e kam nderin të vallëzoj me gruan më të bukur të kësaj balloje? Nëna ngriu. Nuk ia kish thënë njeri tjetër ato fjalë. Ndoshta ju, zonjë, jeni mësuar me sallone më mondane, po ama zemra e kësaj balloje është zemra juaj! Nëna u ngrit si e goditur, nuk u besonte fjalëve të tij, po i vinte mirë që ai e respektonte kaq shumë. Ku kish parë ajo të tillë sjellje? Dhe nga kush pa, nga burri më i fuqishëm, që vriste dema me një goditje dhe me pesë thika me dy tehe!

Zgjati shumë ajo tango dhe kur mbaroi më në fund, me një klithmë entuziazmi, nëna erdhi me nxitim duke fshirë me shami fustanin e zhubravitur, duke rregulluar flokët, e hutuar, tepër e tronditur, sikur t'i ishte prishur shtëpia për herë të dytë. E, i tha Evanthia, si t'u duk? Nëna s'foli. E bëri? Oj, ç'të bërë, zorzopi! Nëna qeshi. Do ta mbaj mend këtë ballo! S'kishe faj. Të shijonte shumë, ç'turp! Prandaj ishte ajo errësirë në ftesë, ta kishim ndaluar! shpërtheu nëna. Ç'flet, moj, ç'do t'i mbajmë mend kësaj bote! Ku të shkoj, tha nëna, banjoja ishte dingas me gra e meshkuj, kam njolla sperme në fustan. Mbaji, i tha Evanthia, mbaji për kujtim! Po duken, moj, do lë nam! S'ta vë veshin njeri, sonte të gjithë e duan atë punë! Po sa në qejf më hyri ai kasap ziu? tha Evanthia. Sonte do të luaj për ty, më tha, do t'i bie violinës. Do t'i bjerë këngës cigane: Nata e syrit të zi. I thashë, po unë s'i kam sytë të zinj, o i luajtur, e ai më tha, do t'ia ndryshoj titullin, do ta quaj: Nata e syve blu! Sa më pëlqeu, po të presim, kur t'i bjerë violinës... Inatin e kishte me Zoin! Mos shkosh me të, më thoshte! Ç'ne, more, ç'më di ti mua! Jo, po ai po i merr me radhë gratë! Të bëjnë sytë, i thashë! Je çmendur, më duket! Ti më ke çmendur, më tha! Po a dëgjohen më këto fjalë, ka burra që digjen e përvëlohen për ty? Ja, kjo më pëlqen!

Djali rrinte në një cep, i menduar, sikur vuante e hiqte me shpirt. Ai i shikonte të gjitha ç'ndodhnin në atë ballo dhe vendosi t'ia marrë bllokun Evanthisë dhe ta ripunonte romancën. Ç'grua, mendonte, më tha të dua vetëm ty e më kërcen me kasapin, që e urren, gjoja... Do të vuaj në këtë jetë, do të vuaj e do të vdes i ri. Atë kohë u dëgjua violina, violina cigane dhe asaj i binte kasapi, që ishte shndërruar befas në magjistarin e ballos, ai i këndonte si me të qarë natës së syve blu e cila kishte kaq shume fjalë prekëse, sa të bënte të dridheshe nga një ndjenjë molisëse, ajo këngë aq prekëse fliste për një dashuri të madhe po tradhtare që përfundonte me një thikë në zemër. Të gjithë u ngritën në këmbë dhe duartrokitën, thërrisnin: edhe një herë, po ti qenke i madh, ku ishe fshehur deri tani, lëre dyqanin, bëj disqe, bëhu i famshëm! E shikon, tha Evanthia, e shikon kush është ai? Dhe ju, lëre evgjitin, vjen erë, po unë shikoj shpirtin e tij, talentin. Më ka rënë në kokë!

Ajo nxitoi ta përqafonte me lot në sy dhe ai, pa pyetur fare, kërkoi qetësi dhe pasi gjithçka u platit, tha, i larë në djersë: E dua këtë grua, po pranoi, i vë unazën në gisht dhe kjo punë merr fund! Pres të thotë: po! Po! Po, thërrisnin njerëzia, thuaj po! Edhe nëna ishte ngritur në këmbë dhe ulërinte: Puthe, moj, e nxirë! Ai i vuri unazën në gisht, e ngriti në krahë dhe u zhduk, ndërkohë që violina ra përtokë dhe u thye.

Djali doli nga salla dhe eci kuturu nëpër rrugë, ku ta shpinin këmbët. Ata bëjnë dashuri, ndërsa mbrëmë ajo ishte me mua dhe me lexonte pjesë nga romanca ime. A t'i besoj kësaj nate, asaj violine të mallkuar, që ta ngjethte mishtë, asaj Evanthie që shkëlqente, më e bukur se kurrë, që më tradhtoi me një kasap? Ia mori mendjen me atë violinën e mallkuar, me atë këngë të jashtëzakonshme. Ç'këngë! Kishte shumë shpirt. Ah, kasap, ma çave zemrën! Merre dhe shite nesër në atë dyqanin tënd të ndyrë! Ose gatuaja asaj dhe mbaroi kjo punë. Po si ndodhi ky ndryshim i menjëhershëm, kaq papritur? Ja, këtë nuk e besoj dot. Mos kthen mendje? Të shpresoj? Pëlqeu violinën e tij, romanca ime i është dukur kot fare. S'ka faj, unë s'di të shkruaj! Fitoi kasapi, ja, kjo s'durohet! Tani ata bëjnë dashuri dhe ai buburrec është duke kënaqur fluturën e tij. Ajo lëshon rënkime si me mua, e bën me të si me mua, i thotë po ato fjalë turpi si me mua, ja, ky është fundi i një dashurie! Ndoshta e merr në krahë dhe më vijnë rrotull, më tallin, po unë s'i vë re, ndonëse i ndiej. Flutura dhe buburreci, fluturojnë të dy, i ziu dhe bluja, nata dhe deti, zia dhe qielli, toka dhe ajri... Kishte pirë ca dhe po i pëlqente shumë kjo lesh-arapnajë e fjalëve pa ndonjë kuptim, kjo kotni, ky kaos i shpirtit që vuan. Ai e tregoi veten me atë këngë, me atë violinë, unë duhet ta tregoj veten me diçka, që t'ia kaloj kasapit. Këtë dashka dashuria! Fiton ai që ka sukses më shumë, ai që bën përshtypje të madhe, ai që dallohet mbi të tjerët, po unë jam ende kalama, ç'mund të bëjë një picirruk si unë? Unë nuk kisha guxim të kë një grua për vallëzim, druhesha se mos më qeshnin, ose këtë përshtypje e kisha vetëm unë. Evanthia s'm'i hodhi asnjëherë sytë, sikur të mos ekzistoja më. Po natën e kaluar ishim bashkë, natën e kaluar, kaq shpejt i harroi ajo ato orë të mrekullueshme, me aq shumë fjalë, plane, betime? Ç'di të bëj unë? Të shkarravis! I vinte për të qarë, po nuk qau, i dukej sikur e shikonte kasapi dhe kënaqej. Tani Evanthia i dukej e largët, e ftohtë, kaq e harrueshme, sa ia ndjeu harresën dhe u trondit. I hoqi këmbët zvarrë deri në shtëpi.

DHIMITËR POJANAKU

Shiu lexon trishtimin tim

poezi

SHTRATI KUR TI S`JE

I madh, i gjerë, alpin.
Unë mlidhem e mblidhem,
Mbështillem e mbështillem,
Struk duar e këmbë si nën një guackë mbrojtëse dhe prapë
Ngrij.
Ndriçomëni nga lart,
Jam si një kërmill mbi një bordurë të ftohtë.

DIMËR NË LIMAN

Ç'është ky lot thellë në liman?!
Era fryn
Por dot s'e than.

Varka e dashurisë,
Qan.

KUR FLASIN FËMIJËT

Po flasin fëmijët.
Erdhën nga gjuha e zogjve në gjuhën njerëzore.
Erdhën!
U ka mbetur një "r" që lëmohet dhëmbëve, buzëve
E bëhet "l" e ëmbël,
Një "th" e bryllët, çudibërëse,
Një "c" kristal.

Erdhën, po flasin.

Tulatuni ju fjalë të pasinqerta,
Pini në kaltërsinë e fjalëve të tyre,
Vishuni në blerimin e tyre,
Rrethojuni me pushin e ajkën e valë,
E nisuni,
Si të porsadala nga alfabetet.

Kur flasin fëmijët,
Gjuhët gjelbërojnë...

E DASHURUARA

Ajo e di ku flenë ditën ëndrrat.
Ku mbështeten natën ylberët.
Ajo e di orarin e pranverave, bulëzimin e sytheve,
Pluskimin e frutit;
Ajo e di kur lumenjtë lënë shtratet e bari brigjeve s'ngopet së piri,
Kur detet bien në baticë
E mezi çmallen te tokën,
Kur hapësirës del një yll i ri
E qielli sa s'përmbytet nga lumturia,
Ajo e di

Ajo që udhëkryqeve rri
E shpërndan fluturimet.

ERËS

Fry erë,
Fry!
Detet të ndërrojnë dallgë e të përmendin fundet,
Malet të dëgjojnë fyejt e pyjeve, grykave, luginave.
Gjethet e vjeshtës të luajnë danset e fundit,
Telat të ndiejnë fërgëllimat e teshës së nderur,
Balonat t'u çojnë fjalë reve,
Flamurët puthje qiejve,
Qoshkat e qeta të dridhen,
Prushet e fjetur të ndizen,
E unë,
Të tallazit gjoksin
E unë të rrah mendimin, ndjenjën,
Fry erë.

GJYSHES

Ku je?
S'më dëgjon?
Atherë unë po sajoj një grindje, një sherr,
Dhe ti, si
Mjeshtre pajtimi,
Do dalësh,
E do qetësosh gjithçka në limanet e lirishtet e tua.

Ndonëse e ikur,
Patjetër do dalësh.

Ku je,
E nisa shamatën.

S'JEMI MË SI MË PARË

Marrim lajmin se po bëhemi me fëmijë
Dhe s'jemi më si më parë.
Mbajmë mbi krye një brerore që na e lakmojnë të katra stinët,
U thërrasim grave me emrat më përkëdhelës,
Me shkurtimet më të dashura.
U vërshëllejnë parreshtur motivet e takimeve të hershme,
U vërtitim ca shirita ylberësh që veç ne i shohim,
Jemi si në ëndërr, si në zhgjëndër.

Lirikë jemi gjer në ind.

TRËNDAFILAT E VARREZAVE

Asnjë dorë nuk i këput
Asnjë nuk s`u afrohet,
S'i mbledh
E ata prapë çelin
Dimër e verë.
Mbajnë mbi vete petalet e thara
Si vetë dhimbjen
Si vetë vdekjen,

Dhe vetë i shkundin
Pjalmohen,
E çelin.

S`janë trëndafila dashuri.

Askush s`i këput.
E ata çelin

Dimë e verë.

YJEVE QË BIEN

Ku bini kur e zbraz kupa e qiellit
Ku?!
Rënçi në det,
Të shuheni përnjëherë!
Se do jetë tmerr të vdisni ngadalë,
Qiell duke parë.

FTESË PAJTIMI

Nxito t'i bëjmë një kurdh kësaj merie që po bren si demon.
Që po na rrëmben të folurat të parat
Po na ndan dhomat, rrugët, plazhet,
Po na varros kujtimet e na stis gabimet.
Nxito t'i bëjmë një kurth
T'i vëmë ura zjarri përreth,
Ta tërbojmë,
Ta valojmë!

Se edhe pak
Po vonuam edhe pak,

Afrojmë orën e ajsbergut!

SHELGJET LOTUES

Gjithnjë të heshtur, të ndrydhur
Si dashuri të pathëna.
Gjithnjë në përkëdheli, pështpërima, kujtime.
Gjithnjë në lot
Si nën një shi të fshehtë.
I rrëfehen vetëm lumit, zallit,
Ca rrethinave toke,
Ca netëve me hënë.
Gjithnjë të qetë, të patrazuar,
Larg zhurmës e bujës, pa emër, mënjanë.
Si nuk shpërthyet një herë?!
Si s'dhatë njëherë alarm?!

MALL I FSHEHTË

Pranë pyllit me bredha ra vjeshtë
Dhe bredhat i dogji zili e fshehtë,
Ç`është kjo stinë si mërmëritje
Atry e qetë atje e dridhshme
Aty dremiste si perëndimi
Më tutje digjej me ag agimi.
Aty vallëzonte me marramendje
Aty trishtihej nga caste ndarjeje.
Dhe bredhat kërkonin të ndjenin pak vjeshtë,
A nuk mund t`i merrte njëherë në kaq vjet?!
Po ishin krenarë veç shihnin përpjetë
Sa mmalli u mbedti I mbyllur I fshehtë

Dhe vjeshta se diti, se donin ca vjeshtë...

POROSI NATE*

Hidhe tej `dhe rroben e fundit.
Jam unë, nata e pagojë,
e pasy,
e paveshë.
Jam verbuar, shurdhuar, sakatuar,
Prej dashurive.
Hidhe!
Të feksin trupat e çveshur,

QIELLI NGRIN

Qielli ngrin.
Hodhi kuvertën ambulante të reve,
Dhe u mbulua me gjithsej.

Tash syri im,
Më ther për pak qiell.
Ther syri im.

Ngrin qielli, ngrin.

SPIUNKAT

Mëngjes për mëngjes, lulishtari merr vesh
Sekretet e mbrëmjes.
Ia thënkan lulet!
Ato, të urtat!
Ato, të butat!
Bëka sikur dremitin,
Por qenkan sy e veshë:

Përgjojnë mbrëmjeve
Kallzojnë në mëngjes.

Ato, të urtat,
Të bukurat!

LISI

Ç›i thua qiellit ti lis,
Është muzg, dremitje
E ti e ngacmon me gishtrinjtë e gjethtë,
E afron.
I trembesh ikjes të së kaltërës
Si braktisjes prej të dashurës.
Ç›i thua qiellit ti, lis,
Është muzg, dremitje
E ti s'nanurit,
S'mbështillesh,
S'bie në kujtime,
S'të josh serenatë e hënës.

I gris qiellit mbulesën e natës
Me kthetrat e vetmisë.

NJË DASHURI E MADHE DHE NJË DASHURI E VOGËL

Në fushën sa deti digjet një zjarr.
Fusha,
Ndonse lakuriq,
I rri ftohtë,
Mospërfillëse.
Fundet e fushës nuk mblidhen rreth zjarrit,
Fundet e fushës harbojnë pas horizontit,
Lakmohen tok,
Përpihen tok,
Shumohen tok.

E në zjarrin që digjet,
Ngrohet vjeshta e tretë,
Si vejushë e mardhur,
E zbehtë.

Fry!

SHIU LEXON TRISHTIMIN TIM

Ky shi ra qëllimisht.
Qëllimisht ende me një si tenjë të brishtë
Rrugët,
Sheshet,
Shpirtrat,

Vetëm kështu mund të lexojë trishtimin tim.

Poezitë u përzgjodhën nga libri me të njëjtin titull, botoi sh. b. "Naim Frashëri" Tiranë 1991. (red I. Yzeiri)

MARK SIMONI

Mesnata e të marrëve

tregim



Bash atëherë kur e kuptova se qeshë lodhur e rropatur kot, i cfilitur dhe i pa shpresë për ta gjetur shtëpinë e atij shkrimtari të librave të çuditshëm, në njërën prej rrugicave të ngushtë të asaj mëhalle, ia befi përpara meje një njeri, i veshur krejt allosoj. Qe njeriu i fundit që kisha ndërmend të pyesja, nuk kisha më durim. Dhe pastaj ashtu siç qeshë, i drobitur e telef, të kthehesha dhe të merrja trenin e jugut.

Sapo mu afrua, e dallova. Ai njeri qe krejt i luajtur mendsh.

-Duket se kërkon dikënd! -më tha.

Unë i përmenda shkrimtarin që kërkoja.

-Lëre të qetë! Eshtë në libër.

Këto fjalë kishin aq shumë situata brenda sa më çorientuan. Mbase po thoshte se ai atje po shkruante libër, mbase tregonte se po lexon librin e dikujtë, ndoshta qe i hutuar nga librat, është çmendur prej librash, nuk i duhet dreqit një lek se merret veç me libra. Të gjitha ishin të mundura.

Pasi ndenji një çast, duke më vështruar, më pyeti nëse edhe unë shkruaja libra?! Tunda kokën.

-Edhe unë vetë mund të shkruaj libra, po s'jam aq i marrë sa të merrem me to. Dhe pastaj çfarë të bëj unë, të çmendem!? Përderisa shkrimtarët dhe të çmendurit dallojnë të njëjtin ndriçim drite tek gjërat që shohin, (që askush tjetër nuk e dallon përveç tyre), tregon se shkruesit dhe të çmendurit janë të gjithë njëlloj. Ndaj dhe natën, më shumë se çdo gjë, e kanë kohë kthjellimi.

Pastaj, sikur të kishte dalë në rrugë vetëm e vetëm për të më shprazur dhe thënë ato fjalë, pa më përshëndetur fare, më ktheu shpinën, u vodh e bishtnoj, dhe iku rrugicave të ngushta të asaj mëhalle.

Ika dhe unë.

Dhe vetëm atëherë kur pata hipur në tren dhe qeshë rehatuar në kompartimentin tim, mu kujtua se, në librin që kisha në qantë, në kopertinën e pasme të tij, qe fotografia e shkrimtarit që kërkoja atyre zgëqeve të asaj lagjeje gërmuqe. E nxora ta shoh. O Zot. U tremba. Në fotografi qe bash portreti i atij burrit të çmendur që kisha hasur atje, pak përpara se të ngjitesha në tren. Kishte qenë vetë ai, shkrimtari që s'pata lënë vend pa e kërkuar, dhe befas e kisha hasur krejt kot. U ngrita vrik në këmbë, dhe mora për nga dyert e zbritjes, por treni tashmë e kishte nisur trokun.

***

Me tu kthyer në Shqipëri, sa lashë qantat në shtëpi, ia mësyva drejt qytetit tim të vogël, ku pata lindur.

Megjithëse e dija mirë se të marrët e fëmijërisë sime kishin kohë që patën vdekur, nuk kuptoja se çfarë po më beditej nëpër mend dhe besoja se, patjetër që ato vazhdonin të silleshin akoma nëpër mëhallat e vjetra me kalldrëm, rrugicave të ngushta, përbrij avllive të shtëpive mbuluar me tjegulla dhe me puset në mës të oborrit.

Sa mbërrita në mëhallat e mia, pyeta për to.

"Thonë se vetëm natën dalin bregut të lumit, ndezin do zjarre të vegjël, pjekin pulëza të zeza që ua vjedhin gjuetarëve, pijnë raki me tasa, dhe këndojnë këngë e vaje. Muzikën e vjolinës së tyre të vjetër ka njerëz që e kanë dëgjuar, por për t'i parë, nuk i ka parë askush".

Në mesnatë, duke ndjekur bregun e lumit, ua gjeta zjarret që kuqlonin terrin. U afrova deri aty ku mbërrinte vetëm pak dritë, dhe që nuk mund të më dallonin. Nuk ishte kush. Përrreth, mbi ca velenca e qilima të shtruar dhe të hedhur vend e pa vend, kishte pjata, jastekë e batanije, rraqe gjithëfarë lloji, demozhanë të boshatisur, kapota të rënda, tesha të mbledhura e të bërë kapicë. Më tutje qe një karrocë rrangallë me tri rrota, (të katërten e kishte të këputur), që e patën mbuluar me një qadër të madhe, si karrocat e dikurëshme të teatrove shëtitës. Mbase e kishin për udhëtime të largëta.

Prita kundrull. E ndjeja se po afronte koha kur vinin, mbasi dhe pak e binte mesnata.

Nga përtej, nëpër terr, dëgjova cingrima të zbehta metalesh që afroheshin ngadalë. Kur u fut në dritë e njoha. Më kujtohej qysh para 50 vjetësh kur kisha qenë fëmijë. Nuk pati ndryshuar fare. Ishte Luma, ai plaku që qalonte dhe mbante lidhur në brez një rreth të madh, në të cilin pati vënë qindra çelësa, të mëdhenj e të vegjël, të ndryshkur e të rinj, të saktë, të shtrembër e batalla. Aq çelësa sa nuk i kishte dot i tërë qyteti. E mbaja mend që shëtiste me ta në brez gjithë ditën e ditës, dhe i binte vërdallë qytetit qosh e më qosh. Unë nuk e kisha mësuar asnjë herë nëse nga tërë ajo tufë çelësash Lumës i ishte dashur të paktën një herë ndonjëri. Qe i mjerë fukarai, i vobegtë, dhe e dija mirë se ai s'kishte për të hapur kurrë në jetën e tij as ndonjë kanavetë teneqeje ku fshihte lekët, as ndonjë valixhe letrash a dokumentesh të rëndësishëm, as ndonjë arkë teshash e petkash të reja, kurrë ndonjë kapanxhë a kapak. E ngaqë jetonte i vetëm, në një kthinë të vogël, poshtë ca shkallëve, për çudi, edhe dera e vet nuk pati kurrë çelës, mbasi ai e mbyllte vetëm me një gozhdë të madhe.

Zuri vend mbi një gurë papërdhok, hoqi nga brezi rrethin e madh të çelësave dhe filloi t'i numrëonte një e nga një, krejt siç numërohen monedhat. Pastaj i ulur galuc shpuploi disa pulëzat e vogla e të zeza, i hodhi në prushin e zjarreve dhe më në fund u shtri në kokërr të shpinës, mbi një velencë të pistë, me rrethin e çelësave në brez, me pllëmbët nën kokë, duke soditur qiellin e errët.

Me vete pata marrë një bllok të vogël shënimesh, aparatin fotografik dhe tri katër fletë për të bërë skicën e portretit të ndonjërit.

Diku pas shpinës sime, shugulloi zëri i një autoparlanti të qjerrë, që thoshte vazhdimisht: "po japim lajmet". Pasi foli gjatë nëpër terr për luftën në Vietnam, Kamboxha dhe Laos, lajmëroi se të nesërmen pasdite do të hapej dyqani i vajgurit, se autobusi për Shëngjin qe prishur, se Laja që shiste kripën kishte rënë e sëmurë dhe pati zënë shtratin, (gojët e liga thonin se i patën bërë magji të keqe njerëzit e burrit). Lajmi i fundit që doli nga hinka u tha gjithë kob se, nëpër qytet kishte rënë lija e pulave dhe qerosa….

E mbaja mend zërin e tij prej vitesh. Ishte Hidri i Milotit. Qysh se pati filluar lufta andej dhe deri sa mbaroi, ai njeri një palë lajme jepte, ku përditë vriteshin me qindra armiq dhe asnjë, po asnjë për be nga të Vitnamit, Kamboxhas apo Laosit.

Mbërriti. E përplasi hinkën për tokë, i tha Lumës se njerëzit nuk ia dëgjonin më lajmet, dhe shkoi drejt zjarreve ku Luma pati vënë pulëzat që po përzhiteshin dhe nxirrnin tym. Sa e preku mishin e njëres, e tërhoqi dorën shpejt, mbasi siç duket u dogj. Prej kapicës së teshave, nxori një shishe të fshehur rakije, dhe pastaj iu lut Lumës t'i jepte dhe një herë laps e letër.

-Kam dy lajme të reja dhe mos i harroj:

Limi ka sjellë nga Tirana krëhra me dhëmbë të shpeshtë, si dhe shitësin e xhevrekëve dhe gurabijave e kishte zënë qymyri me një magjype.

Donte ta zgjaste akoma më shumë këtë punën e sevdasë, por, për dy dekika ia behu gjithë pompozitet, me tërsëllimë dhe sokollimë, i vrejtur dhe me shikimin e hedhur tej në terr, Marka Fana. Bënte sikur sapo pati zbritur nga kali, por kalë nuk kishte askund. Duke ecur në marsh, bërtiti me të madhe se "Qe mbreti i Arabijes" Pastaj fërkoi, si në teatër, mjekrrën e thinjur si shkurre me brymë, rrahu gjoksin me grusht dhe e ngriti akoma më fort zërin se, "qe vërtetë Mbreti i Arabijes". U ndal, vështroi rrotull, duke pritur ndonjë nderim, dhe pasi asnjëri nuk ia hodhi sytë, lëshoi përtokë trastat me gurë, ndonjë rrungicë bukë, dhe në fund filloi të çvishte krenarinë e tij. Hoqi dy shpatat, tri thikat e ndryshkura, një sakicë që e mbante mbas vetes si patllake, mburojën që e pati varur pas supit si trofe gjahu, dhe pasi u lehtësua, u shtriq duke shugulluar, (siç duket qe mpirë nga pesha e armatimeve), dhe ra shakull në atë copë livadh.

Pas, si dikur, Marka Fanën e ndiqnin përherë dy dishepujt e tij.

Njëri ishte Nusi i sarikanës, që në një bodrum të errët, nëpër ca kazanë të mëdhenj, mes avujsh e magjishë, ziente lëngje parfumesh, dhe lutej që blerësit e tij të kishin fat në martesë.

Tjetri qe Ndoc Kadoshi, me kostumin e tij bezhë dhe këpucët e bardha me majuc, me mustaqet spic dhe favoritet si harta e Italisë. Thoshte se kishte qenë aktor i madh filmash në Romë, (por filmat i qenë ndaluar), dhe se në kohë të luftës pati qenë edhe parashutist . "Sa mirë do të kishte qenë sikur, ajo dreq parashute të mos i hapej, dhe të kishte vdekë njëherë e përgjithmonë, dhe të mos e kishim sot nëpër këmbë, me gjithë këto rrena që na thotë,", e mallkonte Tina, gruaja për të cilën thuhej se qe e dashura e fshehtë e Ndocit, por që e urrente për vdekje sa herë që ziheshin.

Ndoci filloi të shante e të kastërgjohej, se përherë dikush i vidhte kremastarin, ku ai duhej të varte kostumin e tij bezhë, "atë petk zotnije që e kishte ble në Itali", të cilin më vonë ia merrte në dorë dhe ia përfumoste Nusi me sarikanën e tij aromatike, bash me atë shishen që e ruante veç për Ndocin dhe askënd tjetër në këtë botë. Kushtonte shumë, por për Kadoshin e kishte falas, se edhe Ndoci e donte fort Nusin, ia jepte sa herë kostumin bezhë për ta veshur, sidomos kur shkonte të takonte fshehtas atë viranen e tij. Vdiste për danaq.

Zunë vend të dy pranë Marka Fanës, morën gjithë përvlim pulëzat e zhuritura, dhe i shtrinë në ca kartona kutishë, hodhën raki nëpër kallaqe, thyen në gjunj një copë të madhe buke, dhe mbasi u rehatuan ia nisën një kënge dashnije, për një vajzë që kishte vdekur në sanatorium nga veremi, dhe për djalin që e kishte dashur, që shkonte përditë te varri i saj.

S'kaloi shumë dhe mbërriti dhe Prena e spitalit, me shishen e saj të ujit të bekuar, (që e mblidhte lart e poshtë, përrenjëve ku lante kokën e saj, me ca flokë të gjatë si flokë shtrigash). Iu afrua sejcilit dhe i spërkati mbi krye, njëlloj si t'i përmjerrte, duke u përshpëritur se po i bekonte. Por të gjithë e shporrën me inatë, e i thanë që t'iu hiqej qafe me gjithë magjitë e saja.

Në fillim nuk e kuptova se, përse vinin veç e veç, me një rradhë të caktuar, si aktorët që ngjiten në skenë për tu përshëndetur me publikun, të vënë në një rend, njëri pas tjetrit, me një interval pothuaj të barabartë kohe. Por vetëm kur plasi sherri për rradhën e viteve se kur pati vdekur njëri e kur pati vdekur tjetri, e kuptova, që rradha ishte sipas viteve të vdekjes së tyre. Pra i pari pati ikur nga kjo botë Luma, me varguan e çelësave, pastaj Hidri me autoparlantin e tij që nuk qe gjë tjetër veçse një ybrik i vjetër që ia kishin hequr fundin, Marka Fana pa kalë, por me shpata e k'mesa, si dhe dy ndihmësit e tij Nusi i sarikanës dhe Ndoc Kadoshi, që pati qenë rrëzuar nga maja e minares, ku pati hipur për tu hedhur me një parashutë që e kishte shpikur vetë ai, por që nuk iu hap. Thuhej se të tre qenë në një varr të përbashkët.

Nga terri, dhe drejt e në dritë ia behu Nedusha, gjithë tersëllimë, fjalë të pista e kastërgjim, veshur me një fustan me ca lajle lule për ibret, me këpucët me taka që i kishte dy numra më të mëdha, me buzëkuqin e saj të ndezur flakërim, që e zhgrryente pa kujdes rreth e rrotull buzëve. Ajo që në vajzëri, e mbaja mend, piklonte me laps kopjativ fytyrën e saj, se kishte merak të dukej me nishana.

Sapo mbërriti u kërkoi se, kush atë natë do të bënte dashni me të, mbasi qe e mërzitur për ca gjëra që nuk thuheshin, i kishte sekret. Por, kur pa se askush nuk ia vari, futi dorën nga jaka e drejt në kraharor, duke nxjerrë gjithë krenari njërën cicë, që u var deri në bark, e fishkur si qafa e një pate të vrarë, me sqepin poshtë. Ndërsa me pëllëmbën tjetër filloi të rrifte dafllaku, dhe sa herë i binte, u thërriste atyre, gjithë kënaqësi; Na! Na! Na!

E mbaja mend mirë Nedushen. Nëpër lagjen e vjetër të fëmijërisë sime sillej vërdallë, duke bërë shamatë e duke sharë dynjanë. Nedusha qe një plakë zevzeke dhe e mbrapshtë, që i dilte punë me këdo. Të shante e të kërdiste, zihej e të turrej me shkop. Ne fëmijët e kishim frikë si dreqin. E gjeje rrugicë më rrugicë, me nallanet e vjetra që kërcisnin kalldrëmit. Pinte duhan të keq, flokët rrokopujë si të qe ngritur atë çast nga gjumi, një fustan të dalë boje dhe zërin e trashë si burrë. Madje thuhej se po t'i afroheshe pranë i dukeshin dhe pak mustaqe. Kishte një shtëpi të vogël, pa burrë e fëmijë, vetëm qyqe, vetëm një të afërme që jetonte jashtë.

Nedusha mbante inatë me të gjithë, dhe shfrynte mbi ato që i dilnin përpara.

Një mëngjes, krejt papritur, u hap fjala nëpër qytet se Nedusha do të shkonte në Itali, tek kushërira e vet. Prej tridhjetë e sa vitesh, qysh se qenë mbyllur kufinjtë, vetëm një zyrtarë pati qenë me një delegacion në Bashkimin Sovjetik, dhe një këngëtare kishte shkuar me Ansamblin e Shtetit në Kinë. Dhe e treta që do të gjezdiste botën qe Nedusha. Dhe ku? Në Itali. Akoma pa marrë fjala dhe habija dhenë, gratë e zyrave iu vunë punës për ta rregulluar e sjellë në fe Nedushën. I blenë teritalna kineze, rroba, çanta, këpucë lustrafin, shalle me ngjyra, çadër me lule, rruaza me kokrra të mëdha. E çfarë nuk i grumbulluan për ta bërë zonjë. Do të përfaqësonte vendin tonë atje ku do shkonte. Dhe ç'hoqën për ta veshur. Ditën kur u nis doli tërë qyteti të bënte sehir. Nedusha qe shpërfytyruar. Qe bërë akoma më e shëmtuar nga ç'kishte qenë. Rrobat nuk i rrinin për së mbari, dukej allosoj, qe hukubet. Këpucët nuk i binin mirë dhe nga takat herë pas

(Vijon në faqen 19)

205 vjet nga lindja e Arbëreshit të shquar Francesco Antonio SANTORI

Nga Klara Kodra, Vilma Proko

Viti 2024 shënon dy përvjetorë të rëndësishëm dhe një ngjarje të shënuar për historinë e gjuhës dhe letërsisë shqipe, 205-vjetorin e lindjes së Franqisk Anton Santorit në Picilì, (Santa Caterina Albanese), më 16 shtator 1819 dhe 130-vjetorin e vdekjes në Shën Japk (San Giacomo di Cerzeto), më 7 shtator 1894.

I. Francesco Antonio Santori është cilësuar nga studiuesit si më prodhimtari ndër shkrimtarët arbëreshë të shekullit XIX, autor themelues i disa gjinive letrare në trashëgiminë e shqiptarëve. Ka lëvruar në arbërisht: poezi, sonete, poema, novela në vargje, dramë, melodramë, tragjedi, komedi, satirë, fabula, roman, i cili, sipas profesoreshë Klara Kodrës: "bëri një vepër prej pionieri, duke çarë "tokat e virgjëra" të letërsisë shqiptare, dramaturgjinë, prozën, satirën dhe duke e pasuruar këtë letërsi në gjini dhe lloje, shfaqi, gjithashtu, një pjellori marramendëse në numrin dhe vëllimin e krijimeve të tij" (K. Kodra, "Santori poet dhe dramaturg", 2020, prej 268 faqesh, botim i Qendrës së Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë të Akademisë së Studimeve Albanologjike-sot Akademia e Shkencave e Shqipërisë, f. 9.

Santori është një ndër intelektualët arbëreshë që morën përsipër detyrën e vështirë të krijimit të një tradite letrare, me anë të dokumentimit dhe mbledhjes së zërit të popullit, në përpjekje drejt rivlerësimit të identitetit të tyre, për shkak të nostalgjisë therëse të djepit të identitetit të tyre, edhe pse në një pozicion të dorës së dytë, për shkak të vështirësisë së botimit të veprave të tij. Që në vitin e largët 1867 Dora D'Istria në veprën *Shkrimtarët shqiptarë të Italisë jugore* (*Gli scrittori albanesi dell'Italia meridionale)* e paraqet Santorin si përfaqësuesin më të kompletuar të kulturës shqiptare që ka shkruar për shtresën më të varfër të kolonive[1], duke shprehur një vlerësim të sinqertë për të dhe dëshirën për të njohur shkathtësinë e prodhimit të tij letrar dhe potencialin e madh që fshihej pas një prodhimi të mjerueshëm që nuk nxirrte në pah imagjinatën e madhe dhe përgatitjen solide të Santorit. Ndryshe nga miku i tij De Rada, kishte një kulturë në thelb autodidakte dhe një qasje latine, sepse në vendlindjen e tij riti romak ishte zbatuar tashmë për më shumë se një shekull. Më tej, ai e kreu edukimin kulturor në Manastirin e Minimëve të Reformuar të San Marco Argentano.

Ende deri më sot nuk kemi një inventar të përfunduar të veprave të Santorit. Veprat që mbetën dorëshkrim patën fatin e keq sepse u bënë të njohura shumë vonë, por edhe të mirë sepse mundën të dalin si botime kritike dhe të ofrojnë mundësinë për të na shfaqur një Santor të pamanipuluar gjuhësisht.

Francesco A. Santori me dëshirën e papërmbajtshme për të kapërcyer kufijtë dhe vështirësitë u përpoq të krijonte mjetet e nevojshme për të përballuar sfidat gjuhësore dhe kulturore me të cilat u ndesh. Gjuha që kishte mësuar nga e ëma kishte sharmin e të diturit për të shprehur ndjenjat fillestare dhe fuqinë e të qenit një mjet komunikimi, por shumë të kufizuar për të shprehur koncepte dhe situata komplekse që kërkojnë një fjalor të pasur dhe të sofistikuar.

Proza shqipe, ose thënë më mirë, romani shqiptar lindi me Santorin, i cili u përball menjëherë me këtë detyrë të vështirë. Në atë periudhë ai pati mundësinë të takonte Domenico Mauro-n me të cilin ndante aspiratat politike, Jeronim De Radën, Vincenzo Padula-n dhe shumë shkrimtarë të rinj dhe aktivistë politikë.

Santori nuk u ndal te romani në vargje, por u përpoq të krijonte duke shkruar prozë në italisht dhe shqip, me tri përpjekje që tregojnë evolucionin e formimit të tij letrar: "Bija e mallkuar", "Ushtari shqiptar" dhe "Sofia Cominiate", e botuar në *editio princeps* në vitin 2011. Meqenëse fjalorin e bollshëm e të larmishëm nuk e gjen te arbëreshët, Santori përpjekjen e parë e bën te "Bija e Mallkuar", shkruar tërësisht në italisht, studim të cilit i kushtoi shumë përpjekje. U botua në vitin 1863 nga Tipografia Bruzia e Kozencës, për të përfituar nga dashamirësia e botuesit arbëresh nga Shën Mitri (San Demetrio Corone), Giovani Battista Marini, të cilin e kishte takuar në Kozencë me rastin e përurimit të tipografisë së tij të re, por nuk pati suksesin që pritej në skenën kombëtare. Për fat të keq pas disa vitesh libri humbi çdo gjurmë.

Sipas studiuesit Oreste Parise data e shkrimit duhet të jetë në intervalin midis botimit të "Canzoniere Albanese" (1839) dhe "Il Prigioniero Politico" (1848), një datë ndoshta më afër të dytës, rreth viteve 1845-1846. Ky roman, i pari i këtij lloji në letërsinë shqipe, përmban në mënyrë embrionale disa tipare që Santori do të arrijë t'i zhvillojë në romanet e mëvonshme, si: prirja për të pasqyruar pasione të stuhishme, hiperbolat tipike romantike të subjektit, psikologjizmi, etnografizmi, ambivalenca, ndërthurja e një romantizmi të skajshëm me elementët e para të realizmit etj. Po sipas Parise-s, pyetjes se çfarë interesi mund të kishte sot ripropozimi i një vepre të harruar sigurisht të një teme jo aktuale, të shkruar në një italishte më pak se bashkëkohore, mund t'i jepet një përgjigje: *kjo vepër e rizbuluar është një element shumë i dobishëm për të kuptuar më mirë një autor si Santori, i cili konsiderohet i rëndësishëm në letërsinë shqipe dhe që ende njihet pak për jetën dhe mendimet e tij.*

II. Viti 2019 që përkoi me 200-vjetorin e lindjes së Frangjisk Andon Santorit (1819-2019) u quajt "Viti santorian", e gjatë së cilit u organizuan disa veprimtari shkencore brenda dhe jashtë vendit.

1. Në marsin e vitit 2019 u organizuan në Shkodër *Ditët Santoriane* ku u çel një ekspozitë me dorëshkrimet e Francesco A. Santorit, të cilat gjenden në Arkivin Qendror të Shtetit në Tiranë. Për shpirt të Tij u mbajt edhe një meshë në <u>Katedralen Katolike të Shkodrës</u>. Pjesë e rëndësishme e këtyre manifestimeve ishte Sesioni Shkencor Ndërkombëtar me temë "Roli i shkrimtarit dhe i françeskanit arbëresh Frangjisk Andon Santori për Rilindjen Kulturore Kombëtare" (*"Il ruolo dello scrittore e del francescano arbëresh Francesco Antonio Santori per la Rinascita Culturale Nazionale"*), organizuar nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Qendra e Studimeve Albanologjike e Universitetit "Luigj Gurakuqi", në bashkëpunim me Fondacionin Universitar "Francesco Solano" (Itali) dhe me mbështetjen e Komunës së Cerzeto-s (Qanës), Komunës së Santa Caterina Albanese-se (Picilìsë), Arqipeshkvisë Shkodër-Pult, Provincës Françeskane në Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave. Kumtesat e mbajtura lëvruan tema të larmishme si: *Personaliteti i Frangjisk Andon Santorit dhe pasuria gjuhësore në krijimtarinë e tij në prozë* (Mimoza Priku&Artan Haxhi); *Kontributi i katedrës së Albanologjisë të Universitetit të Kalabrisë për studimet dhe kërkimet santoriane* (Francesco Altimari); *Variantet alfabetike të përdorura në veprën e Santorit* (Tomor Osmani*); Për botimin e veprës letare të Frangjisk Andon Santorit* (Mateo Mandalà); *Frangjisk Andon Santori në dyqindvjetorin e lindjes së tij* (Anton Berisha); *Cikli rrezatues me vjersha te vëllimi "Këngëtorja arbërore" i Frangjisk Andon Santorit* (Alfred Çapaliku); *Identifikimi i veçorive psiko-sociale përmes gjuhës së veprave të Santorit* (Rrezarta Draçini); *Elemente të gegërishtes në veprën e Santorit* (Erzen Koperaj); *Çështje të letrarësisë në "Këngëtorja arbërore" e Santorit nga arbërishtja në shqip* (Ermira Aliaj); *Tipare të antroponimisë dhe toponimisë në dramat e Santorit* (Merita Hysa &Rezearta Murati) dhe *Emira" e Santorit-një dramë për skenën shqiptare* (Gëzim Puka).

Konferenca u mbyll me një shfaqje teatrale santoriane nga studentët e Universitetit të Shkodrës "*Luigj Gurakuqi*" dhe u pasua nga këngë popullore të korit arbëresh "*I Paradosis"- G.B.Rennis*". Edhe të nesërmen vijuan këngët arbëreshe dhe me motive santoriane nga grupi etnomuzikor "Shpirti arbëresh", kori "Picilia" dhe kori arbëresh "I Paradosis"- G.B.Rennis" që përcollën emocione tek të gjithë të pranishmit.

2. Në shtator të po këtij viti Fondacioni Universitar "Francesco Solano" dhe Laboratori i Albanologjisë (DiCES) i Universitetit të Kalabrisë, në bashkëpunim me Bashkitë e Picilisë dhe të Qanës organizuan Konferencën Ndërkombëtare: "Françesk Anton Santori, Vepra dhe koha e tij: Kontributi i shkrimtarit dhe arbëreshit françeskan për letërsinë, gjuhën dhe 'Rilindjen' kombëtare" ("Francesco A. Santori: La sua opera e il suo tempo: L'apporto dello scrittore e del francescano arbëresh alla letteratura, alla lingua e alla 'Rinascita' nazionale"[2]), përkatësisht, më 15 dhe 16 shtator në katundet e Santorit, Sënd Japk të Qanës dhe në Picili, ndërsa më 17 shtator në Universitetin e Kalabrisë në Kozencë. U ndjeva e nderuar të marr pjesë në këto tri ditë të rëndësishme santoriane plot me aktivitete të ndryshme, e duke referuar një kumtesë të përgatitur së bashku me profesoreshë Klara Kodrën, studiuesen e talentuar të letërsisë shqipe e sidomos të asaj arbëreshe, më 17 shtator 2019 në Universitetin e Kozencës (titulli i kumtesës jepet më poshtë).

Në Sënd Japk (Sheshi "F. A. Santori") në pasditen e 15 shtatorit u shfaq drama "Emira" (reduktim teatror me disa pjesë të dramës nga Nando Pace, të shoqëruara me këngë popullore të nxjerra nga veprat santoriane: grupi "Shpirti Arbëresh" i Qanës dhe grupi i Picilisë, me recitimin e Brunilda Latos.

Në Kishën e Shën Pandaliut (Santuario Di S. Pantaleone) të Picilisë u mbajt Sesioni I i Studimeve Santoriane me tematikë nga fusha e filologjisë. Punimet e këtij sesioni i çeli Prof. Francesco Altimari me një *Paraqitje–Hyrje* dhe në vijim u referuan kumtesat: *Poezi apo rrëfenjëza të vargëzuara? Vëllimi "Satirat" i A. Santorit* (Floresha Dado); *"Këngëtorja arbëreshe" e Santorit përballë "Këngës së këngëve" dhe "Canzoniere" të Petrarkës* (Anton Nikë Berisha); *Meditime rreth poemës "Këngëtorja arbërore" të Françesk Anton Santorit* (Alfred Çapaliku); *Francesco Antonio Santori në produksionin teatror të shekullit të 19-të: Udhëtimi historik dhe identitar i Italisë së Risorgimentos dhe pas-bashkimit* (Maria Teresa Morelli); *Në një variant ms. i panjohur për "Ushtarin shqiptar" nga Francesco Antonio Santori në kontekstin kohor* (Kamber Kamberi); *Anton Santori në historitë e letërsisë shqipe* (Dhurata Shehri); *Francesco Santori: mes specifikës së romantizmit arbëresh dhe modernitetit* (Blerina Suta) dhe *Studime për F. A. Santorin të paraqitura në Seminarin për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare* (Bardh Rugova).

Më 16 shtator u mbajt Sesioni II i Studimeve Santoriane në fushën e letërsisë me kumtesat: *Rapsoditë e Santorit* (Vincenzo Belmonte); *"Emira" e Santorit për të mirën e skenës shqiptare* (Gëzim Puka); *Francesco Antonio Santori në studimet kritike të Francesco Solanos* (Fiorella De Rosa); *Ndërthurja e elementeve realiste dhe romantike në dramën "Emira" të Santorit* (Gëzim Rredhi); *Bota e katundit në veprën letrare të F. A. Santorit* (Kastriot Gjika); *Analiza e metaforës në veprën Emira nga Francesco Antonio Santori* (Monica Genesin); *Françeskani arbëresh në atelienë teatrore universitare! Drama e parë shqipe "Emira" e Anton Santorit në skenën e Teatrit Kombëtar Eksperimental "Kujtim Spahivogli" në arbërisht, në Festivalin Teatror Universitar, Tiranë, 2019* (Erenestina Halili); *"Mbë kënëka*

1 Dora D'Istria, *Gli scrittori albanesi dell'Italia meridionale* di Elena Ghika. (Con note del traduttore), Palermo 1867. "Il P. Antonio Santoro è un rappresentante più complete della cultura albanese per avere scritto nella favella delle colonie", f. 11.

2 https://www.fondazioneuniversitariasolano.it/wp-content/uploads/2019/10/CONFERENZA-SANTORI-2019-PROGRAMMA-RELATORI-E-ABSTRACTS.pdf

vallesh" një shkrim i pabotuar i Francesco Antonio Santorit (Saverina Bavasso); *Veprat fetare të Françesk Anton Santorit dhe tradita liturgjike në gjuhën shqipe. Një krahasim filologjik i veprës liturgjike të Santorit me atë të Budit e Bogdanit* (Erzen Koperaj); *Mbi tragjedinë "Neomenia" të Santorit–botimi i Prishtinës, 2001* (Labinot Berisha) dhe *Fabulat e Ezopit të përkthyera në italisht dhe shqip nga Francesco Antonio Santori* (Sandra Domanico). Seanca u mbyll me dokumentarin "Hora", realizuar nga regjizorja me origjinë arbëreshe Maria Alba, mbi historinë e një gruaje me origjinë arbëreshe, e cila kthehet çdo verë në qytetin e saj të lindjes, San Nicola dell'Alto, qyteti ku ajo kish jetuar për më shumë se pesëmbëdhjetë vjet.

Ditën e tretë të punimeve të konferencës (17 shtator 2019) u mbajt Sesioni III i Studimeve Santoriane në fushën e gjuhësisë me referimet: *Frangjisk Andon Santori-përfaqësues i shquar i kulturës arbëreshe. Disa veçori gjuhësore të prozës santoriane* (Artan Haxhi); *Neologjizmat në romancetën e Santorit "Brisandi, Letixja dhe Udhadheni"* (Klara Kodra&Vilma Proko); *Santori dhe çështja e gjuhës në Rilindje: disa konsiderata gjuhësore* (Gëzim Gurga); *Emira e Santorit: disa vëzhgime me karakter gjuhësor* (Giuseppina Turano); *Gjuhë "të vogla", "ndë avs të faregjëit", e gjuhë "të mëdha", "të stoneónme": Paradigma e Santorit (1819), e Mitkos (1820) dhe e Kupitorit (1821)* (Dhori Qirjazi); *Diminutivët dhe roli morfopragmatik i tyre në krijimtarinë e Santorit* (Mimoza Priku); *Sistemi shkrimor dhe identifikimi i dukurive fonologjike nga Santori* (Aljula Jubani); *Zgjedhjet alfabetike të Francesco Antonio Santorit në veprat e tij* (Emilia Conforti); *Vështrim mbi udhëkryqet e globalizimit në popujt e Ballkanit perëndimor* (Rezarta Draçini); *Vëzhgime leksikore dhe semantike mbi dramën Emira të F. A. Santorit* (Genc Lafe); *(Ri)ndërtimi i identitetit në kushtet e dygjuhësisë* (Majlinda Bregasi) dhe *Analizë e disa trajtave foljore dhe e kuptimeve të tyre në veprën "Emira" të F. A. Santori-t* (Flora Koleci).

Sesioni IV i Studimeve Santoriane iu kushtua artit dhe historisë me kumtesat: *De Rada, Anselmo Lorechio, dhe zhvillimi e arteve grafike në botimet e shek. XIX* (Shpend Bengu); *Tiparet krijuese dhe gjeniale të Francesco A. Santorit* (Battista Sposato); *Mendimi politiko-shoqëror i Francesco Antonio Santorit* (Oreste Parise); *Francesco Antonio Santori në kujtesën popullore* (Carmine Stamile); *Ekonomia dhe shoqëria e S. Giacomo në vitet santoriane* (Italo Sarro) dhe *Rapsoditë, dorëshkrimi i Françesko A. Santorit në kontekstin europian të vlerësimit të folklorit* (Olimbi Velaj&Naile Malaj-Imani).

3. Gjithashtu, në kuadrin e këtij viti të shënuar santorian Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë i Akademisë së Studimeve Albanologjike (sot ASHSH) organizoi më 20 dhjetor në Tiranë Konferencën Shkencore Ndërkombëtare: "Franqisk A. Santori dhe trashëgimia gjuhësore e letrare shqipe", që u botua në vitin 2022 (me 460 faqe). Studiuesja Bruci-Sauku në *Parathënien* e këtij botimi shprehet se "...janë përfshirë me synim pasurues edhe ilustrime të përzgjedhura nga pena e Santorit, brendashkruar kumtesave apo ndërmjet tyre, si një kontakt i drejtpërdrejtë me autorin dhe plotësim i argumenteve të trajtuara në kumtime". Më poshtë po rendisim titujt e kumtimeve në këtë veprimtari: *F. A. Santori mes njohjes e mosnjohjes* (Merita Bruci-Sauku); *Franqisk Anton Santori dhe letërsia arbëreshe* (Italo Costante Fortino); *F. A. Santori në dritën e disa të dhënave të reja biografike* (Giovanni Belluscio - sot i ndjerë); *"Valle Ĥarës madhe" ("La ridda della grande festa"): Una chiave di lettura. Il regno delle Due Sicilie, La Costituzione e Gli Arbëresh* (Oreste Parise); *F. A. S. ndë mend të popullit* (Rosario Golemme). Nga pikëpamja e këndvështrimit letrar u kumtuan temat: *Santori përmes lirikës dhe satirës* (Laura Smaqi); *Prologu i Këngëtores arbëreshe i F. A. Santorit, i shqyrtuar përmes prurjeve teorike dhe koncepteve të përpunuara në analizën e diskursit dhe pragmatikën letrare* (Tomor Plangarica); *Përkime midis rapsodive të Santorit dhe këngëve të eposit heroik shqiptar* (Zeqirja Neziri); *Komedia e parë e letërsisë arbëreshe dhe shqiptare "Kolloghrea karroqare"* (Klara Kodra); *Lëvrimi i romanzetto-ve si një zgjedhje e ndërgjegjshme e Francesco Antonio Santori-t për të komunikuar me lexuesin* (Edmond Çali); *Rreth disa teksteve të liturgjisë së krishterë në krijimtarinë e F. A. Santorit* (Evalda Paci) dhe *Përrallëzat "e Santorit" përkthim/ krijimtari/ përshtatje-motive dhe burime* (Arian Leka).

U mbajtën po ashtu edhe kumtesa nga fusha e gjuhësisë: *Pjetër Bogdani në arbërishten e Santorit: një përpjekje për afrimin e dialekteve të shqipes* (Anila Omari); *Santori, bashkëthemelues i një arbërishteje për të gjithë* (Ardian Doka);

Mbi sintaksën dhe semantikën e fjalës 'për' në shqipen e shek. XV: rasti Santori (Anila Kananaj); *Alternimi i mbylltoreve të pazëshme/të zëshme në të njëjtën fjalë në veprën e Santorit* (Valbona Sinanaj) dhe *Mbi përdorimin e disa formave të pashtjelluara foljore (prë me gëzuarë, vjen me thënë) në veprën e F. A. Santorit* (Erzen Koperaj).

Ndërsa në fushat leksikologji, semantikë e kritikë u mbajtën kumtesat: *Leksiku dituror në veprën e Santorit (*Valter Memisha); *Rreth vendit dhe rolit të greqizmave në veprën e Santorit dhe në të folmet në letërsinë arbëreshe* (Dhori Q. Qirjazi); *Vështrim etnosemanik për përrallëzat e përpunuara nga Santori* (Artur Lamaj); *Ngjyrimet leksiko-semantike në satirën e Santorit* (Juliana Kume) dhe *Krijimtaria e F. A. Santorit (në poezi, dramë e prozë) në kritikën letrare shqiptare* (Edlira Gugu).

III. Romani "Bija e mallkuar" i arbëreshit Francesco Paolo (Antonio) Santori, me rreth 238 faqe, vjen për herë të parë në gjuhën shqipe në vitin 2021 si një dokument historik dhe letrar nga studiuesja dhe përkthyesja e talentuar profesoreshë Klara Kodra, në trajtën e një botimi kritik nën kujdesin e Oreste Parise-s, si edhe falë ndihmesës së çmuar të studentit Elvi Proko me banim në Romë, i cili përktheu shënimet plotësuese me karakter historik dhe antropologjik e që paraqisnin një vështirësi të veçantë për specifikën e tyre dhe për arkaizmin që i dallonte (siç shprehet edhe vetë profesoreshë K. Kodra në faqen 238), botuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe realizuar nga ShB "Onufri". Në këtë mënyrë u realizua edhe dëshira e autorit për të komunikuar me sivëllezërit e vet të origjinës dhe për të patur një publik sa më të gjerë.

Studiuesja Klara Kodra, në dritën e objektivitetit shkencor dhe e bindur se ky autor meriton një rivlerësim, për të mos mbetur më "në limbin e shkrimtarëve minorë", në hijen e bashkëkohësve të mëdhenj si De Rada, Dara, Serembeja dhe Skiroi, ka hartuar në vitin 2020 monografinë "*Santori poet dhe dramaturg"* me 268 faqe, që na përforcon, zbulon e sjell të dhëna të reja mbi krijimtarinë e njërit prej autorëve më fatkeq sa i takon botimit dhe komunikimit me publikun, botuar nga Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët dhe Akademia e Studimeve Albanologjike, realizuar nga ShB "Onufri". Ndërkaq, studiuesi Oreste Parise është duke përgatitur për botim përkthimin në italisht të kësaj monografie të titulluar "*Santori–poeta e drammaturgo"*.

Në përfundim*:* Studiuesja Klara Kodra i ka kushtuar një kapitull të veçantë neologjizmave të Santorit, të titulluar "Santori si fjalëkrijues" në faqet 243-252 të monografisë "Santori poet dhe dramaturg" (QSPA, 2020), duke thelluar e zgjeruar ato çka u trajtuan më sipër, dhe duke arritur në konkluzionin se Santorit i takon merita si fjalëkrijues për fantazinë dhe shijen e tij, fjalë të cilat i kanë dhënë gjuhës poetike të këtij autori një shije të veçantë dhe të freskët, me anë të zëvendësimit me sukses të italianizmave dhe sinonimeve nga arbërishtja më pak shprehëse.

Përsa i përket veprimtarisë së dendur botuese të viteve të fundit të studiuesve arbëreshë dhe shqiptarë, theksojmë se ata kanë sjellë në dritë disa botime kritike sipas kritereve rigorozisht shkencore të filologjisë tekstuale (të cilat do të trajtohen në një tjetër studim). Këto prurje i kanë zgjeruar njohuritë tona për arbëreshin Santori dhe shtrojnë nevojën e ripërfshirjes dhe të rivlerësimit të tyre në suazën e letërsisë arbëreshe dhe asaj mbarëshqiptare.

(Vijon nga faqja 17)

here i ikte këmba shtrembër. Qe tragjike e qesharake njëkohësisht. Ishte bërë për të t'u dhimbsur. Brënda atyre rrobave Nedusha rrinte e habitur, e heshtur si e zënë rob, me sytë të zgurdulluar e të hapur jashtë mase. Dhe ashtu e nisën dhe shkoi në Itali.

Kur u kthye qe akoma më hukubet dhe e shëmtuar. Kushërirat e Italisë e kishin modeluar sipas mënyrës italiane. Qe bërë krejt përrallë. Zyrtarët e morën Nedushën e mjerë dhe e shëtitën ndërmarrje më ndërmarrje. Ajo mbante fjalime e recitonte kudo që vente se; " atje në Itali njerëzit s'kishin ç'të hanin, s'kishin me se të visheshin dhe jetonin nën ura". Pastaj se nga iku Nedusha, s'u pa më, nuk u mor vesht se nga shkoi dhe si e mbylli jetën. Eh Nedusha, një nga përsonazhet më të frikshëm dhe më të habitshëm të fëmijërisë sime, që edhe doja fort për marritë e saj prej plake.

Dhe tashti, bilbilonte dhe kërkonte të bënte dashni me ndonjërin prej attyre fakirash të rrënuar.

Pak më tutje dallova me zor, se qe disi në terr, (duke mbllaqitur e shqepur mish pulëze, ulur mbi një rrogozë të brejtur nga minjtë), njeriun e kryqëzimit, që kishte të veshur po atë xhaketën e dikurshme të policit, (ku dukeshin akoma shenjat e shplara të gradave të rëna dhe spaletave të vjetra). Më kujtohej qysh kur, që kot së koti bënte sikur drejtonte në mes të pazarit, me një tabelë allosoj, trafikun e atyre pak makinave që iknin rrugës, gati një trafik imagjinar.

Neja me Qeren erdhën duke hedhur valle. Neja i binte dajres së shpuar dhe Qerja hidhte për bukuri valle, këmbëzbathur, mes pluhurit, në breg të Drinit. Kur befas, në mes të valles, ia shkrepte të qarit. Thoshte se pati mbetur jetime, pa babë e pa nënë. Kishte kohë që i pati kaluar të shtatëdhjetat.

Akoma pa mbaruar vallja e Qeres, përrreth nëpër terr shugulluan këmborët. Nata u mbush me tringëllimat e tyre. E mbaja mend. Ishte Kurti i dhive, me tufën e tij, që edhe dikur i binte mes përmes qytetit, me dyqind këmborë. Ecte dhe vajtonte këngën e trishtuar, të një çobani që e pati zënë dëbora e madhe në mal dhe qe kthyer në korb. Solli qumësh dhe lëkura.

Kurti siç dukej qe i fundit që do mbërrinte, se e pashë që po afrohej mëngjesi.

Unë aty në prag të dritës, i shtrirë dhe mbështetur në brryl, po mblidhja e shënoja ç'të mundja nga kjo natë. Shkruaja shpejt me simbole, shkurtica, që nuk doja të humbja asgjë. Pata shënuar se "Të gjithë ishin të fandaksur, të luajtur mendsh, interesantë dhe artistikë në marritë e tyre, të lafitur dhe bërë jerm nga halle dhe ndodhi kushedi se çfarë. Të lezetshëm herë herë, dhe të bezdisshëm herë të tjera, të mallkuar dhe të bekuar njëkohësisht, që megjithëse ishin ashtu siç ishin, ndjeheshin mirë në fantazinë dhe realitetit të tyre. Patjetër që në kokat e tyre ata mendonin se qenë tjerë njerëz nga ajo çfarë ishin vërtetë. Njëri spikër radioje, tjetri polic trafiku, madje dhe ai tjetri që qe mbret i Arabisë."

Akoma pa dalë drita, u dëgjua nga larg një sirenë, që herë dukej si e zjarrfikses, herë e alarmit ajror, herë si e policisë, dhe s'merrej dot vesh. Të gjithë u turrën me vrap, fikën zjarret, mblodhën rraqet dhe çaklat, dhe se nga u zhdukën në çast.

Sirena u afrua. Ishte ambulanca. Dy vetë zbritën prej saj dhe, duke mu afruar disi me frikë, mbërritën te unë dhe më pyetën për emrin.

-Po, u thashë.

-Jemi të psikiatrisë. Duhet të vini me ne. Keni nevojë të kuroheni dhe të pushoni ca kohë.

Libri me reportazhe "Udhëtim në Europën Lindore" i G. G. Márquez

Gërshetime imagjinare në "largësitë" e epokave dhe të zhanrit

Nga Enver S. Morina

Libri "***Udhëtim në Europën Lindore***" (përktheu nga origjinali: Edlira Hoxholli, Onufri, Tiranë, 2016) i Gabriel García Márquez ka njëmbëdhjetë reportazhe, në strukturë kapituj leximi kronologjik a udhëtimi nga Gjermania Perëndimore përkatësisht Frankfurti, në Gjermaninë Lindore (në Berlinin), në Çekosllovaki (në Pragë), në Poloni (në Varshavë), në BRSS (në Moskë) dhe në Hungari (në Budapest).

Akti i epilogut hyrës (Arratisja" nga Perëndimi)

Teoritë moderne letrare dhe tekstet klasike janë paradigmë dekonstruksioni që mund të rishfletohen në ditët e sotme, për ta njohur një periudhë të ndritshme të "provës" dhe përvojës edhe të një shkrimtari, siç është njëri nga përfaqësuesit e realizmit magjik në letërsi Gabriel García Márquez. Autori i monografisë "***Gabriel Garcia Marquez***" Dagmar Ploetz kapitullin e periudhës së fundviteve 50-ta të udhëtimeve të shkrimtarit e quan "*Shqetësime socialiste*". Nga "***Gjethurinat***" (1955) tek "***Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë***" (1959) Márquez krijon atë Mesin e Artë të zhanrit, siç citon studiuesi e përkthyesi Shpëtim Doda në parathënien e "***Kallëzimi i një anijehumburi***": "*Problemi im i kryehershëm si gazetar – shpjegon shkrimtari në një letër drejtuar Camilo González Díaz-it, një lexues i tij, teksa flet pikërisht për këtë libër – ishte krejt i njëjtë me atë të shkrimtarit: më lipsej të zbuloja faqëza se cili nga zhanret më tërhiqte më tepër dhe arrita në* përfundimin se ishte reportazhi, i cili duke*j më i natyrshmi dhe më i dobishmi domen i gazetarisë. Një reportazh jo vetëm që mund të arrijë të barazohet me jetën, porse mund edhe ta kapërcejë kryekëput atë. Mund të jetë fare mirë një tregim apo një roman, me të vetmin ndryshim – se tregimi dhe romani janë krejtësisht të hapura ndaj përfytyrimit, ndërkohë që reportazhi lipset të mbartë të vërtetën deri në pikën e tij përmbyllëse.*"

Siç edhe ndodhi me veprën "testament" për të mos u botuar në të gjallë por me një "OK"-ej filtrimi përfundimtar "***Shihemi në gusht***", janë dy vepra të mëhershme të Márquez-it që kanë pasur një histori gërshetimi në diakroni botimi odisejade interesante. Është fjala për reportazhet e shkruara gjatë a pas udhëtimit të autorit në Evropën Lindore dhe reportazhit rrëfimtar me autorësi "të diskutuar" të veprës në prozë "***Kallëzimi*** i një ***anijehumburi***". Në prologun e botimit shqip të veprës "***Kallëzimi...***" përkthyesi Shpëtim Doda shkruan: "Çdo vepër letrare mbart në vetvete, madje në çdo faqe, në çdo paragraf, në çdo rresht, në çdo fjali, në çdo fjalë apo shenjë pikësimi, identitetin e shkrimtarit dhe të gjuhës së tij të shkrirë *përnjësueshëm* në një *mishtim* të vetëm mistik, që të kujton padyshim metaforën e famshme të zanafillës biblike."

Derisa vepra "***Kallëzimi...***" është botuar në një revistë për çka më pas revista do të mbyllet, si libër do të botohet në vitin 1970, libri me reportazhe **"*Udhëtim në Europën Lindore*"** pas botimit nëpër revista të kohës do të botohet në vitin 1978. Të njëmbëdhjetë reportazhet: *"Perdja e hekurt" është një tra i lyer me të kuqe dhe të bardha, Berlini është një çmenduri, Të shpronësuarit mblidhen për të treguar vuajtjet e tyre..., Për një çeke, çorapët e najlonit janë xhevahire, Në Pragë njerëzit reagojnë njëlloj si në çdo vend kapitalist, Me sytë hapur mbi Poloninë që vlon, BRSS: 22.400.000 kilometra katrorë pa asnjë reklamë të vetme për Cola-Cola, Moska: Fshati më i madh i botës, Në Mauzoleun e Sheshit të Kuq Stalini fle pa e vrarë ndërgjegjja, Njeriu sovjetik po fillon të lodhet nga kontrastet dhe "Unë vizitova Hungarinë"* janë të shkruara me një gjuhë të gdhendur në përsosmëri, me një finesë përkushtimi që ngërthen një botë të tërë kulture, arti, mentaliteti, sjelljeje e dukurish nga "më të papritura" për një shkrimtar i veshur nën petkun e një gazetari.

Akti i prologut dalës ("vetëdija" e Lindjes)

Gjatë leximit të kapitullit të parë "*Perdja e hekurt" është një tra i lyer me të kuqe dhe të bardha*" mendja më shkonte se si futbollisti gjermano-perëndimor Franc Bekembauer ka mundur të përshkruaj në shekullin XXI udhëtimin e tij, hyrjen në Shqipëri në vitin 1971. Qysh atëherë futbollisti legjendar duhet të dezinfektonte domosdoshmërisht duart.

Detaji i hyrjes së udhëtarëve perëndimor në një restorant të Gjermanisë Lindore?! Heshtja e tyre për Zhaklinën më kthen të filmi "*Koncert në vitin 1936*". Vizita e dy artistëve në një kafehane të kohës sikur trondit të pranishmit konservator. Markez shkruan: "*Kurrë nuk do ta harroj hyrjen në atë restorant. U përplasa me një realitet për të cilin s'isha i përgatitur.*" (faqe 15) Edhe artistet shqiptare nuk do e harrojnë kurrë hyrjen dhe qëndrimin në një restorant me plot njerëz. Ekzotikja e Zhaklinës i heshti të pranishmit. "*Në mes të asaj heshtjeje, duke ndjerë në lëkurë qindra shikime tinëzare, ecëm drejt së vetmes tryezë të lirë, e cila është vendosur pranë një gramafoni të dalë boje dhe që punonte me gjysmë marke.*" (16) Është Dagmar Ploetz që tek kapitulli "*Shqetësime socialiste*" të citoj këto fragmente! Një tjetër analogji rastësie përputhshmërie.

Thellësia e një realiteti është magjik duke e vënë në mëdyshje shpjegimin. "*Ka çaste ndjeshmërie që nuk mund t'i rindërtosh e t'i shpjegosh.*" (17) Të kuptosh Berlinin e viteve 50-ta nga leximi i Márquez-it "*duke u vërtitur brenda tij pa e gjetur dot.*" (19) dhe të kuptosh Shqipërinë e sotme përmes periudhës së udhëtimit të Márquez në Evropën Lindore a nuk është një paradigmë e mrekullisë së realizmit magjik! Vetëm një shkrimtar siç është kolumbiani Márquez e bënë këtë përmes diskursit nëntekstor që rilexohet në të gjitha kohët. Në vitin 1960 Çe Gevara do ta vizitoj Tiranën. Është kjo një vizitë jo vetëm e papritur por që do të mbartë enigmat më diskrete që sipas kronikanëve të kohës dhe dëshmitarëve do mbetët "e mbyllur" përgjithnjë, si një vegim vetëtime që duhet të harrohet shpejtë nga forca goditëse me pamjen e trupit të pajetë të tij dhe imazheve të sotme të portretit të Tij me yllin çlirimtar rinor! Jemi në vitin 1957. Autori e thotë edhe këtë: "*Në territorin e Gjermanisë Perëndimore ka pesë radiostacione që asnjëherë s'kanë transmetuar asnjë fjalë në gjermanisht.*"

(21) Márquez nuk vë pikëçuditje. Diç e zakonshme pas dymbëdhjetë, trembëdhjetë vite pas përfundimit të luftës. Një përshkrim brilant, në thellësitë e njohjes së brendshme ekzistenciale dhe të pamjes. "*Tërë* mëngjesin u vumë në kërkim të *qytetit, duke u vërtitur brenda tij pa e gjetur dot.*" (19)

Leximi i një romani ekzistencialist futet në realitetin e një bordelloje që për autorin është si një "përzierje labirintike të *Komedisë Hyjnore* me Salvador Dalinë" (32) Gjatë leximit të këtij fragmenti vijnë vetvetiu imazhet nga filmi "*Përse bie kjo daulle*" (1969) prodhim i Kinostudios shqiptare si analogji, sipas Márquez-t në Berlin "*ekzistencializmi është pajisje që instalohet në verë për turistët*" (32) ndërsa në Shqipëri mund të instalohet gjatë një dasme dhe ndërtimit të një qyteti të ri ku asgjë nuk ndodh, por vetëm ëndërrohet.

Një krahasim tej zonës së ndërdijes metaforike dhe përafrisë në të cilën të dy personazhet e plotësojnë njëri-tjetrin. "*Mendova se e kisha parë edhe diku tjetër atë vend, po Franko* më kujtoi se në të vërtetë nuk e kisha parë: e kisha lexuar në ndonjë roman ekzistencialist."

Udhëtimi përshkruhet të shpeshtën e herëve me thirrje zymtësie të pashpresë: "*Të shkretët njerëz.*" (Zhaklina, 17), "Çfarë tmerri." (Franko, 33), "*Ndjeja keqardhje.*" (Márquez, 33)...

Reflektimi pasqyror në llumin ujor të gropës që për pasojë ka sundimin "e Lindjes" është një tjetër dogmatizëm i modernes prandaj reportazhet e Márquez-it kanë analogji magjike edhe në kohën e sotme. Autori në një fjali gërsheton pikëpamje. "*Arma ligjore do ishte greva. Po e drejta për grevë nuk ekziston, sepse regjimi është dogmatik: thotë se është absurde që kur proletariati ka pushtetin, proletarët të bëjnë grevë për të protestuar kundër vetes së tyre.*" (41) Diç e tillë po ndodh sot në epokën e oligarkëve modern, në vendet e tranzicionit të sistemeve dhe pushteteve të shpeshta. Greva në një institucion a ndërmarrje private do ishte vetëvrasje për punëtorin. Ndoshta, sepse aktiviteti i Sindikatës është i pafuqishëm në këto pushtete gjoja demokratike. Doktrina dhe realiteti i ndarjes së hekurt. "*Mendojnë se në Gjermaninë Lindore nuk ka socializëm. Nuk është diktaturë e proletariatit, po e një grupi komunistësh që është* përpjekur të *ndjekë pikë për pikë* përvojat sovjetike pa marrë *parasysh rrethanat e veçanta të vendit. Hitleri i eliminoi komunistët e mirë. Ata që mbijetuan, që i panë shpejt gabimet e qeverisë aktuale, u eliminuan nga grupi sundues. Rinia marksiste është e bindur se realiteti nuk i përgjigjet doktrinës, veçse ajo nuk i merr në sy rreziqet e ndreqjes.*" (40), shkruan Márquez në kapitullin kuptimplotë "*Të shpronësuarit mblidhen për të treguar vuajtjet e tyre...*" faqe 40.

Sofizmi i demokracisë së oligarkëve sundues në ndërtimin e një koncepti të lirisë në periudhën e pasluftës në Kosovë i ngjan në përpikëri shpjegimit të Márquez që i bënë "ngatërrimit burokratik" dhe regjimit dogmatik.

Ndarja e Gjermanisë, ndarja e Berlinit elaborat magjik i shkrimit të Márquez-it. Katër gjuhë në një çast: rusisht, gjermanisht, spanjisht dhe frëngjisht. (43)

Koha reale e përjetimit të një shkrimtari lëkundët në një diskurs semantik rrëfimtar për ta kuptuar udhëtimin dhe detajet e qëndrimit. Periudha, koha nga gjashtë vjet në dhjetë minuta (48), nga dy orë pritje kot (49), udhëtimi pesëmbëdhjetë orë, katër orë në kufi (49), formalitetet u bënë për pesë minuta (49). Po koha imagjinative e ndërtuar nga një gazetar në veprën e vet fiktive? Për shembull tek vepra "***Kallëzimi i një anijehumburi***". Këtu kemi të bëjmë me gërshetimin në vete të realizmit magjik si në zhanrin e reportazhit ashtu edhe të romanit.

Koncepti i kontrastit në vendet e Lindjes për Márquez-in është një origjinalitet tjetër në kërkim. Po kontrasti i një shqiptari të Kosovës me gjithë periudhën e Shqipërisë së viteve 1945-1990, bien ndesh fillimisht me ekranin televiziv të RTSH-së e pastaj njolla e gabimit në vizitat e para andej Drinit pas rënies së sistemit!

Patriotizmi i një familje në mbrojtje të ekonomisë së atdheut. "*Javë më vonë, gjatë rrugës së kthimit në Francë, takova në tren një familje çeke që shkonte atje për pushime. Një francez u tha një sekret: në Paris ka një vend ku monedha çeke këmbehet me një kurs tri herë më të lartë se ai zyrtar. Çeku nuk e pranoj ofertën.*

-Kjo dëmton ekonominë tonë, -tha." (52)

"*...Piu edhe një birrë tjetër. Pastaj, me zërin të zbutur nga dehja, i foli vajzës në vesh duke i propozuar që ta shoqëronte në hotel. Ajo qeshi dhe, duke shkërbyer ëmbëlsinë e Frankos, i pëshpëriti në vesh:*

-Hajde te tryeza tjetër dhe kërkoji leje tim shoqi." (55)

Edhe sot e kujtoj vitin 1988. Në përfundim të studimeve në Letërsi në Universitetin e



Prishtinës. Tek Rrethi i Spitalit, pranë një kiosku të gazetave ndaloj një vajzë për njohje. Pas disa minutave tashmë kur çdo gjë ishte e njohur, afrohet djali dhe kërkon nga unë që t'ia liroj motrën. Desh me lëshuan këmbët!

Hapat e kalimit të kufijve në Perëndim janë të shpejtë. Në Lindje edhe të ndryshimit. Derisa "*në Europën Perëndimore i dallon kufijtë nga ndryshimi i gjuhës nëpër tabela*" në "*perden e hekurt, kalimi i kufirit është ngjarje.*" (64)

Stili poetik i rrëfimit. Formulat e alkimistëve sipas Márquez janë "*poezi të shkencës*". Márquez-i interesohet edhe nuk harron të shkruaj për dy libra të kolumbianëve të përkthyera në çekisht. *Vorbulla*, i Hose Eustasio Riverës dhe *Katër vjet brenda vetes*, i Eduardo Zalamea Bordës.

Dikur intervistat paguheshin. Sot paguhen analistët llomotitës. Márquez flet për një të tillë. "*Ishte drejtor i një reviste arti. Më mori një intervistë mbi muzikën popullore kolumbiane dhe mbas disa ditësh gjeta në hotel një zarf me kartëvizitën të tij dhe me pagesën e intervistës: 200 zlloti.*" (80)

E tërë kapitulli a pjesa e udhëtimit nga Çopi (vendbanimi më perëndimor në Bashkimin Sovjetik) në Moskë (nëpër Ukrainë) përshkruhet më të dhëna dhe statistika, udhëtim i cili për një të huaj ka veçantitë e veta. Márquez më një gjuhë gazetarie dhe të thjeshtë për nga magjia e formimit përshkruan edhe anën letrare-stilistike. "*Me ngjyra aq realiste sa që s'kishin vërtetësi reale.*", dhe me një përshkrim imazhi e rrëfimi kinematografik: "*Është e admirueshme besnikëria me të cilën letërsia dhe kinematografia ruse e kanë rikrijuar këtë vizion fluturak të jetës që kalon te dritarja e një treni.*" (102)

Gjithashtu për autorin është bindëse dhe mahnitëse që "*qeveria sovjetike duhet të jetë krenare për disiplinën dhe besnikërinë e popullit të saj.*" (107)

Sa kam qeshur me vete në përgjigjen pyetëse të jetës së një njeriu në pesë apartamente. Brilante:

"*-A mund të ketë njeriu pesë apartamente në Moskë?*

-Natyrisht, -m'u përgjigjën.

-Vetëm se, si dreqin mund të jetojë njeriu në pesë apartamente njëherësh?" (120)

Monumentaliteti vëllimor dhe sasior në kontraste gërshetimesh mes fakteve dhe dokumentaritetit vërehet tek të dhënat shifrore kolosale në periudhën e mbajtjes së festivalit: 14.000 përkthyes, stadiumi prej 120.000 vendesh, 400 muzikantë, çdo shfaqje 6000 aktorë të ndryshëm, 60 vagonë treni për transportues dekori, të cilat në këto përmasa gjigante të një shfaqjeje janë të pabesueshme "për të huajt". Morfologjia e një sistemi në kryeqytet shprehet me besimin dhe përkushtimin se "*sovjetikët janë besnikë ndaj qeverisë së tyre.*" (118)

Ndikimi vjen nga një gazetë. "*Ata* (sovjetikët-vë. e.s.m.) *thjesht përsërisin argumentet e gazetës Pravda.*" (125) Nëse sipas autorit "*sovjetikët janë paksa histerikë*" ata gjithashtu njohin gjendjen e brendshme të tyre më një përkushtim të habitshëm komunikimi: "*...karakteristikë e popullit sovjetik: informacioni politik.*" (126)

Më tej vjen portreti i Stalinit në të gjitha dimensionet. Mosha e Stalinit është ngrirë në moshën e portreteve. "*... në përfytyrimin e popullit Stalini kishte moshën e portreteve.*" (128)

Márquez-i më tej flet për Hrushovin dhe angazhimin e tij politik, përshkruan portretin e Stalinit, origjinën dhe identitetin e tij politik, metronë, arkitekturën sovjetike, tradhtinë bashkëshortore. Një fragment që duhet veçuar është e dhëna për Stalinin dhe pikëpamjet e kritikëve të artit për estetikën. Të dhëna për kinematografinë, për puthjen e parë në filmin sovjetik. Márquez-i shkruan për romanet policore, letërsinë fantastike-shkencore, për Aleksej Tolstoin. Një pjesë i është kushtuar përpjekjes për të hyrë në Mauzole dhe përshkrimi i dy arkmortëve, te Leninit dhe Stalinit, në thellësi detajesh nga pamje të ndryshme.

Zhgënjimi?! Pasqyrimi dhe përshkrimi i disa situatave të "turmës", të jetës së popullit. Të punëtorëve në kooperativa (fjalën kooperativë nuk e ka përdorur në asnjë vend!). Kontrastet edhe në titull "*Njeriu sovjetik po fillon të lodhet nga kontrastet*", por edhe në faqe 146 ku thuhet që rinia po "*rebelohet kundër kontrasteve.*"

Takimi me djaloshin që studionte poezinë botërore për fëmijë. Márquez i flet për jetën e shkrimtarit Rafael Pombo derisa studenti recitonte "*me një rrjedhshmëri të admirueshme, një antologji të tërë poezie latinoamerikane për fëmijë.*" (147)

Të zhgënjyer e të frikësuar në Budapest. Autori i librit, misioni i të cilit nënkuptohet (gazetar gërshetuar me një mision në mes shkrimtarit dhe natyralistit të kulturës dhe artit), bënë udhëtimin e fundit i vetëm në Budapest, duke "shënuar" më pas të dhënat e përgjithshme të gjendjes së Budapestit në vitin e fundit (tetor 1956-gusht 1957), kur për këta dhjetë muaj "*Budapesti kishte qenë qytet i ndaluar*" (149), gërshetuar me detaje "të zbuluara" gjatë udhëtimit "të fshehtë" i vetëm në qytet.

Pas ngjarjeve të tetorit 1956 një nga 18 vëzhguesit e parë perëndimor që hynë në Hungari është edhe autori i veprës "***Udhëtimi në Europën Lindore***", gazetari e shkrimtari Gabriel García Márquez. Në fund autori thotë që askush nuk donte të fliste. Dhe përfundon librin më këto 3,4 fjali duke përshkruar pamjen e një tualeti, gjendjen e një kryeqyteti, psikozën e një populli. "*Askush nuk donte të fliste. Por kur njerëzit heshtin –nga frika ose nga paragjykimi, -duhet të hysh në tualet për të ditur çfarë mendojnë. Aty gjeta atë që kërkoja: mes vizatimesh pornografike, klasike në gjithë tualetet e botës, kishte mbishkrime ku shihej emri i Kadarit, në një protestë anonime, po tepër domethënëse. Këto mbishkrime përbëjnë një dëshmi të vyer për gjendjen në Hungari: "Kadar, vrasës i popullit", "Kadar, tradhtar", "Kadar, zagar i rusëve*". (158)

Akti i fundit përmbyllës (uni i udhëtarit nën petkun e shkrimtarit)

"Udhëtimi" nuk ndërpritet as në shekullin XXI. Një pjesë e Europës Lindore është në konflikt, luftë të cilën shteti më i madh i kësaj hapësire planetare, Rusia, e ka nisur që më shpërbërjen e BRSS-së. Në paqe ka politikë. Në liri mund të këtë edhe intriga por dikush e vuan! Márquez na fton në udhëtimin e Tij magjik nëpër realitetin nostalgjik kur ftohtësia e Lindjes preket nga turistët e jashtëzakonshëm. Këtë herë nga një kronikan i cili hyri "nën aureolën e zhvillimit të Nobelit" për të ribotuar në një vëllim reportazhet epokale që me "heshtjen" e personazheve nuk ka një sqarim Post Scriptum se disa situata mund t'i ngjanë një të ardhme të afërt a një çasti të përsëritur fshehtas. Pasardhësit e kanë tabanin e një rileximi nga autori i cili përjetoj rrëfimin e të mbijetuarit nga një anijehumbure, pas "***Gjethurinat***" e para "***Kolonelit s'ka kush t'i shkruajë***".

Në epokën e sotme mediatike të komunikimit, tej hijes dhe imazhit të çastit sublim, citimet e shpeshta sikur e ç'thurin censurën e domosdoshme, për ta ngrirë në mesazhet e pafundme. Akti i fundit është i paprekshëm. Si lexues "i vonuar" poetika e rrëfimit e un-it të shkrimtarit skalitet në këto thënie sentenca domethënëse e shenjëzim përmbajtësor për një sprovë "vetëdije letrare" tashmë të paralajmëruar në të gjitha nënshtresat e poetikës moderne.

"Akumulimi i diskriminimeve" term ky i huazuar nga "*Fjalori i kritikës moderne*", njësia "*Kultura*", ka një rishfaqje për një debat mes përshkrimit dhe vlerësimit. Derisa në epokën e ftohtë kemi izolim te alternativave, sot konfuzioni mes zhanreve tradicionale dhe formave më të arrira të komunikimit ka përparim drastik. Marramendës deri në çmenduri. Imazhe deri në vetëvrasje lehtësisht të përjetuara. Arratisja nga e vërteta është gjëja më e shëmtuar për një lexues. Hyrja në realitetin e një shoqëria të diktuar nga oligarkët e pangopshëm është gjëja më e zakonshme në çerekshekullin e parë të lirisë sonë.

Jemi në pritje të "vëllimit të dytë në shqip" te "***Jeto për ta treguar***". Márquez vëllimin e parë të kujtimeve "e përfundon" me përballjen me të mbijetuarin e anijehumburës Luis Alejandro Velasco për "të filluar" me fatin e reportazheve nga "***Udhëtim në Europën Lindore***". Triptik i zbehtë për triptikun madhështor të jetës për ta treguar te Márquez-it.

Prishtinë, shtator 2024

Librat e jetës sime: Autorja japoneze mbi humorin e Kurt Vonnegut, gëzimet e James Joyce dhe përkthimin e Beatrix Potter

MEKO KAWAKAMI:

Franz Kafka është autori që më ngushëllon

Kujtimi im i parë i leximit

Kur isha e vogël, kishim shumë pak libra në shtëpi, kështu që i prisja me padurim librat shkollorë japonezë që na jepnin çdo semestër. E lexoja të gjithë librin brenda ditës. Librat shkollorë mund të duken të mërzitshëm, por më ofuran një rrugë drejt poezisë bashkëkohore, hajkuve dhe poezive tanka.

Libri i parapëlqyer teksa rritesha

"Demian" nga Hermann Hesse. Nga të gjithë protagonistët, Sinclair më tërhiqte prej natyrës së tij introspektive dhe mungesës së vetëbesimit.

Libri që më ndryshoi në adoleshencë

Pata fat të lexoja Kurt Vonnegut si adoleshente. Michael Ende ka shkruar për mënyrën se si humori nuk është një shprehje e lojës por një qëndrim i mënyrës se si një person përballet me vështirësitë dhe pengesat që ndodhin në jetë. Ky kuptim i humorit lidhet me shpirtin e Osakas, qytetit ku jam lindur dhe rritur. Më habiti që mund ta kuptoja thelbin e kulturës sime përmes veprës së Vonnegut, një shkrimtari amerikan. Përmes imagjinatës së tij dhe përvojave epike, më mësoi për shpresën në mes të dëshpërimit.

Shkrimtari që më ndryshoi mënyrën e të menduarit

James Joyce. Ai e transformoi tërësisht mënyrën si mendoja për poezinë – të gjithë konceptin e saj, nga forma te përmbajtja.

Libri që më bëri të doja të isha shkrimtare

Nuk më vjen ndërmend ndonjë, sepse nuk pata kurrë si qëllim të isha shkrimtare. Thjesht dhashë gjithë sa munda në çdo punë dhe kjo më solli këtu ku jam tani.

Libri që i jam rikthyer

"Gravity and Grace" nga Simone Weil. Si jobesimtare, mund të lexoja dhe ta kuptoja veprën e Weil-it, por asnjëherë nuk u ndjeva sikur mund ta prekja thelbin e saj. Tani që jam më e madhe dhe kam parë kufijtë njerëzorë në mënyra të ndryshme, "Zoti" të cilit i referohet Weil ka marrë një kuptim tjetër për mua.

Libri që rilexoj

"Growing Up" (Takekurabe) nga Ichiyō Higuchi, e cila ishte një prej shkrimtareve të para profesioniste në Japoninë moderne. Ajo shfaq në një prozë të mahnitshme, pafajësinë briliante të fëmijëve dhe zakonet e pjesës së vjetër të Tokios, nga 130 vjet përpara. Përveçse është këndaqësi për t'u lexuar, historia më kujton se si pabarazia ekonomike dhe padrejtësia sistemike e kohës së saj mbeten të pandryshuara edhe sot. Një tjetër është "Zürau Aphorisms" nga Franz Kafka.

Një libër që nuk do mund ta lexoja më kurrë

Ka shumë libra që më duken shumë *macho* për t'u lexuar tani. Histori për "trashëgimi" apo "pasardhës", që shfaqin konfliktin mes bijve dhe baballarëve të tyre shtypës.

Një libër që e zbulova vonë në jetë

"A Manual for Cleaning Women" nga Lucia Berlin. Ky vëllim i shkurtër me tregime u përkthye në japonisht para pak vitesh. U mrekullova nga aftësia e saj për të shkruar për dëshpërimet dhe zhgënjimet e jetës.

Libri që po lexoj tani

"The Tale of Peter Rabbit and Other Stories" nga Beatrix Potter. Tani jam duke përkthyer të njëzetetre rrëfenjat në japonisht, kështu që i kam rilexuar me kujdes për dy vitet e fundit. Vazhdimisht më bën përshtypje struktura e tyre e përsosur – gjithashtu edhe ilustrimet janë të mrekullueshme. Për shembull, kafshët që ushqehen mirë kanë qime të shndritshme, ndërsa ato më pak fatlume duken të yndyrshme dhe të shpërlara – qimet e tyre janë pikturuar ndryshe sipas klasës. Kam mësuar shumë nga jeta e Potter-it dhe vizioni i saj i mprehtë.

Libri që më kthen humorin

Kafka, sepse vepra e tij përmban të vërtetën se dëshpërimi nuk është diçka për t'u urryer e për t'u shmangur, as një fatkeqësi e papritur, por një gjendje normale për jetën njerëzore.

Marrë nga *The Guardian*

Poezia “Silvias” e Giacomo Leopardi-t

TË LEXOSH POEZINË SI NJË PARTITURË

Nga Natasha Poroçani

Qokëtimi[1] hermeneutik i identitetit parafrastik të poezisë “Silvias”, si orientim drejt qasjes gjuhësore të saj në shqip

Në realizimin e skrupujve tanë sa analizues aq edhe transkriptues drejt shqipes u ndoq platforma studimore mbështetur nga parimi i Wittgenstein-it,[2] sipas të cilit *ligjërimi është sfera dhe mekanizmi ku gjuha shfaqet me tërë përmasat reale-funksionale dhe me tërë vitalitetin e saj*:

-Duke e gjykuar ligjërimin si universin ku gjuha shfaq potencialin e saj të strukturave të thella e sipërfaqësore, u synua të analizohet gjuha e Leopardit si dukuri përtej funksionit të saj, *atë të aftësisë së zbulimit të botës*, sipas Heidegger.[3] Me synimin e realizimit të përkthimit të *Silvias*, sa më afër potencialit filozofik të botës së Leopardit iu qas të vërtetës së tij filozofike, duke analizuar studimet në gjuhën italiane (studimin më të plotë të poezisë *Silvias* e kanë realizuar studiuesit italianë), në të cilat u vëzhguan interpretimet filozofike, por njëkohësisht edhe qasjet muzikore, afëritë e metrikës dhe fonetikës së kësaj poezie me muzikën në përgjithësi dhe atë rekanatase në veçanti.

-U konsultuan manualët fonetikë dhe stilistikorë të gjuhës italiane (veçantërisht të orientuar nga nga studimi i Ladislao Galdit, por jo vetëm), duke verifikuar jo vetëm intensitetet e përdorimit të fonemave në gjuhën italiane, por edhe valencat e tyre brenda poezisë. E gjithë kjo metodologji kërkimore ka ndihmuar dhe drejtuar për të realizuar përkthimin e poezisë *Silvias*, i cili paraqitet si përfundim i këtij punimi studimor.

-Kemi qokëtuar përkthimet në shqip të pozisë *Silvias*, të cilat kanë vlera të mëdha për letërsinë e huaj në gjuhën shqipe; janë paraqitur disa pika takimi me to dhe së fundmi, janë sjellë në variantin tonë.

Qokëtimi ka ndjekur këtë procede:

a. lëvrimi i etapave njohëse,

b. formulimi dhe respektimi kanonik i rregullave,

c. aplikimi i njohurive të përfituara.

Rrafshet arsyetuese drejt një analize hermenautike

1.1 Përkthimi në shqip i Silvias, *përballet me sfidën e interpretimit në rrafshin e të vërtetdukshmes apo verosimilianzës (verosimiglianza)*[4] (për t`i qëndruar besnik terminologjisë italiane). Ardhur si një nga nocionet kapitale të retorikës së Aristotelit, ajo është estetikë e lexuesit dhe jo e autorit, “*përkushtim ky ndaj një pakti të mundshëm të besueshmërisë i provuar përmes vërtetësisë, objektivitetit të shkrimit me nuanca autobiografike*”,[5] duke qenë se ky nocion lidhet me “*retorikën e provës, rezonimit dhe të silogjizmit aproskiumativ (entimemën)*”.[6] Kjo qasje replikon konformitetin e dukshëm me të vërtetën: është trilli i një imazhi femëror (ose dhe jo), që në raport me vetë imazhin e heroit lirik në pasiguritë e tij, ofron disa mundësi: rinia dhe humbja; ikja dhe natyra; vetmia dhe ngjyrat; jeta dhe vdekja; vdekja dhe jeta nga të cilat maksimalizohet raporti *jetë/vdekje*, por i përmbysuar si imazh falë lakmisë ndaj vdekjes që duket se poeti e provon në të vërtetën e besueshme të ekzistencës binare (heroi lirik dhe plotësia e tij nga imazhi eterik i Silvias), e rrëmon më pas në fund të çdo strofe, për ta sjellë të plotë si receptim të të gjithë poezisë. Kjo filozofi, në fakt është mbizotëruese në gjithë sa shkruan Leopardi, por ne gjykojmë se edhe përtej *Silvias*, vjen si një marrëveshje e fshehtë e dy tipeve të lexuesit (lexuesit interpretues dhe bashkëpunëtor) me tekstet e poetit, për aq kohë sa këtë raport që anon drejt imazhit të përmbysur jetë/vdekje lexuesi (i të dyja tipologjive) e rezonon në të gjitha veprat e poetit.

Mbi një receptim të tillë kemi orientuar lexuesin në interpretimet mes shenjave dhe kuptimeve, në lidhjen e ngushtë të imazheve konform situatave thëniesore, duke qartësuar që semantika jep të mundshmen, ndërsa pragmatika të besueshmen. Veçantitë semantike të korpusit leksikor, studiuar në situata pragmatike e ndihmojnë të vetëdukshmen (të vërtetën) të bëhet në fillim e mundshme dhe më pas e besueshme, duke i hapur rrugë një pakti, të cilin Gashi e emërton “*autobiografik*”.[7]

1.2. Paktet, raportet, marrëdhëniet semantiko-pragmatike tekstin e derivojnë në një tjetër rrafsh arsyetues, ku gjuha është protagonist veprues, duke qëmtuar në punimin tonë një tjetër rrafsh metodik të hermeneutikës: r*rafshi i ndërfutjes në ndjesitë romantike të leximit*, i orientuar domosdoshmërisht nga teksti *Silvias*-tekst, si simbol i romantizmit. Që të siguronim rolin e dorëdhënësit në komunikimin e ndjesive që teksti *Silvias* përcjell te lexuesi, na duhej të receptonim ndjenjat, shpirtin, emocionet si korpus romantik ndjesor të heroit lirik, në të cilin e vetmja gjë e paprekshme ishte protagonisti i romantizmit, heroi lirik me kultet e tij romantike, të cilat luhaten mes kërkimit të së vërtetës dhe paqartësisë së realitetit trishtues. Me autoritetin e receptuesit, i cili e bën tekstin të ekzistojë në formën sesi ai vetë e percepton atë, u ndërkallëm në tjetër spektër komunikimi, të emërtuar nga Hans Robert Jauss[8] dhe të referuar nga Shevrel (Chevrel) *horizont i pritje*s,[9] sipas të cilit, horizonti i pritjes ndërhyn në nivel të dyfishtë: i pari është niveli i tekstit (tekst i lexueshëm) dhe i dyti është niveli i lexuesit, tiparet që ai do të zbulojë.

1.3. Në horizontin e pritjes gjykuam që përputhshmëria e dy niveleve sugjeronte këmbëngulje arsyetuese *në analiza të rafshit stilistiko analitik të retorikës së tekstit*. Duke mbështetur idenë që përcjell Marteta[10] se *është pikërisht poezia gjinia me të cilën eksperimentohet më shumë në fillim të Nënëtëqindës në Europë*, shqipja është

elitare në lartësinë e saj për të mbajtur revolucione metrike, siç kishte pohuar edhe Ernest Koliqi, që më 1942:

“Mjafton më lexue përkëthimet në shqipe nga klasikët mâ të mëdhaj të botës për të kuptue fuqín shprehse dalluese veshguese muzikore në të cilën u naltësue në pesëdhetë vjet gjuha e jonë. Në poezín e soçme dridhet nji sensibilitet i ri dhe prirja e përgjithëshme shënon nji zavendësim të frymzimit figurativ me atë muzikuer: dishmi e qartë se poetënt t’anë shtinë tashma në dorë të gjitha mjetet e artit për të ndjekun rrymat letrare ma fluturuese europjane e botnore.”[11]

Me këtë siguri, sprovuam tekstin burimor drejt hapësirës shenjuese të shqipes, nën vështirësinë e paktit mes dy bashkësive retorike të ndryshme, të cilat nëse në perceptim mund të përkojnë, në përputhjen e sferave konjitive krijojnë problematika që lidhen më së shumti me tërësinë e kritereve receptuese të dy tipologjive të lexuesit (lexuesi ideal dhe lexuesi si marrës i tekstit). Ndaj dhe sistemin aq të ndërlikuar stilistikor e retorik të Leopardit, më së pari e zbërthyem në lidhjen e ngushtë të shenjës me figurën, në marrëdhënie semantiko - pragmatike, udhëtime arsyetuese ku prioritare ishin sa imazhet, aq dhe synimi për të qartësuar thelbin kërkimor të poetit.

Të nisur nga shqyrtimi i termave romantikë dhe bazës së metrikës e fonologjisë leopardiane (dhe në këtë hulli edhe asaj italiane), përkthimi mori një tjetër përmasë kur teksti *Silvias* na u shpalos si një partiturë, në harmoninë mes tingujve dhe ndjesive romantike, deri te harkimi i tingujve në përputhje me gjendjen shpirtërore të heroit lirik, për të përfunduar te ballafaqimi i gjetjes së Leopardit me triumfin e strukturës muzikore të tekstit

1.4. Misioni i realizimit interpretativ dhe hulumtues, në rolin e “*lexuesit ideal*”,[12] mundëson marrëdhënien e ngushtë receptive-perceptive, sidomos nëse qasja ndaj tekstit në fjalë ka synime që bashkërendojnë *studimin* me *përkthimin*. Tanimë kuptimi i termit *përkthim* ka fituar aspekte të reja, duke u bërë një unitet gjithnjë e më kompleks. “*Një shtëpi me shumë dhoma*”[13] e quan Hatim, duke na pohuar idenë se nuk mund të ketë vetëm një teori gjithëpërfshirëse përkthimi. Kjo na jep komoditetin të krijojmë qasje ndaj përkthimit nëpërmjet metodave të ndryshme kërkimore, formante, të cilat realizojnë perspektiva vizionare të larmishme. Trajtesat e ndryshme të teorisë dhe praktikës përkthimore, në lidhje me qëllimin kryesor të përkthyesit, në shumicën e rasteve, bashkohen në faktin se “*përkthimi duhet të krijojë te lexuesit e tekstit të përkthyer efekt sa më të afërt me atë të lexuesve të tekstit në origjinal*”.[14] Ky parim, i emërtuar “*parimi i kundërveprimit/ efektit të ngjashëm/barasvlershëm/ ose parimi i barasvlerës funksionale/dinamike*”,[15] krijon efekt të ngjashëm, të përafërt me atë burimor dhe përkon me aftësinë e përkthimit për të modifikuar, formësuar materialin burimor (tekstin origjinal) në njësi të reja, “*duke u barazuar sigurisht edhe me funksionin performues të gjuhës*”,[16] {siç argumentojnë gjatë Hermans dhe Timozko (Tymoczko)}, në të cilin, siç kemi nënvizuar më lart, vetë gjuha bëhet veprim.

Të lexosh një poezi si partiturë

Leopardin e njoha nëpërmjet *Silvias*[17].

Leximi i parë të çon drejtpërdrejt te pyetja: *Si t`ia bëj që ta kuptoj këtë poezi*? Sikurse edhe Marteta[18] e pohon, “*poezia këndohet, dhe këndohet me ritëm*”, ritëm, i cili mbështetet te *“gërshetimi i substantivave me adjektivat*”. Problematika kryesore e poezisë në fjalë identifikohet nga Umberto Eko (Eco), sipas të cilit Silvia *realizon dy rrafshe: rrafshin e të shprehurit (fjalët shpeshherë të vështira për t`u përkthyer) dhe rrafshin e përmbajtjes apo të fakteve të treguara. Në rrafsh përmbajtjesor mund të dallojmë ende dy komponentë, fabula dhe trama*[19]. Kjo do të thotë të pranosh se poezia që të vjen në duar është një kombinim perfekt tingujsh dhe mendimesh, nëpërmjet të cilëve ti herë lëkundesh e vallëzon në morinë e zanoreve që përplasen në zhurmën e *aliteracioneve*[20] e herë pengohesh e gati rrëzohesh në sintaksën e thyer të *enjambements-it*[21] leopardian, për ta ringjitur këtë frakturë në vargun pasardhës. Ky lloj kapërcimi mes një sintakse poetike jo fort të përdorur në vargjet shqipe dhe valëzimit me të cilin të pështjell poezia nëpërmjet *apostrofeve*[22], sfidon duke hedhur në letër dorashkën e bardhë të pamundësive të përshtatjes absolute në shqipen tonë, të cilat italishtja jo fort qumështore e Leopardit t`i sfidon si *anagramë*[23], *epifrazë*[24], *opozicion*[25] *(chiasmi), zeugma*[26].

---

[1] Këtë term e kemi huazuar nga Plangarica, *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar* (2017), i cili, ndërsa saktëson terminologjinë e përkthimit nga frëngjishtja, shkruan: Për të vijuar më tej, skaji *repère,* mendojmë se duhet përkthyer me *qokë*, ndërsa të ardhurat prej tij *repérer*, *repérage*, *repéré* përkatësisht me *qokëtoj, qokëtim* dhe *i qokëtuar*; përkthim i tillë nuk është bërë ende në shumë gjuhë të tjera. P.sh.: në anglisht, për mungesë të një fjale që do ta jepte barasvlershëm nocionin përkatës të gjuhësisë franceze, përdoret skaji *reper* i huazuar nga frëngjishtja. Është parapëlqyer skaji *qokë*, sepse i përgjigjet më mirë skajit gjegjës frëng *repère*, se që të dy vijnë nga fusha e marrjes, e vënies së diçkaje (qokë, popël, kunj, etj.) si skaj orientimi, *sepse fjala qokë me kuptimet dhe përdorimet e saj në gegërisht i përgjigjet më mirë jo vetëm nocionit të orientimit, saktësisë, urtësisë, maturisë,* por edhe shërben si temë më pak e zënë për të formuar çerdhe homogjene terminologjike fjalësh: *qokëtoj*, *qokëtim*, i *qokëtuar*, *qokëtues*, *i qokëtueshëm* etj.

[2] Ludwig Josef Johann Wittgenstein, Cituar nga: Emine Teichman, *Hapa në Universin e ligjërimit (Përmbledhje punimesh gjuhësore-pragmatike)*, Marin Barleti, Tiranë 2010, f. 7.

[3] Martin Heidegger, *Der Weg zur Sprache*, Vitrorio Klosterman, Frankfurt am Main, 1985, f. 151.

[4] Konformiteti i dukshëm me të vërtetën. Të qenit i besueshëm; duke pasur pamjen e së vërtetës: vërtetësia e një përralle, e një shpikjeje fantastike, e një gënjeshtre; ngjarje të trillimit shkencor të rrëfyera (ose të përfaqësuara në një film).

[5] Agron Gashi, *Proza autobiografike (Poetika dhe modele),* Prishtinë, Parnas 2017, f. 58.

[6] Roland Barthes, *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë 2008, f. 2.

[7] Agron Gashi, vep. cit, f. 61.

[8] Hans Robert Jauss; Elizabeth Benzinger (1970). *“Literary History as a Challenge to Literary Theory”. New Literary History*. 2 (1): 7–37. Viewed 15 March 2013.

[9] Yves Chevrel, *Letërsia e krahasuar*, Naimi, Tiranë 2016, f. 69.

[10] Rafaela Marteta, *Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021, f. 83.

[11] Ernest Koliqi, *Një sy panormik mbi kulturën shqiptare*, 2003, (6) 507, Cit nga Rafaela Marteta, *Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021, f. 83.

[12] Për më tepër shih: Umberto Eco, *Lector in fabula*, Tascabili Bompiani, Milano 2019, f. 50-67.

[13] Basil Hatim, *Teachhing and researching translation* Harlow: Longma, 2001. Xvi+254pp. ISBN 0-582-32899 (Applied linguistics in action series).

[14] Emile Victor Rieu, *Translation in Cassell`S Encyclopeadia of Literatture*, Vol 1, Casell, London 1953 (cituar nga Viktor Ristani, *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve `90*, Geer 2010, f. 45-48).

[15] Eugene Albert Nida & Charles Rusell Taber, *Theory and practice of Translanting*, Brill, Leiden 1969.

[16] https://core.ac.uk/download/pdf/59326015.pdf https://www.researchgate.net/publication/266017340_Translation_ideology_and_creativity

[17] “A Silvia” është poezi e vitit 1828 dhe është ndër poezitë e para pas “ringjalljes” në jetën personale dhe në krijimtarinë artistike të Leopardit. Me “ringjalje” i referohemi fundit të vitit 1827 deri në qershor 1828, ku gjatë qëndrimit në Pisa, Leopardi përjetoi një ringjallje shpirtërore dhe letrare pas një periudhe heshtjeje.

[18] Rafaela Marteta, vep. cit., f. 97.

[19] Umberto Eco, *Sulla letteratura*, Bompiani, Milano 2002, f. 334.

[20] Më gjerë është sqaruar në vijim, me shembujt përkatës.

[21] Është një figurë retorike që gjendet vetëm në poezi dhe konsiston në thyerjen, në fund të rreshtit të sintaksës së fjalisë në mënyrë të tillë që mendimi të vazhdojë në nisjen e rreshtit tjetër: “sonavan le quiete / stanze” (vv. 7-8); “peria fra poco / la speranza mia dolce” (vv. 49-50); “*negaro i fati / la giovanezza” (vv. 52-53); “questi / i diletti” (vv. 56-57); “la fredda morte ed una tomba ignuda / mostravi” (vv*. 62-63).

[22] V. 1: “*Silvia”; v. 29: “o Silvia mia”; v. 36: “o natura, o natura”; v. 43: “o tenerella”; vv. 54-55: “cara compagna dell’età mia nova, mia lacrimata speme”; v. 61: “tu misera*”.

[23] “*Silvia…salivi*” (vv. 1 e 6).

[24] “*io gli studi leggiadri / talor lasciando e le sudate carte” (vv. 15-16).*

[25] *“io gli studi leggiadri… e le sudate carte” (vv. 15-16); “fredda morte, tomba ignuda (v. 62)”.*

[26] Një lloj elipse që konsiston në referimin e disa plotësimeve të një kallëzuesi i cili në fakt do t’i përshtatej vetëm njërës prej tyre: “*porgea gli orecchi al suon della tua voce / e alla man veloce*” (vv. 20-21).

Thirrje e hapur për luftë.

Nga leximi i parë e deri ku Leopardi do të flasë shqip, duhej ndërtuar strategjia, e cila para së gjithash do të çonte në një fshat të bukur, plot gjelbërim e kalldrëm të Ankonës (Ancona), Rekanatin (Recanati) e Leopardit. Rekanati mund të ishte si të gjithë gjysmëqytezat e gjysmëfshatrat e Italisë, sikur në të, çdo adhurues të Leopardit të mos e tërhiqte dritarja e katit të dytë të vilës, nga ku Xhakomo Leopardi (Giacomo Leopardi) kishte dëgjuar për herë të parë i nervozuar zërin e Terezës[27] (Teresa) dhe zhurmën e avëlmendit, instrumentit që endte pëlhurë, të cilin falë prejardhjes, çdo adhurues shqiptar i poetit e njeh shumë më mirë e më bukur se bashkudhëtarët e panjohur të tij në rrugëtimin mes dhomave të vilës luksoze leopardiane. Kjo hyrje në fakt, ishte nevoja për të qenë besnik me Ekon (Eco) kur i tërheq veshin çdo individi që tenton të thotë gati të njëtën gjë: "*nëse historitë sajohen (apo mund të sajohen)..., në ç`nivel përkthyesi është i autorizuar të ndryshojë një histori sipërfaqësore për të ruajtur një histori të thellë*?"[28] E më keq akoma, në duar nuk ke një histori, por një ndjesi. E mbushur me kaq shumë tinguj, së pari duhet pohuar se poezia "*Silvas*" është vetëm një nga instrumentet e Leopardit, me anë të të cilave ai na sjell mekanizmin e përdorimit të fjalëve si tinguj: që do të thotë të lexosh një këngë nëpërmjet fjalëve. Për herë të parë këtë lidhje harmonike mes tingullit dhe fjalës te Leopardi e vëren Klemente Rebora (Clemente Rebora) në esenë e tij: "*Për një Leopard të panjohur*" (*Per un Leopardi mal noto)*[29], i cili e interpretoi si një çelës filozofik për të shpjeguar idetë e Leopardit mbi muzikën, në veçanti, lidhjen mes filozofisë dhe poezisë, meditimit dhe këngës. Dy ekstremet filozofike, *relativen dhe absoluten*, Rebora i sheh të mishëruar në muzikën e vargjeve të Leopardit, si e vetmja "*formë artistike që është në gjendje të kapërcejë hendekun midis të veçantës dhe universales, midis trupit dhe mendimit dhe të shërojë divorcin midis fjalëve dhe gjërave.*"[30]

Nisur nga këto referenca që drejtojnë mënyrën e leximit të poezisë sikur fjalët të ishin nota, do të provojmë të lidhim çelësin filozofik të Reborës me çelësin e solit në një partiturë. Fillimisht, bëjmë një kthim për nga e shkuara e Leopardit, burimit nga ku erdhi muzika e vargjeve të tij. Stefania Notiçi (Stefania Notici)[31] na tregon se që i vogël Leopardi ra në kontakt me trashëgiminë e muzikës popullore të Rekanatit. Në Xibaldone (Zibaldone) ai përmend këngë, për të cilat shprehet se janë "*këngë popullore që janë kënduar në kohën time në Rekanati.*"[32] Dhe gjithmonë sipas Notiçi-it nuk është aspak e vështirë që në to të njohësh paraardhësin e të paktën dy figurave të pranishme në *Këngë* (Canti), ku padyshim njëra shfaqet edhe te "*pamjet e dashura dhe të ndrojtura*"[33] të Silvias. Gjatë përvojës në pranverën e Rekanatit, kuptohet menjëherë se muzika dhe trumbetimi i saj si lojë tingujsh në poezinë e Leopardit gjenerohet nga festat e provincës së vogël, të shpikura për raste aq të zakonshme e të parëndësishme për ne të tjerët. Kjo është

ndjesia ndërsa dëgjon muzikën tradicionale me vargjet e *Gjineshtrës,*[34] si prelud dhe himn për këtë lule fushe, të cilën rekanatasit e quanin pronë vetëm të buzëkodrave të tyre.[35] Këto festa, gjithmonë të pranishme në Rekanat janë frymëzimi i temës së festës, i gjithëgjendur te *Këngë*. Me këtë qasje kthehemi te çelësi filozofik i Reborës dhe çelësi i solit të muzikës. Sipas fjalorit, *çelësi* në muzikë është një shenjë që vihet në krye të pentagramit dhe që tregon notën, sipas së cilës caktohet shkalla e lartësisë për notat e tjera të pjesës muzikore[36]. Hulumtimi të lexojmë *Silvian* si një partiturë, në mënyrë muzikore duke nënvizuar së pari lojën e tingujve që krijojnë rrokjet dhe diftongjet në të. Metoda që do të përdorim në këtë lexim jo fort të zakontë, do t`i referohet sprovës së Bizutit (Bisuti), "*Poezia shpëton jetën*" (*La poezia salva la vita),*[37] përmes së cilës gjetëm mekanizmin e duhur në qasjen ndaj muzikës së vargjeve të Leopardit. Në të njëjtën kohë, duke patur konsiderimin e rrokjeve si nota, na duhet të përcaktojmë korpusin retorik që do të na qartësojë tipin e *muzikës* që përdor Leopardi. Për këtë arsye, i jemi referuar Ladislao Galdit (Ladislao Galdi)[38], në analizën stilistike ku ai ndërton hartën e figurave retorike dhe interpretimin e tyre përmes poezisë dhe narracionit, "Elemente të fonetikës stilistike" (*Elementi di fonetica stilistica*).

Për të përcaktuar tipin e muzikës së Leopardit duhet të hedhim një sy në variacionet tingullore që ai përdor. Duke lexuar *Silvian,* vërejmë se autori vendos në dispozicion të lexuesit një seri proçedesh tipike leopardiane, ndër të cilat dallojmë:

a-*zgjedhjen e tingujve*. Te *Silvias* vërehet prania e gjithkohshme e tingullit *v*, që i shoqëruar me zanore të ndryshme krijon efekte fonetike ekspresive: e gjendur brenda emrit *Silvi*a, gërma *v*, në shoqëri zanoresh dhe brenda rrokjeve *"vita" (v. 2), "fuggitivi" (v. 4), "salivi" (v. 6), "sedevi" (v. 11), "avevi" (v. 12), "solevi" (v. 13), "soavi" (v. 28), "perivi" (v. 42), "vedevi" (v. 42), "schivi" (v. 46), "festivi" (v. 47), "mostravi" (v. 639*) në dalje të shpeshta *vi-va*, krijon efektin e pranisë së emrit të *Silva*s dhe nëse e rigrupojmë atë brenda 63 vargjeve, përtej aliteracionit, rrokjet (*vi-va*) që veçuam japin ritmin e një dysheje që përsëritet. Ky efekt tingëllor është një nga qëllimet e poetit për të pajtuar realitetin (vdekjen) me imagjinatën (viva-e gjallë). Rrokjet që funksionojnë si nota përsëriten në mënyrë të variueshme duke krijuar rima (v2-v6; v12-v13; v42-v46), të cilat arrijnë të realizojnë ritme të jashtme me të njëjtën frekuencë të artikulimit të tingullit. Më tej akoma, përsëritja e rrokjeve të njëjta brenda fjalëve dhe vendosja e tyre në largësi pothuajse të njëjta siguron ritmin e brendshëm ku ruhet e njëjta frekuencë artikulimi.

b-Vokalet palatale. Ato kanë një tingëllim të qartë: zanoret më frekuente në italisht janë *e* (12.5%) *a* (11.47%), *i* (9,45%)[39]. Në tekst e ndeshim në 265 (18%) prononcime gërmën *e*, 136 (9.3%) gërmën *a*, 241 (16%) gërmën *i* në praninë e 1454 tingujve. Zanorja *a* për shkak të hapjes së saj maksimale përcjell ulje të zërit dhe qetësi: *Allor che all'opre femminili intenta Sedevi, assai contenta/ Di quel vago avvenir che in mente avevi./Era il maggio odoroso: e tu solevi Così menare il giorno.*

Prania e tingullit *a* është më e dendur në pjesën e parë të poezisë, sepse aty nis dialogimi, i cili ka nevojë për qetësi. Blazuçi (Blasucci) komunikimin e Leopardit me Silvian e përcakton si meditim që kalon në tri etapa: "*mall-dhembshuri-identifikim*".[40] Etapës së parë detyrimisht i duhet një muzikë e qetë, e ulët, siç ka zgjedhur poeti. Ndërsa etapa e fundit identifikon. Po të konsiderojmë identifikimin si një mekanizëm filozofik që Leopardin e dërgon te zhgënjimi dhe pritja e një makabriteti-shpërbërjeje të shpresës, zëri nuk mund të jetë i qetë. Kjo ka sjellë zhvendosje deri në tkurrje të tingullit *a*: *O natura, o natura,/ Perché non rendi poi/ Quel che prometti allor? perché di tanto/ Inganni i figli tuoi?/Tu pria che l'erbe inaridisse il verno,Da chiuso morbo combattuta e vinta,Perivi, o tenerella. E non vedevi/Il fior degli anni tuoi;/Non ti molceva il core/La dolce lode or delle negre chiome,/ Or degli sguardi innamorati e schivi;*

Edhe tingulli *e* mund të krijojë pritshmërinë e njëtrajtshmërisë: në fazat e para të mallit, vargu është i mbipopulluar nga tingulli *e*, i cili vjen duke u rralluar, derisa në fazën e identifikimit, njësoj si tingulli *a*, bëhet më pak i ndijshëm: *Anche negaro i fati/La giovanezza. /Ahi come, Come passata sei,/Cara compagna dell'età mia nova,/Mia lacrimata speme!/Questo è quel mondo? Questi/I diletti, l'amor, l'opre, gli eventi/Onde cotanto ragionammo insieme?/ Questa la sorte dell'umane genti?/All'apparir del vero/Tu, misera, cadesti: e con la mano. La fredda morte ed una tomba ignuda. Mostravi di lontano*. Po ta vëmë re, edhe në shembullin që morëm, zanorja *e* e shoqëruar me bashkëtingëllore hundore, sugjeron në vesh një luhatje të zërit specifikisht të lehtë.

(VIJON NUMRIN E ARDHSHËM)

BIBLIOGRAFI

Barile, L., *Il Leopardi di un Rebora "malato d'assoluto"*, Interlinea, Novara 1993.

Barthes, R., *Aventura semiologjike*, Dukagjini, Pejë 2008.

Bisuti, D., *La poesia salva la vita*, Universale Economica Feltrinelli, quarta Edizione, Ottobre 2018.

Blasucci, L., *Genesi e contruzione di „A Silvia" e Note sul testo di „A Silvia" në Lo stormire del vento tra le piante, Testi e percorsi leopardiani*, Marsillio, Venezia 2003.

Chevrel, Y., *Letërsia e krahasuar*, Naimi, Tiranë 2016.

Eco, U., *Të thuash gati të njëjtën gjë*, Dituria, Tiranë 2006.

Eco, U., *Sulla letteratura*, Bompiani, Milano 2002.

Ferroni, G., *Storia della literatura italiana*, vol III, Dal`ottocento al novecento. Einaudi, Torino 1991.

Galdi, L., *Introduzione alla stilistica italiana*, Patron Editore, Bologna 1984 (ribotuar 8 herë-botimi i parë 1971).

Gashi, A., *Proza autobiografike (Poetika dhe modele),* Parnas, Prishtinë 2017.

Hatim, B., *Teachhing and researching translation* Harlow: Longma, 2001. Xvi+254pp. ISBN 0-582-32899 (Applied linguistics in action series)

Heidegger, M., *Der Weg zur Sprache*, Vitrorio Klosterman, Frankfurt am Main, 1985.

Marteta, R., *Publicistika e Lazër Shantojës. Paradigmë shqiptare e mendimit modern,* Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Botimet albanalogjike, Tiranë 2021.

Nida, E.A., & Taber, C.R., *Theory and practice of Translanting*, Brill, Leiden 1969

Notici, S., *L`idea di musica in Leopardi e la sua incidenza sui i „Canti"*, Universita degli studi della Callabria, Facolta di lettere e filosofia, anno 2005-2006.

Plangarica, T., *Aspekte të gjuhësisë së zbatuar, INALCO, Paris* 2017.

Prete, A., *Finitudine e infinito, Su Leopardi*, Feltrinelli, Milano 1998.

Rebora, C., *Per un Leopardi mal noto*, «Rivista d'Italia», anno XIII, fasc. IX, settembre 1910.

Rieu, E.V., *Translation in Cassell`S Encyclopeadia of Literatture*, Vol 1, Casell, London 1953.

Ristani, V., *Kontribut në studimet përkthimore gjatë viteve `90*, Geer, Tiranë 2010.

Teichman, E., *Hapa nëUniversin e ligjërimit (Përmbledhje punimesh gjuhësore-pragmatike)*, Marin Barleti, Tiranë 2010.

Todorov, T., *Teorie del simbolo*, Garzanti, Milano 1991.

Web-site

https://www.studenti.it/la-ginestra-di-leopardi.html

http://folkloremaceratese.blogspot.com/2006/02/caratteristiche-di-alcuni-ballitipici.html

https://fjalorthi.com/ndër?PageSpeed=noscript

https://site.unibo.it/griseldaonline/it/didattica/carla-sclarandis-leopardi-scuola-competenze

https://core.ac.uk/download/pdf/59326015.pdf

https://www.researchgate.net/publication/266017340_Translation_

---

[27] Mendohet se figura që frymëzoi poezinë *A Silvia*, është Tereza Fatorini (Teresa Fattorini), vajza e karrocierit të familjes Leopardi që jetonte përballë pallatit të tyre, e cila vdiq në moshën njëzet e një vjeç. Ajo ishte një vajzë e gjallë, plot jetë, me të cilën Xhakomo (Giacomo) duhet të ketë rënë në dashuri, por pa ia shprehur kurrë asaj këtë ndjenjë.

[28] Umberto Eco, *Të thuash gati të njëjtën gj*ë, Dituria, Tiranë 2006, f. 165.

[29] Clemente Rebora, *Per un Leopardi mal noto*, «Rivista d'Italia», anno XIII, fasc. IX, settembre 1910, f. 373-449/ më vonë në përmbledhjen kolektive *Omaggio a Clemente Rebora*, M. Boni Editore, Bologna 1971, f. 69-165.

[30] Laura Barile, *Il Leopardi di un Rebora "malato d'assoluto" Int*erlinea, Novara 1993, f. 131-134.

[31] Stefania Notici, *L`idea di musica in Leopardi e la sua incidenza sui i „Canti"*, Universita degli studi della Callabria, Facolta di lettere e filosofia, anno 2005-2006.

[32] *Zib.* 29. Citimi plotë i frazës së këngës popullore: *«fàcciate alla finestra, Luciola, / Decco che passa lo ragazzo tua, / E porta un canestrello pieno d'ova / Mantato colle pampane dell'uva. / I contadì fatica e mai non lenta, / E 'l miglior pasto sua è la polenta. / È già venuta l'ora di partire, / In santa pace vi voglio lasciare. / Nina, una goccia d'acqua se ce l'hai: / Se non me la vôi dà padrona sei», «Io benedico chi t'ha fatto l'occhi / Che te l'ha fatti tanto 'nnamorati», «Una volta mi voglio arrisicare / Nella camera tua voglio venire». (c*itim i S.Notici)

[33] Notici, idem.

[34] Poezia *Gjineshtra* e Leopardit. https://www.studenti.it/la-ginestra-di-leopardi.html

[35] Për saktësim *gjineshtra* është lule që popullon anët e rrugëve në Shqipëri, falë klimës së ngrohtë dhe të lagësht të zonave të jugut e të Shqipërisë së mesme.

[36] https://fjale.al/çelës

[37] Donatella Bisuti, *La poesia salva la vita*, Universale Economica Feltrinelli, quarta Edizione, Ottobre 2018.

[38] Ladislao Galdi, *Introduzione alla stilistica italiana*, Patron Editore, Bologna 1984 (ribotuar 8 herë-botimi i parë 1971).

[39] Ladislao Galdi, vep. e cituar, f. 29. Edhe shpjegimet e fuqisë së zanoreve i janë referuar këtij kapitulli të Galdit.

[40] Luigi Blasucci, *Genesi e contruzione di „A Silvia" e Note sul testo di „A Silvia" në Lo stormire del vento tra le piante*, *Testi e percorsi leopardiani*, Marsillio. Venezia 2003, f. 131-138.

Karikaturë nga Arben Meksi